



854-32-93

V79

GJERGJ VLASHI

PESË
DRITARE

TREGIME

8SH-32-93.

S

V 79

GJERGJ VLASHI

~~42468~~

3329

PESË DRITARE

- TREGIME -

Biblioteka

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

QJERGI VJASHI

PRESE DORITARE

- BMDIOT -

Tirazhi 4000 kopje Format 70 x 100 /32 Stash 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1987

PESË DRITARE

Mikut tim P.P.

Lexova edhe faqen e fundit të romanit dhe pastaj e mbylla librin. Qëndrova ca duke menduar me bërryla të mbështetur mbi tryezë. Pasi lexoj një libër të bukur, zakonisht ndjej njëfarë brengje të ngjashme si në çastet kur ndahemi me ndonjë njeri të dashur. Nxorra një cigare nga paketa dhe pashë orën: njëmbëdhjetë e ca. Gjumë nuk kisha. Teksa po matesha të ndes cigaren, vura re se dhoma ishte mbushur me tym duhani, që ishte nderë gjithandej si një mjegull e kaltër e tejdukshme.

U ngrita dhe hapa dritaren. Era e freskët e asaj nate të butë vjeshte ma filladiti fytyrën. Mora frymë thellë dhe hodha sytë përreth. Rruga ishte e qetë dhe e përgjumur. Vetëm një mace rrëshqiste e heshtur rrzëzë mureve të shtëpive që dukeshin si përbindsha guri. Larg, dëgjohej në të rrallë zhurma e ndonjë automobili, sirena e çjerrur e lokomotivës dhe akoma më larg zhaurima e elektrovinçave të portit. Pastaj vështrimin e ndala në

pallatin e madh katërkatësh përballë shtëpisë si-
me. Ai është një pallat i lartë, i gjatë; nuk ka
çati po një teracë të madhe. Në teracë banorët
e katit të fundit varin rrobat e lara në telat e
vëna për këtë punë. Ky pallat ka shumë dritare,
por pesë ishin të ndriçuara. Në katin e parë banon
Sotiri, një aktor teatri me të cilin kam qenë shok
shkolle. Edhe drita e dhomës së tij ish e ndezur.
Duke vështruar me kujdes, vura re në ballkonin
para dhomës së tij zjarrin e një cigareje që ndizej
dhe shuhej herë pas here si një xixëllonjë e
kuqe.

— Mirëmbërëma, Sotir. — I fola unë papa-
ndehur.

— **Mirëmbërëma.**

— **Paske dalë të marrësh fresk?**

— **S'kam gjumë.**

Heshtëm. Pastaj mua m'u kujtua diçka:

— **Si e ke gruan?**

— **Mirë më thonë. Pres që të lindë.**

— **Ç'thotë mjeku?**

— **Fjalë të mira.**

— **Po vi të rri pak. Edhe unë, nuk kam gjumë.**

Mbylla dritaren dhe dola nga dhoma.

Duke ecur, pashë në rrugë autoambulancën
që kish qëndruar para njerës nga tri hyrjet e pa-
llatit të madh. Në katin e tretë, në krah të djathtë,
ish dritarja me dritë e doktor Pëllumbit, kirur-
gut të spitalit. Siç ndodh shpesh — rastis edhe çdo
natë — ata kishin ardhur ta marrin e ta çojnë në
spital për ndonjë konsultë ose operacion urgjent.

Teksa unë rrija në rrugë, nga hyrja e madhe,
shquajta mjekun që ecte pak i kërrusur përpara.

— Mirëmbërma, doktor.

Ai qëndroi një hap. Nuk më njohu. Pastaj:

— Mirëmbërma. — m'u përgjegj duke ju afruar autoambulancës.

— Po shkoni në spital?

— Më thirrën për një operacion.

— Ndonjë rast urgjent?

— Ashtu duket. Më thanë se është një pacient me apendicit akut.

— Natën e mirë dhe punë të mbarë, doktor!

U hap e u mbyll dera e autoambulancës dhe maqina u nis menjëherë. Ngrita kokën. Pas xhamit të dritares me dritë në katin e tretë, pashë siluetën e gruas së doktorit. Ajo ish zgjuar dhe priste gjersa i shoqi të kthehej pasi të kish qetësuar më parë dhëmbjet e ndonjerit që vuante dhe përpëlitej në shtratin e bardhë të spitalit.

Sotirin e gjeta të ulur në ballkon me duar të kryqëzuara në krahëror, Zura vend përballë tij.

— Si shkojnë provat e pjesës së re? — e pyeta për të çelur bisedë.

— Njëfarësoj.

— Kur e keni premierën?

— Sot një javë.

Në rrugë kaluan duke biseduar e duke qeshur disa vajza. Janë punëtoret e turnit të dytë të fabrikës së cigareve, mendova unë. Sotiri vazhdoi:

— Javën që vjen unë kam dy premiera, atë të teatrit dhe atë të gruas. Ti je beqar dhe ende nuk e ke provuar ç'do të thotë të presësh fëmijën e parë. Kur isha si ti edhe nuk e dija, por tani po e provoj se qënka gjë e madhe, qënka një shqë-

tësim i ëmbël dhe në rastin tim, një pritje e padurueshme. Them në rastin tim, se ime shoqe nuk po e lind fëmijën në kondita normale.

— Sa ju bënë në maternitet?

— Gati dhjetë ditë. A e beson? Atje e kam mendjen ditë e natë.

Në prova jam bërë i shkujdesur, nuk përgatitem mirë dhe nuk luaj si duhet. Regjizori kërkon punë më intensive, sidomos tani që është java e fundit, «java e sulmit» siç e quajnë në teatër.

— Si dukesh me rolin?

— Roli është i bukur dhe më pëlqen por, ja që unë nuk jam në terezi dhe e kam mendjen e ngritur. Thuj si të duash, po suksezi im në premierën e teatrit varet shumë nga suksezi i «premierës» së gruas.

Sotiri e kish dritën nga pas dhe unë s'ja dalloja mirë shprehjen e gjallë të fytyrës së tij prej aktori. Vetëm i dëgjoja zërin e qetë dhe të ngrohtë. Ai fliste shkoqur dhe me nuanca.

Papandehur u dëgjua një e qeshur e madhe dhe zëra njerëzish që flitnin përnjëherësh. E qeshura dhe zhurma e zërave vinte nga lart. Para se unë të kisha hapur gojën për ta pyetur, Sotiri tha:

— Atje lart, në katin e katërt, bëhet dasmë. Xha Ymeri, ai këpucari plak, marton të birin. S'e vure re dritaren e tyre që kish dritë?

Atëhere m'u kujtua se për atë gjë më kish thënë edhe nëna para dy ditësh.

— Djali i xha Ymerit është bërë marinar më duket, apo jo? — pyeta unë.

— Po. Mbaroi shkollën e marinës «Mujo

Ulqinaku» të qytetit dhe tani endet nëpër det. Unë po të mos isha bërë aktor, s'është çudi që sot të isha marinar. Më pëlqen shumë të lundroj. Kur isha fëmijë, ëndërronja shumë për detin.

— Me cilën martohet djali i xha Ymerit? — u interesova unë.

— Me një shitëse të MAPO-s — tha Sotiri — Xha Ymeri e ka kundërshtuar shumë bashkimin e të birit, se ajo është ortodokse. Po pastaj u zbut dhe tani po i bën një dasmë të mirë.

Sotiri nderi një cigare. Nga lart u dëgjuan përsëri të qeshura. Unë rrija e mendoja martesën e marinarit me shitësen. Kur isha i vogël, kisha menduar se marinarët nuk martohen ngaqë janë përherë larg. M'u kujtua ç'më kish thënë një herë një marinar plak: ne detarët jemi mysafirë në tokë dhe në familje. Unë i fola përsëri Sotirit:

— Gratë e marinarëve e kanë të rëndë jetën, atyre shpesh u takon të rrinë vetëm dhe të shqetësohen në netët me stuhi, kur burri është në det.

Ai u mendua ca, pastaj foli:

— Janë mësuar. Njeriu kur familjarizohet me heroikën e jetës, fle i qetë.

Unë nuk fola më, po me mend i dhashë të drejtë Sotirit. Qëndruam ca kohë në heshtje. Pas pak Sotiri hodhi cigaren nga ballkoni dhe unë e ndoqa me sy gjersa ra në tokë. Pyeti:

— Sa ka vajtur ora?

— Ka kaluar mesnata.

— A flemë?

— Flemë.

U ngrita dhe dola. Në rrugë dëgjova disa pika uji që binin nga lart. Ngrita kokën. Në katin

e parë, disa metra nga e majta e apartamentit të Sotirit, ish dritarja e ndezur e Fanisë. Ajo është një vajzë e re, që punon në fabrikën e cigareve. Siç duket ajo kish punuar në turnin e dytë dhe ish kthyer në shtëpi pas orës njëmbëdhjetë. Pashë se ajo kish një kanë në dorë dhe po lagte lulet në parvazin e dritares.

— Mirëmbërëma, Fani.

— Mirëmbërëma.

— Si i ke lulet?

— Për bukuri. Veç kërkojnë shumë kujdes.

Teksa ne bisedonim, dëgjova pas meje një hap të rëndë, që sa vinte afrohej. Ktheva kokën. Pashë një burrë të gjatë me uniformë polici, që u fut në hyrjen e pallatit prej nga dola unë pak përpara.

— Tani u ktheve nga puna? — e pyeta Faninë, duke ngritur prap kokën lart.

— Kam një gjysmë ore. Hëngra, dhe tani po bëhem gati të bie në shtrat.

— Atëhere s'po të mbaj më se je e lodhur. Natën e mirë.

— Natën e mirë.

Duke vajtur në shtëpi solla ndërmend jetën e Fanisë. Ajo ishte e bija e një muratori, që para shumë vjetësh, kur vajza ende ish në djep, ish rrëzuar nga skelat dhe kish vdekur. E ëma ato kohë ish rrobalarëse. E kish rritur me mundime. Ajo banonte në një shtëpi të vogël përdhese në lagjen Stan. Kurse tani që ish rritur, Fania banonte me nënën plakë në pallatin e madh, punonte, mësonte dhe i pëlqenin lulet dhe librat.

Para se të bija në shtrat, nxorra edhe njëherë

kokën në dritaren time: dritarja e aktorit, e punëtores së fabrikës së cigareve, e policit dhe e marinarit ishin shuar. Në ballin e gjërë të shtëpisë ish ndezur vetëm dritarja e doktorit.

Teksa dora e butë e gjumit po m'i mbyllte sytë, dëgjova zhurmën e autoambulancës që solli doktorin në shtëpi.

Pas pak edhe dritarja e pestë, dritarja e fundit me dritë do të shuhej në pallatin e madh përballë.

ATË NATË, PAS MBLEDHJES

Plaku u gjend papritmas para gardhit që rrethonte shtëpinë. Hodhi sytë përreth i habitur. «Si është e mundur të kem arritur kaq shpejt» mendoi. I kredhur në vorbullën e mendimeve ai nuk e kishte vënë re rrugën nga oborri i shkollës deri tek oborri i shtëpisë. Qëndroi para kapërcyellit. Ndjente se këmbët i zjenin dhe gjuri i majtë i therte. «Siç duket kam ecur shpejt dhe e kam ngjitur kodrën me nxitim» mendoi prapë plaku. «Po pse? Ku ta dish. Nuk mbaj mend çfarë shtytje e brendshme më ka nxitur ta bëj këtë gjë?»

Pak nga pak e ndjeu se frymëmarrja ju qetësua dhe këmbët ju shlodhën. Edhe gjuri i majtë nisi t'i theri më pak. Kurse vorbulla e mendimeve vërtitej e vërtitej në kokën e tij të thinjur.

Dëgjoi një zhurmë hapash pas vetes. Nuk ktheu kokën. Në krah të tij u ndal dikush.

— A u lodhe, baba? — foli një zë i lodhur gruaje. Ishte Minushja, gruaja e djalit, që po kthehej në shtëpi e ngarkuar rëndë me një vandak drushë.

— Nga pak — përgjegji plaku me zë të lehtë, pa kthyer kokën.

Gruaja nuk qëndroi. Ai e pa me bisht të syrit, duke i dalë mbanë kapërcyellit. Kur ajo u gjend para tij, plaku pa barrën dhe litarin e lidhur rreth kraharorit. Ndërsa ajo po largohej në gjysmëhijen e muzgut të kaltër të marsit, ai vuri re se barra dhe trupi i gruas u shkrinë e u bënë një masë e vetme që lëvizte ngadalë në oborrin e shtëpisë.

«Të prishim fejesat në moshë të vogël, të lehtësojmë gratë dhe vajzat nga punët e rënda, t'u heqim atyre litarin e ngarkesës që e sjellin bashkë me pajën kur martohen.» Duke ndenjtur aty, Elez Sadrisë ju kujtuan këto fjalë që atë pasdite ishin thënë në mbledhjen e pleqve. Që të bëheshin këto gjëra, kishin folur shumë shokë të tij: Zeqiri, Muharremi, Rahimi, Nevruzi... Por më shumë ai ishte habitur kur kishte dëgjuar Xhafën. Të gjithë e dinin se ai ishte njeri që nuk pranonte të prekeshin zakonet e trashëguara. «Kështu i kemi gjetur e kështu do t'i lëmë» e kishte zakon të thoshte Xhafa. Prandaj Elezi s'u zuri besë veshëve kur Xhafa kërkoi leje të fliste. Fjala e tij do të zinte vend jo vetëm se kishte pesë nuse e katër vajza në shtëpi, porse të gjithë e njihnin si burrë të ndershëm e fjalëpakë. «Të prishim fejesat në moshë të vogël? Të lehtësojmë gratë nga punët e rënda? Të gjitha do t'i bëjmë, derisa kështu thotë Partia. Ne kurrë nuk ja kemi bërë fjalën dysh asaj. Çfarë ka thënë Partia e nuk ka qënë për të mirën tonë?» Kaq kishte thënë Xhafa dhe ishte ulur.

Pastaj Elezit ju kujtua çasti më i bukur i mbledhjes kur kishin lexuar letrën që do t'i drej-

tonin Enverit, ku përmendeshin zotimet që kishin marrë. Fjalët e letrës ishin të dala nga zemrat e të gjithëve: Dukej sikur atë e kishte shkruar edhe Rahimi, edhe Nevruzi, edhe Xhafa edhe vetë Elezi. Aty në oborrin e shkollës pleqtë shikonin njëri tjetrin, thithnin në heshtje çibukët dhe mendoheshin thellë; mendoheshin dhe kujtonin.

Ndoshta të gjithë nuk e kuptonin rëndësinë e atyre vendimeve që kishin marrë, por e ndjenin se kishin bërë një punë të madhe; kishin rrëzuar një mur të lartë dhe shumë gjëra do të ndryshonin pas kësaj në jetën e fshatit, në jetën e grave dhe vajzave të këtij brezi dhe sidomos të brezave që do të vinin më vonë. Prandaj aty në mbledhje edhe Elezi kishte ngritur dorën dhe i kishte miratuar ato vendime me gjithë zemër.

Po pse tani pas mbledhjes kishte qëndruar pranë shtëpisë, para kapërcyellit dhe mendohej e nuk bënte hap përpara? Ç'e trazonte vallë plakun? Ai thoshte me vete: «Jam i lodhur dhe dua të shlodhem pak». Por arsyeja ishte diçka tjetër. Atij se si i vinte të shkonte në shtëpi atë natë, pas mbledhjes. Si do t'u përgjegjej kur ta pyesnin dhe, ç'është më e rëndësishmja, si do t'i vinte në jetë ato vendime? Të ngrije dorën në mbledhje ishte e lehtë, po, të zbatoje vendimet e marra, ishte e vështirë.

Në oborr lëvizi një hije. Nga ecja ai e kuptoi se ishte Sabrieja, gruaja e tij. E pa që ju avit pusit. Dëgjoi kovën që u përplas në ujë duke lëshuar një zhurmë të shkurtër e të mbytur. Pas pak dëgjoi që kova u përplas edhe një herë në ujë. E shoqja diç foli dhe hyri në shtëpi.

Papandehur Elezi i dha një të shtyrë vetes dhe i doli mbanë kapërcyellit. Eci drejt shtëpisë, duke e mbajtur trupin drejt. Megjithatë vorbulla e mendimeve përsëri vërtitej e vërtitej në kokën e tij.

Në dhomën e zjarrit, aty në një cep, ishte vetëm nipi i tij, Lazimi, i përkulur mbi librat e shkollës.

— Nuk ka ardhur Bektashi? — e pyeti djalin.

— Jo. Babai është me tufën. Po i bëjnë një vathë të re.

— E di. Po ti ç'bën?

— Po mësoj.

Elezi e donte shumë nipin megjithëse këtë gjë nuk e çfaqte kurrë. Po Lazimi e kishte ndjerë këtë dhe sillej e bisedonte me gjyshin ndryshe nga të tjerët.

— Si shkove sot në shkollë? — e pyeti plaku duke zënë vend në qoshe të vatrës.

— Shumë mirë. Mora një nëntë në histori. Po ti, ku ishe, gjysh?

Elezi e vonoi përgjigjen. Pastaj tha:

— Në mbledhje.

— Te shkolla?

— Po.

— Për çfarë u fol në mbledhje?

Elezi nisi të dredhë një cigare pa e shikuar të nipin.

— Mos e kishit mbledhjen për punët bujqësore?

— Jo.

— Po për çfarë atëhere? — nguli këmbë Lazimi kureshtar.

Plaku leu letrën me pështymë, duke i hequr cepat, i mëshoi dorës dhe e grisi.

— Në mbledhje u fol për gratë.

Djali e shikoi gjyshin i habitur dhe e pyeti prapë:

— Për gratë? Po për vajzat?

Elezi nuk u përgjegj dhe nxori një letër tjetër.

Lazimi nuk priti përgjigjen por foli:

— Sot në shkollë u tha se fejesat e fëmijëve do të prishen.

Plaku nuk u besoi veshëve. Ngriti kokën dhe e vështroi djalin sikur ta shihte për herë të parë. Lazimi për një çast u shkëput nga biseda dhe shikonte një hardhuckë jeshile që rrinte përmbys mbi trarin e madh të dhomës.

— Si qëndron hardhucka në tra e nuk rrëzohet? — pyeti papandehur Lazimi.

— Çfarë u tha për fejesat e fëmijëve? — pyeti plaku.

— Do të prishen — përgjegji shkurt djali dhe vazhdonte të shihte hardhuckën i çuditur. — Mos ka ndonjë zamkë te këmbët ajo që nuk bie poshtë?

Edhe Elezit ja kishte zënë veshi punën e prishjes së fejesave. Për këtë gjë kishin marrë vendim edhe në mbledhje atë pasdite. Por që kjo gjë të bisedohej edhe në shkollë, në mes të nxënësve, këtë nuk do ta kishte besuar kurrë.

— Po unë, a jam i fejuar, gjysh? — pyeti papandehur Lazimi.

Plakut ju drodh dora, sikur t'i kishte rënë dikush me bërryl. Duhani i ra mbi gjunjë.

— Mbylle gojën, se ta ngjesha! — ju hakërrua djalit me mashë.

Lazimi uli kokën, pastaj e ngriti prapë dhe shikoi hardhuckën që si një krokodil i vogël rrinte pa lëvizur poshtë trarit.

Elezit i kaloi shpejt zemërimi. Fundi, nipi i tij nëntë vjeç nuk kishte thënë ndonjë gjë të madhe. Por plakut i vinte shumë inat kur fëmijët përziheshin në bisedat e të rriturve. Nga fjalët e tij ai kuptoi se çështja e grave dhe e vajzave ishte bërë çështje e të gjithëve. Atë çast i erdhi mirë që kishin marrë ato vendime dhe u gëzua që edhe ai e ngriti dorën me gjithë zemër. Por, ai kishte qenë vetëm fillimi. Tani duhej vepruar, duheshin vënë në jetë vendimet e mbledhjes. Po si, në ç'mënyrë?

Hyri Sabrija me një gjym në dorë.

— Nuk erdhi Bektashi? — e pyeti ai.

— Jo. — përgjegji ajo.

Pas pak dera e dhomës u hap dhe hyri brenda Minushja me një krah drush që i lëshoi pranë vatrës. Pastaj, para se të dilte, hodhi litarin e ngarkesës aty në mes të plakut e të nipit.

— A do të hash? — pyeti Sabrija.

— Më vonë — përgjegji Elezi.

Ajo i vuri disa dru zjarrit dhe doli nga dhoma.

Elezi prapë mbeti vetëm me të nipin. Por tashti në mes të tyre ishte litari i ngarkesës. Ai ktheu kokën dhe e shikoi. Litari ishte pak i vjetër, i përdorur dhe i shthurur në të dy cepat. Që kur ishte fëmijë e deri tani — më shumë se gjashtë-

dhjetë vjet — ai e kishte parë litarin e ngarkesës të lidhur në trupin e të gjitha grave të fshatit. Ende ruante në kujtesë psherëtimat e nënës së tij kur kthehej nga mali e ngarkuar. hidhte barrën e druve në oborr dhe zgjidhte litarin. Gruaja në ato anë — ashtu si kudo — ishte e lidhur me shumë litarë të dukshëm e të padukshëm. Ajo nuk bënte dot një çap të lirë në jetë, se menjëherë, një tufë litarësh e tërhiqnin, e mbanin të gozhduar në vend dhe i tregonin rrugën nga duhej të ecte. Ato litarë e ndiqnin gruan nga djepi në varr, i vritnin shpinën dhe shpirtin. Elezit atë çast i dolën parasyshtë qindra gra, që kalonin të heshtura nëpër rrugët e fshatit, të ngarkuara rëndë, të lidhura me litarë, me fytyra të kthyer nga toka se ato litarë nuk e linin të ngrinte krye e të shihte një copë qielli të kaltër. I shihte gratë e vajzat gjithnjë të ngarkuara, të lodhura, të heshtura duke u zvarrisur nëpër shtigjet e malit dhe nëpër rrugët e fshatit. Tani partia thotë se këtyre gjërave u duhet dhënë fund një herë e përgjithmonë, dhe ashtu do të bëhet.

Teksa ai rrinte duke parë litarin e ngarkesës, u hap dera dhe hyri Bektashi. Ishte i lodhur, po fytyra i shkëlqente. Ai u ul në qoshen tjetër të vatrës, vuri qeleshen mbi gju dhe nisi të fshijë kokën e qethur.

— Ke kohë që ke ardhur? — e pyeti të jatit.

— Kam pak.

Kaluan disa çaste. Plaku, që kishte pyetur disa herë për të birin, tani nuk dinte si të niste bisedën.

— E mbaruat vathën?

42470

— Po. Sonte dhentë do të flej në shtëpi të re — qeshi Bektashi i kënaqur.

Elezi bëri buzën në gaz. Pas tyre u dëgjua zëri i Lazimit që ja plasi gazit dhe tha:

— Qenke bërë edhe murator, baba!

Dy burrat kthyen kokën. Bektashi shikoi të birin, kurse Elezit i shkuan sytë te litari që ndodhej në mes të tij e të nipit.

— Rri e merru me librat e tua e mos u përzje në bisedë! — e qortoi Bektashi të birin.

— Pse? Unë pak më përpara bisedova edhe me qyshin! — tha Lazimi.

— Ashtu? E për çfarë folët?

— Për punën e grave e të vajzave — përgjegji djali duke u përpjekur t'i japë vetes një hije të rëndë burri. — Gjyshi ka qenë në mbledhje, te shkolla. Atje kanë folur për gratë.

Elezi, padashur kapi mashën por e lëshoi menjëherë.

Atë çast hyri Bedrija.

— Na shtro të hamë — i tha Elezi.

Kur doli plaka, Bektashi fshiu kokën me pëllëmbën e dorës dhe tha me zë të lehtë, por duke u mëshuar fjalëve:

— Kudo ka nisur një luftë e madhe që femrat të fitojnë të drejtat që u takojnë.

Elezi ngriti kokën dhe e shikoi. U mat të flasë por i biri vijoi:

— Në gjithë Shqipërinë po bëhen mbledhje e po merren vendime. Fjalët e Enverit kanë ngritur peshë mendjet e zemrat e njerëzve. Edhe ne duhet të bëjmë diçka në shtëpinë tonë. Si thua, baba?

~~42468~~

3329

Dy gratë sollën darkën.

Kur po lanin duart, Sabrija i tha Elezit:

— Mos harxhoni shumë ujë, se sonte nuk kemi.

Plaku e shikoi.

— Është këputur litari i pusit. Ishte ngrënë duke u fërkuar tek gurët dhe qëparë u këput.

Elezit ju kujtua se, kur po rrinte atje para kapërcyellit, kishte dëgjuar dy herë zhurmën e kovës duke rënë në ujë.

— Nesër mos harroni e na blini një litar të ri.

Plaku ktheu kokën dhe shikoi litarin. Ndjeu se një valë ngashërimi po i buronte së thelli dhe gati ju muarr fryma.

— Dëgjo! thirri më në fund dhe zëri i tij ushtoi në dhomën e zjarrit. Të gjithë e shikuan duke pritur se ç'do të thoshte. Edhe Lazimi i vogël nuk shikonte më hardhuckën por ja nguli sytë plakut. Elezi pas asaj fjale heshti dhe sytë e tij u takuan në fillim me sytë e qetë të së shoqes, pastaj me ato të nuses. Ai vuri re se sytë e Minushes ishin të mëdhenj dhe po e shikonin me vemendje.

— Dëgjo — përsëriti edhe një herë plaku dhe me një lëvizje të shpejtë mori litarin e ngarkesës dhe e mbajti në dorë para syve të të gjithëve. — Merre litarin e ngarkesës dhe vere te pusi. Ai litar nuk do të të duhet më as ty moj plakë dhe as ty, moj nuse.

Prapë sytë e Elezit u takuan me ato të Minushes. Dhe ai vuri re se në sytë e saj u ndez një dritë e re.

E MIRË SI BUKA

Çdo ditë në orën pesë e gjysëm të mëngjesit e gjej Myrveten para derës së shtëpisë. Kur ajo hypën në maqinë, unë e pyes:

— Ke kohë që pret?

— Tani sa zbrita.

Një ditë i thashë:

— Si e kupton që është maqina ime?

— Zhurma e «Ifas» që ke ti, ndryshon nga ajo e maqinave të tjera. — M'u përgjegj ajo thjesht.

Kjo përgjigje më bëri të mendohem. Si shofer, e di se edhe maqinat, ashtu si njerëzit, kanë zërin e tyre që i dallon nga njera tjetra. Por që ta bësh këtë dallim, duhet të mirresh me atë punë dhe ta kesh veshin e stërvitur. Ndoshta Myrvetja e njeh Ifën time se në kthesën e fundit para shtëpisë së saj, unë i bie burisë dy herë — vetëm dy herë. Zëri i burisë është i shkurtër, i thatë dhe duket si trokitje në një derë të padukshme. Dimrit në orën pesë e gjysëm është errësirë e plotë dhe në dritat e forta të maqinës unë shquaj trupin e gjatë e të hollë të Myrvetes, mbështjellë me pallton bojëkafe. Ajo s'e ka larg shtëpinë nga dyqani ku shet bukë, megjithatë ka pranuar të shkoj e ta marr çdo mëngjes me Ifën time ngar-

kuar me bukë të freskëta, që ende avullojnë duke shpërndarë një aromë të këndshme.

Ka më se një muaj që vazhdon kjo gjë. Çdo ditë përsëriten po ato lëvizje, thuhet po ato fjalë, megjithatë mua më duket përherë se po ndodh diçka e re, diçka e bukur. Unë ndal maqinën dhe i hap derën. Ajo hyn në kabinë dhe më thotë: — Mirëmëngjes — pastaj shton duke marrë frymë thellë — Sa erë e mirë! Pasi nisemi, unë ndjej kundërmimin e flokëve të saja, e trupit të saj të hollë mbështjellë me pallton bojëkafe. Dyqani i saj është afër, por unë e ngas maqinën ngadalë, duke shikuar fytyrën e saj të qetë e të skuqur nga të ftohtit. Te dyqani e ndihmoj të shkar-kojë bukët, që ajo i vendos në raftet e bardha. Nganjëherë gishtat e mij të trashë, plot nyje bashkohen me gishtat e saj të gjatë, të mavijosur nga të ftohtit. Pastaj unë mbyll spondën, e përshëndes dhe e ngas maqinën shpejt që të ngarkoj bukë për dyqanet e tjerë.

Ajo sillet me shumë përzemërsi dhe unë nuk e kuptoj, a ndjen gjë për mua, apo kështu sillet me të gjithë se është e mirë. Ka nisë të më shqetësojë, se e dashuroj me gjithë forcën e shpirtit. Duhet t'ja them Myrvetes pa e zgjatur fare. Unë jam njeri që nuk i bëj tërkuzë punët dhe çfarë kam në zemër e ve në gjuhë. Prandaj edhe kësaj i duhet dhënë rrugë pa vonesë.

Dje në mëngjes, pasi shkarkuam bukën e fundit nga maqina, ajo nuk u fut brenda por qëndroi aty pranë karrocërisë, teksa unë po mbyllja spondën.

M'u duk sikur priste diçka.

— Myrvete — nisa të flas unë — Nuk ta kam

thënë deri sot, pasi... ashtu ka qenë puna. Dëgjo, duhet të dish që të dashuroj.

Ajo nuk lëvizi. Pasi i thashë ato fjalë, në pallatin përballë dyqanit të saj u ndez një dritë. Dikush u zgjua mendova unë, duke u shkëputur për një çast.

Pas pak shtova:

— Të dashuroj me gjithë shpirt se ti je e mirë, e mirë si buka.

Si ta kishte shtyrë njeri, ajo u shkëput nga vendi dhe u fut në dyqan duke qëndruar me fytyrë nga raftet plot me bukë.

Hypa në maqinë dhe ndeza motorin, por nuk u nisa. Në pasqyrën e kabinës shikoja Myrveten. Pasi dëgjoi zhurmën e maqinës, ajo padashur ktheu kokën. M'u duk e habitur dhe si e trembur.

Sot në mëngjes u zgjova shumë shpejt. U solla rreth maqinës, duke pritur orën që të shkoja për të ngarkuar. Te furra u grinda me përgjegjësen se donte të ngarkonte një maqinë që, siç thonte ajo, kishte ardhur para meje. I ndihmova gruas së shërbimit që ta ngarkonte shpejt, megjithëse ishte ora pesë. U nisa, por nuk dija ku të shkoja. I rashë dy herë rrotull pazarit, përshkova një rrugë të gjatë duke pritur që të vinte ora pesë e gjysmë. Kur ora e qytetit tingëlloi duke shpërndarë nëpër rrugët e fjetura zërin e saj metalik, unë mora kthesën e fundit para shtëpisë së Myrvetes, duke i rënë burisë dy herë — vetëm dy. Por dritat e forta të maqinës dhe sytë e mij më kot kërkuan vajzën me trup të hollë, mbështjellë me pallton bojë kafe. Ajo nuk ishte aty. Pa qëndruar fare e drejtova Ifën time te

dyqani i bukëve. Qepeni ishte i hapur, drita ishte e ndezur dhe pas rafteve të zbratur rrinte Myrvetja. Kur e përshëndeta, pashë se fytyra e saj ishte më e skuqur se ditët e tjera. Më hodhi një vështrim të shkurtër, pastaj e heshtur u drejtua nga maqina dhe nisi të shkarkojë bukët. Nuk folëm asnjë fjalë. Edhe kur sytë tanë ndesheshin, ajo i bënte meniëherë, sikur trembej nga diçka.

«S'doli gjë kjo punë» thashë i dëshpëruar, duke u larguar nga dyqani i saj. «S'ke ç'bën! Nejse, unë ja thashë. Ajo nuk foli, nuk u përgjigj. Nuk do ta hap më këtë bisedë. Mos të pandehë se do t'i bie në gjunjë. Nëse ajo nuk do një herë, tani unë nuk dua njëqind herë. Punë e madhe!»

Gjithë ditën qeshë i zemëruar dhe u mbeta në derë shitësve të bukës në dyqanet e tjerë. Në darkë takova Mihalin, shoferin e spitalit. E kam shok dhe shkuam u ulëm në qoshen më të errët të një pijetoreje të vogël. Aty ja rrëfeva brengën time.

Pasi dëgjoji deri në fund fjalët e mia, Mihali, që nuk di të rrijë pesë minuta serioz, më tha:

— E sa ishte ora kur ja the ato fjalë?

E vështrova i habitur:

— Ora? Po besoj akoma s'kishte vajtur gjashtë. Pse pyet?

Ai qeshi. Mua më hypi gjaku në kokë:

— Ç'ke që zbardh dhëmbët? — thashë tërë inat.

— Si të mos qesh, mor Abdyl vëllai. Po a i shfaqet dashuria një vajze në orën gjashtë të mëngjesit, pa zbardhur dita? Ajo akoma ka qenë mahmur, kurse ti i ke thënë fjalët e tua. Në këtë kohë njeriu mezi thotë «mirëmëngjes» e jo të dëgjojë deklarata dashurie e t'u përgjigjet atyre.

U ngrita, përndryshe do të isha zënë me Mihalit. Duke kapërcyer prakun dëgjova qeshjen e Mihalit. Ajo e qeshur më ndoqi deri larg. Atë natë, sa herë mendova për Myrveten, më vinte ndër vesh edhe e qeshura e Mihalit, që ma shtonte edhe më shumë inatin.

Thonë se të këqijat nuk vijnë kurrë vetëm. Edhe mua kështu më ngjau. Tani që jam në spital, rrij e mendoj për këtë gjë. Që ditën që Myrvetja nuk ju përgjigj dashurisë sime, punët më kanë shkuar ters. Pas dy ditësh, drejtorja më largoi nga ajo punë dhe më caktoi të furnizoja dyqanet e zarzavateve me mall të fermave jashtë qytetit. Në fillim më erdhi mirë që u largova nga Myrvetja. Po pas disa ditësh nisa të ndjej mall për të dhe mbrëmjeve nganjëherë kaloja nga dyqani i saj dhe fshehurazi e shihja Myrveten prapa banakut me atë fytyrën e qetë, gjithmonë pak të skuqur. Nuk doja që ajo ta merrte vesh se isha aty. Nuk i përulem njeriu unë, aqë më shumë një vajze.

Aksidenti më ngjau pas dy javësh. Po udhëtoja një ditë me Ifën time të kaltër dhe një kamion i madh, duke dashur të më kalojë para, u pengua nga një qerre e ngarkuar me pajën e një nuseje, nuk gjeti rrugë tjetër por erdhi e u përplas me Ifën time. Nga ajo përplasje e pësoi më keq maqina ime e vogël dhe e lehtë. Teksa po rrëzohesha në hendek, desha të hap derën për të dalë, po maqina u përplas për tokë, dhe dera më zuri dorën e ma theu. Kam pesë ditë që rrij shtrirë në spital me krahun e djathtë futur në allçi. Kokën dhe fytyrën m'i kanë mbështjellur

qetë... Të kap edhe njëherë timonin, pastaj do të flasim. Ti ndërkaq mendohu prapë.

Ajo qëndroi e mpirë, e shtangur. Fjalët e mia i kishin ardhur të papritura dhe shumë të rënda. Pas pak u kthye nga dera dhe doli jashtë.

U ngrita me zor nga shtrati dhe hodha vështrimin përtej dritareve. E pashë duke përshtuar ngadalë oborrin e spitalit, ashtu e pështjellë nga pëlhura e imët dhe e ndritur e shiut.

U shtriva në shtrat. Mbylla sytë. Dorën e shëndoshë e vura nën kokë. Nuk më erdhi mirë që i fola ashtu Myrvetes. po nuk mund të vepra ndryshe. Një zë i brendshëm më detyroi t'i them ato fjalë. Pastaj kisha nevojë të shfreja.

Nuk e di sa kohë kam që rri kështu pa lëvizur.

Filloi të erret. Po rri gjithnjë i palëvizur, gjithnjë duke menduar për Myrveten. Më vjen ndërmend njohja jonë, ditët kur e merrja me maqinë para shtëpisë çdo mëngjes. Më vjen ndërmend dita kur i thashë:

— Të dashuroj me gjithë shpirt se ti je e mirë, e mirë si buka!..

Dhe në fund më vjen ndërmend se kur i thashë këto fjalë, në pallatin përballë u ndez një dritë.

QYTETI QË KISH HUMBUR QETËSINË

Shkrimtari Andon Treshiti vendosi ta kalojë lejen krijuese në qytetin N., ku banonte tetoja e tij. Ajo kishte një shtëpi të vogël e të veçuar, me kopësht plot lule e pemë. Andoni kishte dhjetë vjet pa vajtur atje. Herën e fundit kishte kaluar te tetoja dy javë, që ende i kujtonte me kënaqësi. Qyteti ishte i vogël, i bukur dhe shumë i qetë. Edhe në verë, kur në Tiranë vapa është e padurueshme, atje bën fresk, se qyteti N. është në këmbët e një mali të lartë, hijerëndë, sipër të cilit në netët e qeta del hëna si një sy i madh, i çuditshëm.

Andoni kish nisur të shkruajë një roman dhe brenda dy muajve kishte hedhur në letër vetëm-kapitullin e parë. Puna në zyrë, mbledhjet, zhurma e qytetit të madh nuk e kishin lënë të punojë sa duhet. Atje te tetoja mund të punonte i qetë, pa e trazuar njeri.

Ditën që do të nisej u zgjua shpejt dhe doli nga shtëpia një orë para se të nisej autobusi. Eci ngadalë nëpër rrugët plot zhurmë të qytetit duke shikuar njerëzit, fëmijët e kopshteve që çapitnin të zënë dorë për dorë njëri pas tjetrit, pemët dhe ballkonet me lule.

Kur u nis autobusi, atij për një çast i erdhi keq që po largohej nga Tirana tani në pranverë. Porsa autobusi la pas qytetin dhe u sul nëpër shiritin e zi të asfaltit, në mes kodrash të bleruara, fushash me bar të njomë, atë e rrëmbeu bukuria e natyrës së zgjuar dhe harroi çdo gjë.

Kur hynë në qytet, kishte rënë nata. Sa vuri këmbët në tokë, ju duk se kishte ardhur në një qytet të panjohur. Në shesh kishte disa ndërtesa të reja trikatëshe, që ai nuk mbante mend të kishin qenë më parë. Sheshi ishte i asfaltuar dhe me drita. Ai hodhi në sup pardesynë, rrëmbeu nga toka valixhen dhe u nis për në shtëpinë e tetos.

Kur hapi derën, në fillim ajo nuk e njohu. Pastaj ju hodh në qafë, i mori valixhen nga dora dhe e futi brenda. Tetoja ishte një grua që sa i kishte kaluar të pesëdhjetat. Ishte trupshkurtër, me flokë të thinjura e të mbledhura pas zverkut. **Kishte sy të mëdhenj, të rrumbullaktë që shikonin plot ëmbëlsi dhe gishtërinj të gjatë, me ngjyrë të zbetë dhe nervozë.** I shoqi i kishte vdekur para shumë vitesh dhe ajo jetonte vetëm me të birin që tani ishte ushtar. Punonte si rrobaqepëse në kooperativën e artizanatit, bënte jetë të qetë, duke u kujdesur për kopshtin dhe duke lexuar pareshur letrat e të birit.

Atë natë Andoni nuk fjeti mirë, megjithëse ishte i lodhur. Kështu i ngjante gjithnjë natën e parë kur ndërronte shtratin. I doli gjumi disa herë dhe u përpëlit nëpër shtrat deri në orët e vona. Vetëm ndaj të gëdhirë e pushtoi një gjumë i ëmbël.

U zgjua pas orës gjashtë.

— Si fjete? — e pyeti tetoja kur e pa që doli

nga dhoma. Ajo po nxitonte, prandaj shtoi pa marrë përgjigje — Unë po iki se u bëra vonë për në punë. Qumshtin e ke në zjarr, po më parë ulu e pi kafënë. Edhe një gjë tjetër: Po dole nga shtëpia, mos harro ta mbyllësh derën me kujdes.

— Nuk është nevoja të ma thuash, teto... Pse ç'u bëra unë? i tha buzagaz Andoni.

— Ej mor bir, ju njerëzit që shkruani... — tha ajo duke tundur kokën e thinjur.

Nuk e mbaroi fjalën por i vuri përpara filxhanin me kafënë. që avullonte, pastaj hapi derën dhe doli në kopësht me hap të shpejtë. Nga dritarja e sallonit Andoni e pa duke këputur një tërëndafil të kuq të njomur me lotët e natës, pastaj tek kapërceu prakun dhe u zhduk në cepin e rrugës.

— Tani është koha të nis punën — tha Andoni pasi hëngri. E ndjente veten të shlodhur dhe një dëshirë e zjarritë për të shkruar i vlonte përbrenda. U ngrit dhe shkoi e mori dosjen me dorëshkrimin. Doli në kopësht dhe u ul në një tryezë druri të palatuar nën një plep të lartë plot gjethe fëshfëritëse.

Nuk kishin kaluar as dhjetë minuta, kur para shtëpisë qëndroi një kamion duke gulçuar rëndë. Andoni e la lapsin. Kamioni nuk kaloi tutje, por u ndal aty dhe shoi motorin. U dëgjuan disa zëra që nisën të thërrasin, pastaj një zhurmë e rëndë. Andoni u ngrit, ju afrua parmakut të kopshtit dhe hodhi sytë jashtë. Atëherë e kuptoi si ishte puna. Përballë shtëpisë së tetos po ndërtohej një pallat i madh katërkatësh. Disa punëtorë po shkarkonin tullat nga kamioni. Ndanë pallatit ishte ngritur një kullë e drunjte dhe mbi te një vinç. Andoni

ngriti kokën i habitur. Kati i tretë kishte mbaruar dhe muratorët po ngrinin muret e të katërtit. Andoni dëgjoi një murator duke kënduar atje lart. Mbi kullën e drunjtë një burrë i shkurtër bënte lëvizje me duar dhe i thërriste një djali që rrinte poshtë.

Andoni qëndroi ashtu i rrëmbyer, duke vështuar nga çdo anë pallatin që ndërtohej dhe lëvizjet e shpejta të punëtorëve. Para hyrjes ai pa dy grame kominoshe e çizme, që përzienin llaçin dhe një vajzë të re me trup të imët që hidhte ujë në një gropë, në mes të llaçit.

— Sill ujë, Fatime — i thirri njera nga gratë.

— Bidonat nuk kanë më — përgjegjji vajza.

— Shko dhe mbushi — tha tjetra duke u mbështetur te lopata.

— Tani do të shkoj — tha Fatimja.

Rrëmbeu dy bidona të mëdhenj dhe u drejtua nga dera e kopshtit të tetos së Andonit.

— A mund të mbush pak ujë te pushi? — i tha vajza Andonit duke e vështuar me habi, pasi e shihte për herë të parë.

— Mbush sa të duash, moj vajzë — tha ai dhe shtoi me buzë në gaz — uji është pa para.

Vajza qeshi me zë të lartë. Pastaj kapërceu prakun, ju avit pusit dhe hodhi kovën brenda.

— Për çfarë bëhet kjo shtëpi? — e pyeti Andoni, duke u shkëputur nga parmaku dhe duke i vajtur pranë.

— Për banim — përgjegjji ajo shkurt dhe tërhoqi me forcë litarin.

Andoni e vërejti me kujdes. Ajo kishte veshur një palë kominoshe pak të mëdha për trupin e saj të imët. Në këmbë kishte mbathur çizme.

Flokët i kishte mbledhur prapa. Kishte një fytyrë të rrumbullaktë, të rreshkur, sy të gjallë dhe duar të mëdha e të fuqishme që nuk ishin në përpjesëtim me trupin.

— Sa vjeç je? — e pyeti ai pas pak duke e shikuar me admirim.

— Nëndëmbëdhjetë — përgjegji ajo.

— Ke kohë që punon?

— Gati një vit.

— Me këtë punë merresh? — e pyeti prapë ai pas një heshtjeje të shkurtër.

— Tani për tani po. Unë dua të bëhem muratore, por përgjegjësi i këtij objekti thotë se nuk ka vende për muratore dhe se kjo nuk është punë për gra. Unë kam folur me inxhinierin e ndërmarrjes dhe ai më ka dhënë fjalën se kur të nisë objekti i ri, do të më verë të punoj si muratore, pasi të kem bërë edhe një kurs.

— Të pëlqen të bëhesh muratore?

Shumë. Ajo është punë e mrekullueshme.

Vajza mbushi dy bidonat dhe u nis për të dalur. Duke e parë, Andoni u habit si mund t'i mbante ajo vajzë aq e re ato dy bidona të rëndë. Por atë e habiti më tepër diçka tjetër: shpirti i çiltër i asaj vajze punëtore, që ëndërronte të bëhej muratore e të ndërtonte shtëpi, shkolla, fabrika...

Mbeti disa çaste palëvizur në vend, duke rrahur mendime të ndryshme, pastaj ju afrua me hapë të ngadalta tryezës së vogël. Dorëshkrimi ishte i hapur dhe mbi të qëndronte lapsi tij i verdhë.

«Më mirë po shkoj të punoj në bibliotekë» tha me vete.

Mbylli derën me kujdes dhe doli nga kopshti. Kur kaloi pranë grave që përzielin llaçin, shikoi Fatimen. Pasi i kishte hedhur ujin, ajo përziente me lopatë llaçin. Një tufë flokësh i binin mbi ballin që i ndrinte nga bulëza të vogla djerse. Kur ai i kaloi pranë, ajo nuk e vuri re.

I kredhur në mendime, Andoni përshkoi rrugën dhe doli në shesh. Nga sheshi i vjetër që ai mbante mend, pothuajse nuk kishte mbetur asgjë. Ai ishte zgjeruar dhe rrethuar me shtëpi të reja, dyqane me vitrina të mëdha, salla e kinoteatrit dhe pallati i organizatave.

Biblioteka ishte e qetë. Në sallën e leximit ai gjeti vetëm një plak, që po lexonte gazetën duke lëvizur pareshtur buzët e pa nxjerrë zë.

Zuri vend në një cep dhe hapi dorëshkrimin. Pas pak, nga dritarja e hapur u dëgjua përsëri buçima e fuqishme e një motori. Pastaj me buçimën u përzie zëri i trashë i një burri që thoshte diçka.

Andoni ngriti kokën, hodhi sytë jashtë dritares dhe shikoi plakun. Ai nuk e kishte prishur tezezinë dhe po lexonte i qetë gazetën duke i lëvizur buzët parreshtur.

Jashtë zhurma sa vinte shtohet.

— Mor xhaxho — i foli plakut.

Ai nuk e dëgjoi. Andoni thirri më fort. Atëherë plaku ngriti kokën dhe e shikoi.

Çfarë po ndërtohet këtu përballë bibliotekës?

— Si the? — e pyeti plaku.

Andoni ja përsëriti pyetjen.

— Fabrika e niseshtesë — përgjegji atëherë ai me zë të lehtë, saqë Andoni mezi e dëgjoi.

Shkrimtari vuri buzën në gaz. Pastaj u ngrit

dhe mblodhi faqet e porsahapura të dorëshkrimit.
Para se të largohej ju kujtua diçka. Shkoi pranë tryezës ku rrinte nëpunësja e bibliotekës dhe e pyeti:

— Moj shoqe, a është akoma ajo kafeneja në të dalë të qytetit?

— Cila kafene? — përgjegji nëpunësja, një vajzë e ngjallur dhe me gërsheta të shkurtëra.

— Ajo kafeneja rrëzë malit — u mundua t'i spjegonte Andoni. — Ai vend më duket se quhej Guri i Verdhë. Hë, a është më?

— Tani e kuptova. Jo, nuk është më. Aty është ndërtuar një gurore e madhe, bile thonë se është gjetur edhe mermer.

Duke ecur nëpër rrugët e qytetit me dorëshkrimin në duar, Andoni e harroi fare punën e vet dhe gjithfarë mendimesh i vlonin në kokë. Atë e habitnin shumë ndërtimet në qytetin e vogël. Kudo vlonte puna dhe ngriheshin ndërtesa të reja dhe fabrika. Papandehur atij ju kujtua Fatimeja me sytë e saj të gjallë, me duart e fuqishme dhe vuri buzën në gaz.

Teksa ecte ashtu i kredhur në mendime, dëgjoi që dikush e thirri nga prapa. Ktheu kokën. Disa metra pas tij, pranë autobuzit, ishte Arqileja.

— Tungjatjeta — e përshëndeti Andoni, i gëzuar që gjeti një të njohur — Ç'kemi shoku gazetar, nga vjen kështu?

— Nga Korça. Po ti ç'bën këtu?

— Kam marrë lejen krijuese dhe po e kaloj këtu tek tetoja.

— Ke shkruar gjë?

— Mbrëmë kam ardhur, por me sa shoh nuk do të shkruaj shumë.

— Pse?

— Nuk e ke vënë re sa është ndryshuar ky qytet i vogël? — e pyeti Andoni.

— Po, ka ndërruar fare fytyrë, — përgjegji gazetari, pa e kuptuar mirë ku donte të dilte Andoni.

— Këtu, që thua ti, është shumë zor të gjesh një qoshe të qetë për të shkruar ditën.

— Atëherë ndërro orarin e punës.

— Ashtu kam menduar. Do të punoj natën.

U dëgjua boria e autobusit, që ftonte udhëtarët të hypnin.

Arqileja u përshëndet me Andonin dhe zuri vend brenda, aty pranë xhamit.

Teksa Andoni nisi të largohej, gazetari nxorri kokën nga dritarja dhe e thirri:

— Andon, na shkruaj një reportazh për gazetën tonë kushtuar qytetit N.

— Do ta shkruaj me gjithë qejf — përgjegji Andoni dhe pas pak shtoi — Dhe që tani mund të të them çfarë titulli do t'i ve.

— Ma thuaj.

— «Qyteti që kish humbur qetësinë».

Autobusi u nis duke lënë pas vetes një re të bardhë pluhuri.

VILA E VETMUAR

Unë, gati tri të katërtat e vitit rri në plazh. Vetëm në verë shkoj në qytet. Siç e shihni bëj të kundërtën e gjithë njerëzve. Që ta merrni vesh, jam rojtari i ndërtesave të plazhit, kur ato janë të zbrazura. Në verë, kur aty vinë njerëzit për të kaluar pushimet, unë shkoj në Durrës dhe drejtoria më cakton në një punë tjetër. Tre muaj me radhë nuk vë këmbë në plazh. Nuk më pëlqen. Ditën ka shumë zhurmë kurse netët janë të qeta. Në dimër ndodh e kundërta: ditët janë të qeta, kurse netët të mbushura me poteren e detit dhe me uturimën e erës. Pastaj, në verë aty ka aqë shumë njerëz, sa të mirren mend duke i shikuar. Në dimër plazhi është krejt i imi me shtëpitë e vilat, me pistat e kabinat. Më duket sikur edhe deti është i imi; ai flet vetëm me mua me zërin e tij të fortë, që herë duket se thërret i zemëruar. herë sikur qesh dhe vetëm kur është bunacë pëshpërit ngadalë, sikur do të më tregojë ca gjëra të fshehta që nuk duhet t'i dëgjojë bota.

Që ta merrni vesh, e kam shumë qejf këtë punën e rojtarit. Rri aqë me dëshirë në dimër, sa rrini ju në verë. Kur vini për të pushuar ju, e keni të vështirë të gjeni ndonjë dhomë apo kabinë,

kurse unë e zotëroj tërë plazhin dhe mund të banoj e të fle ku të dua. A e dini çfarë bëj? Një natë shkoj e flej në një vilë të vogël me verandë përpara, njëherë tjetër e kaloj natën në një kabinë, pastaj në një ndërtesë me dy kate që i ka shkallët nga prapa.

Nuk e merrni dot me mend sa gëzim ndjej kur futem në këto banesa. Nga gjërat që shoh brenda rri e vras mendjen për të gjetur kush ka banuar aty gjatë verës. Ja, ta zemë se sonte kam vendosur të fle te kjo vila bojëqielli me shkallë mermeri me grila jeshile. Hap derën dhe futem brenda. Në dhomën e parë shoh një revistë «Fatosi» gjysmë të grisur. Më tej janë disa kuti konservash dhe dy a tri shishe të vogla ilaçesh, nga të cilat ende kundërmon dhoma. Atëherë them me vete: «Këtu do të ketë banuar ndonjë familje me ndonji fëmijë dhe një plakë të sëmurë. Pastaj rrah mendjen për të gjetur sa vjeç ishte fëmia dhe çfarë temperamenti kish. Mundohem të gjej nga çfarë vuante plaka. Mbyll sytë dhe më duket sikur e shoh atë plakën me trup të vogël, që në netët e qeta rri e shtrirë në verandë, ndërsa djali flen dhe prindrit janë duke shëtitur në bregun e detit.

Me që e kemi fjalën për shëtitjet buzëdetit, duhet të them se edhe unë, kur është koh' e mirë, bares shpesh. Në rërën e lagur shoh vetëm gjurmë e hapave të mia që nuk përziejn me gjurmë të tjera. Kënaqem duke i parë dhe më duken si një varg i pandërprerë mendimesh.

Kur endem në rrugëzat e vogla në mes të vilave, shoh pemët dhe padashje vë buzën në gaz: kur në plazh vinë njerëzit dhe xhvishen, pemët

janë të ngarkuara me gjethe, tani në dimër që bën të ftohtë dhe nuk ka njeri, ato mbeten lakuriq. Duket sikur edhe ato bëjnë të kundërtën e njerëzve ashtu si unë. I shikoj të xhveshura, që dridhen e ankohen pareshtur dhe me gishtat e tyre të ftohtë e të hollë trokasin në xhamet e dritareve të vilave të zbrazura.

Sot isha në qytet dhe mora rrogën. U ktheva pasdite. Kam vendosur ta kaloj natën në një vilë të vetmuar, më pak të bukur se të tjerat. Është fillim nëndori. Bën ftohtë. Era fryn dhe deti i zemëruar përplaset në breg, klith pareshtur e nxjerr shkumë. Qielli është i errët, si fundi i një pusi. Asnjë yll në qiell. Asnjë dritë në plazh.

Po eci pak me mundim nëpër rrerën e lagur, për të shkuar te vila e vetmuar. Në dorë kam një pako. Brenda saj dy batanie dhe një jastëk.

Nxjerr çelësin për të hapur derën, por ve re se nuk është nevoja: dera e vilës është e hapur. E shtyj. Qëndroj një çast pa lëvizur. M'u duk sikur veshi më zuri një përshpëritje të lehtë. «Këtu pas-ka hyrë ndokush» mendova dhe thërrita:

— A ka njeri këtu?

— Asnjë përgjigje.

Dëgjohet vetëm uturima e detit që grindet me erën.

Thërras edhe njëherë:

— A ka njeri këtu?

Zëri im mbush dhomat, përplaset në muret e xhveshura, pastaj del jashtë, e merr era dhe e tret larg.

«Duhet të shikoj njëherë nëpër dhoma» them me vete dhe hap derën e parë në të djathtë.

Në katrorin e dritares së ndriçuar paksa shoh
nji hije.

— Kush je ti?

— Po ti kush je, rojtari? — pyet hija duke
lëvizuar nga vendi.

— Rojtari. Përgjigju: kush je ti dhe ç'bën
këtu?

— Unë dhe kjo vajza...

— Qenke me një vajzë këtu? — pyes prapë
unë.

— Po, me gruan time — përgjigjet prapë ai.
Heshtëm. Vetëm era dhe deti dëgjohen jashtë.

— Pse keni ardhur këtu? për të bërë banjo?
— pyes unë me tallje.

— Skënder, tregoji të vërtetën — foli vajza
me zë të lehtë po të vendosur.

Dhe Skënderi tha:

— Sot jemi martuar...

— Dhe vendosët që muajin e mjaltit ta kaloni
në plazh?

Ai bëri sikur nuk e kuptoi shakanë time dhe
tha:

— Kemi ngatërresa me familjet tona. Ata nuk
janë dakord për martesën tonë. S'kishim ku të
venim dhe erdhëm këtu për të kaluar natën.

Mua m'u zbut inati. U qetësova si deti në
muzgjet e verës. Vilat nuk kanë drita në dimër,
por unë m'bah me vete gjithmonë nga një llamba-
tinë për ta ndriçuar dhomën ku kam vendosur të
kaloj natën. Ashtu bëra edhe tani. Hypa mbi një
arkë që ishte në një cep dhe pas pak dhoma u
mbush me dritë.

— Në errësirë nuk bisedohet mirë — thashë
unë duke i shikuar dy të rinjtë. Por isha gabuar.

Përkundrazi, në errësirë, pa i parë fytyrat e njeri tjetrit sikur flitej më lirisht. Drita e papritur ja lbyri për disa çaste sytë dy të rinjve që rrinin të ngjeshur te muri dhe që më shikuan të çuditur.

Pasi vura re se nuk kishin ndërmend të hapnin gojë, foli i pari:

— Domethënë sot u martuat... Prej Durrësi jeni?

— Po! Ne të njohim ty — tha djali dhe vuri buzën në gaz. Pastaj për të ma mbushur mendjen shtoi:

— Përpara punoje në bankë dhe familja jote bañon në lagjen Varosh, apo jo?

— Djali i kujt je?

— I Zeqir Shutit.

Porsa përmendi atë emër, mua m'u kujtua ai mësuesi i gjatë me mustaqe të dendura, të zverdhura, që në ditët e ngrohta gjithmonë e gjen ulur në lulishte duke lexuar.

— Si është me shëndet Zeqiri?

— Tani është më mirë, por prapë zemra nuk e le të qetë. — Tha Skënderi dhe përsëri vuri buzën në gaz. E shikova me vemendje atë djalë me trup mesatar, me sy të ëmbël, që vazhdimisht ngrinte dorën e djathtë për të rregulluar tufën e flokëve që i binte mbi ballë.

— Po kjo vajzë kush është? — pyeta Skënderin.

— Jam e bija e Sotir Miços — foli ajo, megjithëse unë ju drejtova djalit.

— E Sotirit? — U çudita unë. E njihja mirë të jatin e saj, atë rrobaqepësin e çalë që punonte si privat në një dyqan të errët në të dalë të pazarit të vjetër. Ndërsa unë po sillja ndërmend Sotirin, Skënderi foli:

— Dashuria jonë nisi para një viti. Unë veja shpesh në dyqanin ku është shitëse Kristina. U dashuruam dhe vendosëm të martohemi. Folëm me prindërit por ata ishin kundër bashkimit tonë, për arsye të feve të ndryshme...

— Pastaj mua babai desh të më fejojë në Tiranë me një inxhinier të moçëm, dhe unë s'pranova... — Tha Kristina duke ja marrë fjalën nga goja djalit. E shikova për herë të parë me vëmendje atë vajzë: Ishte pak më e gjatë se Skënderi, me trup të hajthët dhe sy të ndritshëm që shikonin ngultas.

— U përpoqëm disa herë t'ja mbushnim mendjen — filloi të flasë përsëri ai. — Kur e pamë se nuk po nxirrnim gjë në dritë, vendosëm të martoheshim pa lejen e tyre dhe të iknim nga shtëpia. Sot i kërkova leje shefit të oficinës...

— Kurse unë kisha ditën e pushimit...

— Shkuam në gjendjen civile dhe bëmë celebrimin. — I dha fund tregimit Skënderi dhe përsëri bëri buzën në gaz.

Unë kisha dëgjuar i çuditur tregimin e tyre të thjeshtë dhe mendime të ngatërruar më vërtiteshin në kokë. Heshtëm prapë ne brenda, ndërsa jashtë u dëgjua i fortë dialogu i pandërprerë i erës me detin.

— A kishte menduar ku do të shkonit pas martesës? — Pyeta unë duke shikuar Kristinën.

— Jo — përgjegji me zë të qetë vajza.

— Nuk menduam fare për këtë — shtoi Skënderi — Donim të martoheshim dhe pikë. Vendi ku do të rrinim nuk kishte rëndësi.

Mua më bëri përshtypje të madhe mënyra si

ata e treguan historinë e dashurisë së tyre dhe vendosmëria për t'u bashkuar. Unë nuk jam më i ri dhe kam mendimet e mia për dashurinë dhe martesën, por duhet të pranoj se ata sikur ma mbushën mendjen. Për këtë ndihmoi mënyra e thjeshtë dhe fare e çiltër me të cilën ato treguan çdo gjë.

Papandehur mu kujtua diçka:

— Po plaçkat ku i keni?

— Plaçkat? — thanë ata të dy me një gojë dhe u shikuan në sy.

— S'kemi asgjë — tha pastaj Kristina.

— Përveç këtyre që kemi veshur — tha Skënderi buzagas.

Unë s'u mendova gjatë:

— Merrni këto dy batanie, jastëkun dhe flini këtu sonte — thashë unë duke u zgjatur pakon që mbaja në dorë. Pasi ata nuk u avitën për ta marrë, unë ja hodha në mes të dhomës.

— Po ti? — pyeti vajza.

— Kam dyshek e batanie në një vilë tjetër — gënjeva unë. — Flini sonte këtu. Nesër shohim e bëjmë. Natën e mirë!

U nisa të dal. Tek dera u ktheva. Ata nuk kishin lëvizur nga vendi. Rrinin gjithmonë të mbështetur tek muret e xhveshura të dhomës. Pakoja me batanie ishte në mes të dhomës. I shikova dhe për herë të parë qëkur u njohëm, vura buzën në gaz.

Tani që dola jashtë po më kujtohet se harrova t'u uroj martesën. «Nejse, këtë mund ta bëj edhe nesër» them me vete. Po eci dhe mendoj a duhet të njoftoj drejtorinë për këtë, apo më mirë ta le punën në heshtje. «Sonte po shkoj të flej. Kam kohë të mendohem nesër për këtë.

Eca disa metra dhe papandehur qëndrova e

ktheva kokën për të parë vilën. «Është e vetmja dritë në tërë plazhin» thashë me vete. Më duket sikur po i shoh përsëri dy të rinjtë të mbështetur në mur me pakon e batanieve në mesin e dhomës, ku do të kalojnë natën e parë të martesës së tyre.

Eci nëpër rërën e lagur, ndërsa deti uturin dhe era më pëshpërit në vesh fjalë të pakuptuara.

Pastaj i thashë vetes: Ç'bëhesh merak or plak për këta të rij punëtorë e plot shëndet, që e kanë sot të ardhmen të sigurt dhe s'i pengon dot asgjë që ta ngrejë jetën e tyre bashkëshortore ashtu siç duan.

NJË CIGARE NË ERRESIRË

Trokiti dera. Ishte një trokitje e lehtë por e pandërprerë dhe këmbëngulëse.

Dy vajzat, që po mblidhnin pjatat dhe pastro-
nin tryezat, bënë veshin e shurdhër.

Trokitja u përsërit pak më e fortë e gjithnjë
e pandërprerë, këmbëngulëse.

— Menca është e mbyllur. — tha Sania.

— Hapeni pak — u dëgjua një zë burri —
Isha në punë deri tani. Do të ha darkë shpejt.
Hapeni, dreqi e marrtë!

Të dyja vajzat ja njohën zërin, por nuk u shi-
kuan në sy, as folën. Edhe trokitja pushoi për një
çast. Në mendje u dëgjua vetëm zhurma që bënin
pjatat duke u përplasur me njëra tjetrën.

— Si thua, Shkurtë, a t'ja hapim? — Pyeti
Sania shoqen e vet. Por tjetra nuk foli. Mori sërën
e pjatave dhe me krahët e shtrirë, tru-
pin drejt e kokën pak të përkulur përpara, shkoi
në kuzhinë.

Qëndroi aty para grumbullit të pjatave duke
dëgjuar zhurmën e parreshtur e si të përgjumur të
rubinetit të ujit. Pastaj u shkund dhe me shpinën
e dorës rregulloi flokët.

Kur u kthye në sallën gjysmë të errësuar të
mendës, vuri re Gjelokun të ulur në vendin e tij
të zakonshëm.

— Mirëmbërëma, Shkurtë — e përshëndeti ai kur ajo i kaloi pranë.

Vajza nuk ju përgjegj. Shkoi në tryezën më të largët të menciës, atje ku ishte errësirë. U ndal para tryezës. Ja nguli sytë dritares dhe dëgjoi zukatjen e pandëprerë të mizave mbi xhamat e dritareve dhe sipër pjatave të zbrazura.

Duke shkuar përsëri në kuzhinë, Gjeloku i tha:

— A po më jepni të ha?

— Po pranoi kuzhinieri.

— Thuaji se isha në punë deri vonë, dreqi e marrtë!

— Nuk është hera e parë kjo.

— Kështu është puna jonë.

— Po menca ka orar.

Dhe si tha këto fjalë, lëvizi nga vendi. Ai i foli nga prapa:

— A të pres apo jo?

Kur hyri brenda, i tha Sanies pa e shikuar:

— Jepi të hajë.

— Ty ta dëgjon fjalën plaku — u përgjegj tjetra duke shikuar nga e ndara me xhama.

— Unë po marr gjellën, ti çoja.

— Ke frikë të flasësh me të?

Në vend që t'i përgjigjej, Shkurta shkoi dhe trokiti te xhami i së ndarës.

Kur djaloshi e pa që ajo i solli gjellën, i ndriti fytyra. Por kjo zgjati vetëm një çast, sa flaka e një shkrepseje. Ai u ngrys menjëherë dhe i tha:

— Pse sille kështu me mua, Shkurtë?

Ajo shikonte pjatën që i solli dhe copën e mishit mbuluar me lëng të trashë, plot yndyr.

— Deri kur do të vazhdosh të sillesh kë-shtu?

— Unë sillem me ty si me të gjithë...

— Kjo më mundon. Si me të gjithë... E pra ne të dy, dikur.

— Dikur... — përsëriti ajo me zë të lehtë, si jehonë e largët.

— Dikur por unë edhe sot...

— Dëgjo — desh të thotë «Gjelok» por qëndroi. — Dëgjo, patëm ç'patëm, ajo punë u mbyll. Këto gjëra janë si buka: po u thye njëherë, nuk ngjitet më.

— Po pse, e marrtë dreqi, pse? Unë gabova, e di... Por kur njeriu e kupton gabimin dhe pendohet, duhet falur... Po gabova, e marrtë dreqi! Por nuk e bëra me mendje të keqe. U frikësova, më hyri lepuri në bark. Isha shumë i ri, atëherë... Pastaj më morën ushtar dhe...

Shkurta i kishte dëgjuar me dhjetra herë ato fjalë. Gjeloku çdo darkë vinte për të ngrënë më vonë se të tjerët, atëherë kur menca ishte e zbrazur dhe kur brenda dëgjohesh zhurma e pjatave dhe zukatja e mizave.

— Kur do të bisedojmë njëherë mirë e me zemër në dorë? — pyeti ai pas një heshtjeje dhe zëri i tij u bë i butë, gati lutës.

— Për çfarë?

— Si për çfarë? — mori zjarr ai. — Po për punën tonë, dreqi e marrtë. Ti e di, unë për ty erdha të punoj këtu në minierë. Për ty duroj fjalët e ngasjet e shokëve. Se unë edhe sot të...

Shkurta nuk foli. Duart e saj të mëdha, të ashpra ishin mbështetur në cepin e tryezës dhe qëndronin aty pa lëvizur.

— Si thua, Shkurtë?

— Ta kam thënë sa herë. Ti po troket në derën e shurdhit tha vajza duke u shkëputur nga tryeza.

— Iku? — pyeti Sania që lante pjatat.

— Aty është, — u përgjegj Shkurta dhe nisi të lajë pjatat.

— Të tha gjë?

— Fjalët e përnatshme.

Dhe heshtën të dyja e vazhduan të lajnë pjatat.

Sa herë që e shikonte dhe bisedonte me Gjelokun, Shkurta ndjente një turbullim të paspjegueshëm. Shkak ishte, ndoshta, kujtimi i lidhjeve që ajo kishte pasë dikur me të. Njiheshin që fëmijë. Bashkë kishin bredhur shpateve e rudinave. Duke u rritur, miqësia e tyre kishte marrë një drejtim tjetër dhe ata kishin ndjerë dridhjet e para kur i bashkonin duart ose shiheshin në sy. Ishin dashuruar në heshtje dhe dashuria e tyre kishte qenë e fortë, e dlirot dhe e thjeshtë si lulet e bjeshkëve. Kur i ati i kishte thënë asaj se e kishte fejuar me Nikën, ajo përnjëherësh e kishte kundërshtuar. Të nesërmen kishte ikur nga shtëpia dhe ishte takuar me Gjelokun, duke ja treguar punën fill'e për pe.

— Si t'ja bajmë? — kishte pyetur ai në fund.

— Bëj çfarë të duash me mua. Jam në dorën tënde.

— Ti nuk duhet të kishe ikur nga shtëpia

— Të merrja Nikën?

— Jo, por...

Shkurtën e kishte pushtuar frika. Por vetëm një çast. I kishte thënë:

— Merrmë me vete. Më ço ku të duash. Unë vij. Me Nikën nuk martohem, edhe sikur ti...

— Ç'flet kështu, Shkurtë?

Në fund ai i kishte dhënë fjalën se do të mudohej të gjente një rrugëdalje. E kishin lënë të takoheshin në mbrëmje vonë, po ai nuk kishte shkuar as atë ditë, as të nesërmen. Ajo nuk e kishte takuar më. Disa net me radhë ishte endur e dëshpëruar. Pas disa ditësh kishte marrë vesh se ai kishte vajtur ushtar. Pabesia e tij kishte genë grusht i rëndë për të, grusht dërmues. Pas kësaj ajo kishte flakur tej dëshpërimin e dashurinë dhe e kishte shikuar të vërtetën në sy. Në shtëpi nuk donte të kthehej e as që mund të kthehej, se i jati me siguri nuk e pranonte. Atëherë kishte marrë rrugën dhe kishte zbritur në qytetin e vogël të minatorëve. Një bashkëfshatar i saj kishte ndërhyrë dhe Shkurtën e kishin marrë në punë aty në mencë. Në fillim e kishte patur të vështirë se ishte vajzë e re, e bukur dhe punonte në një vend ku kishte punë vetëm me meshkuj. Por pak nga pak ishte mësuar. Minatorët, që vinin në mencë të lodhur, dhe hanin me uri të madhe, e kishin bërë vajzën për vete dhe ajo kishte nisur t'i dojë ata njerëz të potershëm, që flitnin me zë të lartë dhe i lëviznin duart parresh-tur. Që në fillim asaj i kishte bërë përshtypje dhe e vinte buzën në gaz sa herë i shihte minatorët duke kapur copat e bukës. Duart e tyre të mëdha, të ashpra, të fuqishme që ishin mësuar të kapnin nëpër galeri copat e mineralit, kur merrnin bukën, u dukej si një lojë fëmijësh dhe e thërmonin që në shtrëngimin e parë. Kur pastronte tryezat, ajo vinte re se aty kishte një mori thërmijash.

Në fillim disa e kishin ngacmuar. Ndonjeri edhe kishte kërkuar të martohej me të. Por ajo heshte. Fytyra e saj e bukur por e mbyllur, sytë e mëdhenj, të ftohtë të bënin menjëherë të heshtje dhe në atë fytyrë nuk mund të lexoje gjë ashtu si mbi një fletë të pashkruar. Por shpejt të gjithë e kishin lënë të qetë dhe silleshin me të si me një shoqe. Të gjithë e merrnin me mend se ajo diçka kishte pësuar në jetë, por çfarë, askush nuk e dinte, se ajo kurrë nuk fliste për jetën e vet.

Pak nga pak plaga e saj kishte zënë kore. Puna në mencë, miqësia me Sanien, njohja e shumë gjërave të reja, ndjekja e shkollës, i kishin dhënë çaste gëzimi. Vetëm malli për shtëpinë, kujtimi i pabesisë së Gjelokut herë pas here e bënin të zymtë e të heshtur.

Pas tre vjetësh kishte ngjarë diçka e papritur: Në qytetin e minatorëve kishte ardhur Gjeloku. Ai posa ishte liruar nga ushtria, kishte pyetur për Shkurtën dhe, kur kishte marrë vesh se ajo nuk rrinte më në fshat, ishte nisur ta kërkojë dhe e kishte gjetur në qytetin e minatorëve. Ajo ishte tronditur kur e kishte takuar përsëri, pas aq vjetësh, të hequr, të rritur e të penduar. Por që në fillim ja kishte prerë shkurt: buka e thyer nuk ngjitet më. Fjalët e tij për ta falur, pranimi i fajit, pendimi i tij nuk e kishin zbutur zemrën e Shkurtës. Ai kishte hyrë në punë aty, e ndiqte pas çdo ditë, çdo natë vinte e fliste me të në mencë dhe çdo natë sillej nën shtëpinë e saj.

— A mbarove? — u dëgjua zëri i Sanies.

— Këto janë pjatat e fundit — tha Shkurta dhe lëvizi shpejt duart.

Kur dolën nga menca për të shkuar në dho-

mën e tyre të vogël, të ndërtesës së re prapa drejtorisë, qyteti i vogël ziente nga jeta. Nga galeritë që përshkonin malin vinte herë pas here një zhurmë e mbytur, që përhapej në natën e qetë. Pak më tutje dëgjohej uturima e ndonjë kamioni. Në rrugë lëviznin njerëz që vinin ose shkonin në minierë. Nga dritaret e hapura atë mbrëmje pranvere dëgjohej muzika e radiove, thirrjet e fëmijëve dhe të qeshura.

Para se të hynin në shtëpi, të dy vajzat, ashtu si çdo natë, kthyen kokat. Pas tyre panë hijen e një burri dhe zjarrin e kuq të një cigareje që ndizej e shuhej si një yll i largët.

— Unë nuk kam gjumë — tha Sania duke u lëshuar me gjithë rroba në shtrat — A rrimë pak në ballkon. Këto netët e pranverës...

— Të kujtojnë të fejuarin?

— Lere të qetë atë. Kushedi ku do të jetë duke udhëtuar sonte. Bëftë natën e mirë! — tha Sania duke kryqëzuar duart pas zverkut dhe psherëtiu.

Shkurta përshkoi dhomën dhe u mbështet te dera e ballkonit. Era e freskët e natës ja përkëdheli fytyrën si një dorë e butë dhe diç i pëshpëriti në vesh. Ajo këqyri në errësi. Në cep të ndërtesës që ish përballë shtëpisë së tyre, shquajti hijen e një burri dhe zjarrin e një cigareje që herë bëhej më i fortë dhe herë dukej sikur shuhej.

— Aty është ai? — e pyeti Sania gjithnjë e shtrirë në shtrat.

— Aty — përgjegji Shkurta dhe padashje psherëtiu lehtë lehtë, që të mos e dëgjonte Sania.

DUKE UDHËTUAR NATËN

Pasi kaloi Milotin, Ademi këqyri orën: Ishte tetë e gjysmë. Duhet t'ja shkel që të jem në Durrës para njëmbëdhjetës, tha me zë dhe i mëshoi gazit. Skoda e ngarkuar me krom shtoi shpejtësinë, xhamat e kabinës nisën të dridhen e rrotat fishkulluan duke u fërkuar në asfaltin e zi të rrugës. Dritat, si dy shtiza të zjarra çanin errësirën dhe zhurma e maqinës dëgjohej deri larg në fushat e përgjumura duke prishur qetësinë e asaj mbrëmje shtatori. Në një kthesë Ademi pa një çoban me një tufë të vogël delesh. Ngadalësoi shpejtësinë dhe pas pak qëndroi disa minuta. Delet e trembura nga dritat e zhurma e maqinës nisën të rëndin duke u strukur pas njera tjetrës.

Po ky ç'bën kaqë vonë me këto dele, tha Ademi përsëri me zë dhe nisi kamionin. E kish zakon që, kur udhëtonte dhe ish vetëm, shprehte mendimet me zë. Kjo sikur ja hiqte pak përshtypjen e vetmisë dhe i dukej sikur i fliste ndonjerit. Kish gati njëzet vjet që ngiste maqinën dhe që në fillim e kish bërë zakon të fliste me vete. Këtë e bënte sidomos natën kur ish i lodhur dhe ndruhej mos ta zinte gjumi.

Pasi u largua edhe ca nga Miloti, Ademi vuri re larg, përpara vetes një njeri. Kur u avit pa se

ish një vajzë e veshur me pardesy që mbante në dorë një valizhe. Ajo i bëri shenjë të qëndrojë. Skoda ngadalësoi ecjen derisa u ndal. Shoferi uli xhamin dhe nxorri kokën.

— Ku shkon? — pyeti ajo pasi u afrua.

— Në Durrës. Po ti për nga udh'e mbarë?

— Dua të vete në Tiranë. Sikur të vi me ju deri në Vorë a mund të gjej maqinë për në Tiranë?

— Pak zor se është vonë. Megjithatë nuk i dihet. Fundi mund të qëndroj edhe unë ca kohë e të të ndihmoj të gjesh maqinë.

— Ju falemnderit! — Tha ajo dhe s'luajti nga vendi.

— A do të vish? — E pyeti pas pak Ademi.

— Mirë.

Ai zgjati trupin dhe hapi derën në të djathtë të tij. Vajza hypi dhe e vuri valixhen në mes të këmbëve.

— Mos i beso derës. Kujdes, mos u mbështet se nuk të mban. — Tha Ademi dhe i dha gaz maqinës. Skoda u shkund e zuri të ecë.

Ç'bën kjo grua kaqë vonë, tha me vete Ademi, ka veshur pardesy dhe ka valixhe. Duket menjëherë se është nga qyteti. Në fytyrë ish pak si e vrrarë. Kushedi se ç'hall ka. Po hajt ta marrim vesh cila është dhe si e ka punën.

Nxorri paketën e cigareve dhe, duke mbajtur me një dorë timonin, ndezi çakmakun. Flaka e vogël ja ndriti një çast shuplakën e madhe plot kallo dhe fytyrën e zeshkët e të parruar.

— Paske zgjedhur orë të keqe për të udhëtuar. — Tha ai duke thithur thellë cigaren.

Ajo nuk foli. Shoferi ktheu kokën dhe e shi-

koi. Vajza ja kishte ngulur sytë rrugës si e tretur në mendime. Kish profil të bukur, flokë të zes, të shkurtër e fytyrë pak të imët e të zbetë.

— Sa është ora, ju lutem? — pyeti papritmas vajza pa e kthyer kokën.

— Nëndë pa një çerek.

Ajo uli kokën dhe ai vuri re se zuri të kurdisë një orë të vogël dore.

— Të është prishur ora? — pyeti Ademi duke vënë buzën në gaz.

— Ka ca kohë që nuk më vete në rregull. — u përgjegj ajo dhe pas pak shtoi duke ndërruar zërin — Në fshat u shkatërrova edhe unë e jo ora!

— Pse në fshat banon? — e pyeti menjëherë Ademi për të vijuar bisedën.

— Po, në fshatin që kaluam. Aty është agrom burri im.

— Ke shumë kohë që je aty?

— Dy muaj. Merre me mend, akoma s'kishim mbushur muajin qëkur u martuam kur burri im u transferua në fshat. Ai më mori me vete që të gëzoj edhe unë bukuritë e rralla të fshatit.

— Peri shkon pas gjilpërës. — tha Ademi.

— Jo gjithnjë. Fshati është i bukur vetëm në përshkrimet e poetëve. Unë jam rritur në Tiranë, jam mësuar me jetën e kryeqytetit dhe të shkoj e të mbytem në fshat do të thotë të varros veten për së gjalli.

— Po e zmadhon pak si shumë. — tha Ademi pa u tallur. Ndjeu se e mbuloi një valë inati për ato fjalë. — Vërtet fshati nuk është si qyteti por s'është edhe ashtu si thua ti, varr. Fshati ku je ti ka dritë, dyqane dhe rrugën automobilistike, është pranë e mund të shkosh në Tiranë sa herë të merr

malli për prindët, për bulevardet. Ja, kështu si paske bërë sonte.

— Po, kështu si bëra sonte, — tha ajo me zë të mekur sikur të fliste me vete.

Duke gumëzhitur rëndë, Skoda përpinte rrugën e gjatë dhe po i avitej Fushës së Krujës. Ademi shtrëngonte fort timonin, sytë i mbante të ngulur përpara dhe me mend përtypte bisedën që kish bërë me vajzën.

Qënka mërzhitur nga fshati, nusja, mendonte Ademi, këtë hall paska. Në fillim pandeha se është ndonjë vajzë e heshtur, e mbyllur por sa e ngacmova pak ajo nisi t'i thotë të tëra. Mundet që këtë e bën që të shfrej. Ku ta dish. Epo derisa është gati të flasë, le ta vijojmë bisedën e të shohim si ka vajtur puna më tej.

— Ke kohë pa vajtur te prindët? — e pyeti Ademi.

— Pardje u ktheva nga Tirana.

— Pardje, dhe sonte po vete përsëri? Të paska marrë malli shpejt.

— Sontë? — tha ajo duke shqiptuar këtë fjalë në një mënyrë të çuditshme. Heshti pak, pastaj zu të flasë me zë të ulët, pa u ngutur dhe duke i shkoqitur fjalët mirë: — Sontë u luajt akti i fundit i një drame që ka nisur para dy muajsh. Qëkur erdha në fshat nisa të grindem me burrin tim. Ai s'bënte asnjë përpjekje për t'u larguar nga fshati. Mendohej të më qetësonte, të më bindte se nuk jemi keq, madje më propozoi të futem në punë, të bëhem mësuese në shkollën e fshatit. Unë, natyrisht kundërshtova. Qëkur kam vajtur në fshat jam shkatërruar nga nervat e nga shëndeti. Pardje isha në Tiranë dhe fola me babanë tim. Ai

është avokat dhe më tha të bind burrin të bëjë lutje dhe, po të ketë mundësi, të nxjerrë edhe ndonjë raport nga doktori. Në këtë mënyrë mund të shpresoj se do ta transferojnë. Mirëpo, i mbushet mendja tim shoqi? E ka kokën shkëmb. Sonte fola përsëri me të për transferimin, por ai nguli këmbë në të tijën. Ju luta, u përpoqa ta bind, i përmenda dashurinë tonë. Asgjë. Atëherë mora valixhen, i thashë se do të kthehem te prindët dhe midis nesh ka marrë-fund çdo gjë.

Heshti. Ademi nuk ktheu kokën për ta shikuar dhe fytyra ju ngrys. Udhëtuan ca kohë në heshtje. Pasi kamioni kaloi Urën e Zezë dhe po i avitej Vorës, Ademi nisi të flasë me zë të trashë e të thellë:

— Dëgjo, shoqe. Unë vetë nuk kam grua. Ajo më ka vdekur tre vjet pasi u martuam. Puna e shoferit është e rëndë. Një herë në shtëpi dhe më shumë jashtë. Shpesh kthehesh vonë. Megjithatë ajo gjithmonë më priste dhe gjatë viteve që jetuam bashkë kurrë nuk u ankua, kurrë nuk më tha një fjalë të vrazhdët. Në udhëtimet e mia të vështira, në netët pa gjumë që kaloja në timon, në mot të mirë, apo në tufan, gjithmonë unë e ndjeja pranë gruan time dhe mendimi i saj më jepte forcë dhe më ngrohte. Lumturia bashkëshortore nuk është vetëm qëndrimi në qytet, shetitjet, rrobet e bukura, por është diçka tjetër më e thjeshtë, më e madhe, më e thellë.

Ndezi cigaren dhe e hoqi thellë disa herë me radhë. Larg u duk një dritë që vinte duke u zmadhuar. Ishte Vora. Ademi ngadalësoi dhe frenoi.

— Arritëm. Zbrit — tha ai pa e shikuar vaj-

zën dhe pa i hequr duart e tij të fuqishme nga timoni.

Ajo hapi derën duke e shikuar me habi dhe pasi zbriti tha:

— Nuk po qëndroni pak? Më premtuat se do të më ndihmoni që...

Zhurma e Skodës që u nis menjëherë nuk i la të dëgjohen fjalët e tjera. Vajza e veshur me pardesy e me valixhe në dorë, mbeti aty vetëm, në mes të rrugës e mbështjellur nga hijet e natës.

NUK JANË FJALË TË SHKRUARA MBI RËRË

Leka nuk donte që Lumtoja ta shihte atë film. Siç i kishin thënë, ngjarjet e filmit zhvilloheshin në një kamp përqëndrimi. E shoqja kishte qenë dy vjet e internuar në Gjermani dhe po të shihte filmin do t'i zgjoheshin sërish kujtime shumë të hidhura. Leka kishte vënë re se edhe sot e kësaj dite Lumtoja herë herë bënte gjumë të shqetësuar e zgjohej e trembur në mes të natës. Atij i kujtohej mirë viti i parë i martesës. Atë kohë ajo kishte gjashtë muaj që ishte liruar nga kampi dhe çdo natë, për shumë muaj me radhë, thërriste në gjumë, qante ose dridhej si ta përshkonte ndonjë rrymë e vazhduar elektrike.

Jo, nuk bën ta shohë, vendosi ai duke u larguar nga reklamat.

Kur hyri në shtëpi e gjeti Lumton llërëpërveshur duke gatuar. Me të ishte teto Nica, komshia e tyre plakë.

— E thirra teto Nicën të mbajë vajzat sonte.
— tha Lumtoja.

Leka e shikoi.

— Preva dy bileta për kinema — tha ajo duke i hedhur një dorë kripë gjellës — më thanë se është film i bukur.

Ai heshti. Pastaj shtoi:

— Sonte në darkë duhet të takohem me një shok — e gënjeu — E lemë për një ditë tjetër.

— Ke kohë edhe për njerën edhe për tjetrën. Biletat i kam marrë për orën gjashtë. Me shokun takoju ose para ose mbas filmit.

— Është puna se i dhashë fjalën — u mundua të shpëtojë Leka. «S'keq ungatërrua puna,» mendoi ai, «Lumtoja do të ngulë këmbë dhe po nuk shkuam në kinema, asaj do t'i mbetet qejfi.»

— Nuk e besoj të jetë ndonjë gjë me rëndësi të madhe takimi që ke — tha ajo duke e shikuar të shoqin me vemendje. «Mos vallë i ka ngjarë gjë? Fytyra e tij nuk më duket e qetë dhe e çelur si gjithnjë. Mbase ai më fsheh diçka.»

— Por në qoftë se ti nuk ke qejf, e lemë — shtoi pastaj.

Nga mënyra si tha këto fjalë, Leka e kuptoi se i kishte mbetur qejfi.

— Mirë moj grua, shkojmë. Takimin do ta shtyj. — Pranoi ai dhe nderi cigaren. «S'kam si t'ja bëj. Nuk mund t'i them asaj se filmi tregon jetën në një kamp përqëndrimi dhe nuk bën ta shohë. Ajo nuk tregohet kurrë e dobët dhe fjalët e mia do ta fyenin».

Lumtoja vijoi punën. Leka shkëmbeu dy fjalë me teto Nicën. Pastaj kontrolloi një problem aritmetike që kishte zhvilluar Flutura, vajza e tyre nëndë vjeçe.

* * *

Para kinemasë arritën në gjashtë pa dhjetë. Të dy kishin veshur pardesytë, se ajo mbrëmje vjeshte ishte plot lagështirë dhe në qiell endeshin

tufa reshë të zeza. Para hyrjes kishte njerëz që kërkonin bileta.

— E shikon? — tha Lumtoja me gëzim — Njerëzit akoma kërkojnë bileta. Kjo tregon se filmi është i bukur.

Ai nuk u përgjegj.

Lumtos i bënte përshtypje heshtja e tij atë pasdite. Nja dy-tri herë ishte matur ta pyesë pse rrinte fytyrëngrysur. «Ku ta dish» mendonte ajo «mbase ka ndonjë arësye që lidhet me punën e tij. Derisa ai nuk tregon vetë, unë s'kam përse ta pyes».

Filloi filmi. Kuadrot ndiqnin njeri tjetrin me shpejtësi. Pasi nis lufta dhe filmi paraqet betejat e para të Ushtrisë së Kuqe kundër gjermanëve, Lumtos padashje ju kujtua Vasja, ushtari sovjetik që kishte hapur i pari derën e kampit të përqëndrimit. Ai ishte një burrë trupshkurtër, fytyrëshkur, me një palë mustaqe të mëdha, të verdha. Lumtoja ashtu si të tjerët i ishte hedhur ushtarit duke e përqafuar, duke e puthur me zjarr e dhur nga liria, gëzimi, shpresa.

Leka e shikoi Lumton me bisht të syrit. Në errësirën e sallës nuk ja dalloi dot shprehjen e fytyrës. Duke përfutur nga një heshtje, mbajti vesh për të dëgjuar frymëmarrjen e saj: Ju duk e qetë. U lehtësua. Por vetëm për një çast. Mendoi: «Ky është fillimi i filmit. Duhet parë çdo të bëjë ajo pastaj, kur...»

Një lëvizje e Lumtos ja këputi fillin e mendimeve. Dora e saj e vogël u mbështet mbi dorën e tij. Gishtat e saj të butë fërkuan disa çaste dorën e tij të madhe, të mbledhur grusht. Pas pak Leka e hapi grushtin dhe dora e saj, si një zog i droj-

tur, sikur u qetësua brenda dorës së tij të fuqishme dhe nuk lëvizi më.

Ja, filmi paraqet si robërit i futën në një kishë të vjetër. «Neve, pasi na zunë rob, na futën në një ahur të madh» ju kujtua asaj. «Kishim ecur dy ditë me tren nëpër Jugosllavi. Arritëm në kufirin austriak. Aty na zbritën, na futën në një ahur të madh ku kaluam natën.» Asaj ju zgjuan kujtimet me një qartësi të habitshme: Ju duk sikur dëgjoi jo vetëm thirrjet e çjerra të grave, kërcënimet e rojeve por edhe kundërmimin neveritës të ahurit të madh, të errët, të frikshëm.

Leka ndjeu se dora e së shoqes e shtrëngoi dorën e tij. Dhe ai shtrëngim fliste më shumë se fjalët. Ai e kuptoi se Lumtos i ishin zgjuar kujtimet dhe shqetësimi po i shtohet, po i shtohet si rritet vala kur i avitet bregut. e shtyrë nga kamxhiku i erës.

Pastaj filmi tregonte si robërit i hypën në tren dhe i çuan në kampin e përqëndrimit. Ja, ata arritën. Muzikë shurdhuese, zhurmë, shtyrje, urdhëra...

...«Ne arritëm në kamp një ndajnatë pranvere». «Pranvera në Gjermani na u duk ahere e shpëlarë, pa dritë e ngrohtësi. Nuk e di, atje pranvera është vërtet e tillë, apo ashtu na u duk neve. Na zbritën nga treni duke na shtyrë. Një zë i çjerrë, nga një altoparant i padukshëm, shpërndante urdhëra e thërriste, thërriste, thërriste. Unë isha zënë përdore me Sanien, një vajzë nga Vlora dhe bashkë me gratë e tjera të mbledhura grumbull ecnim andej këndeje të shtyrë nga rojet si një re që era e degdis tutje nëpër hapsirë të qiellit. Bëmë banjo, pastaj na rreshtuan, na thirrën em-

rat dhe na shpërndanë nëpër ca baranga të gjata, të zeza që shëmbëllenin si qivurë. Kështu nisi jeta e kampit».

Leka e shihte filmin pa vemendje. Sytë vërtet i kishte të ngulur në ekran por mendjen nuk e kishte aty. Vemendja e tij ishte përqëndruar te dora e Lumtos që ja transmetonte shqetësimin e saj. Ja, ai ndjeu se ajo nisi të bëhet më e nxehtë dhe të djersijë. Atij ju duk sikur ndjeu duke rrahur një damar. «Këto nuk janë shenja të mira», mendoi ai. «Tani filmi mund të paraqesë skena më të tmerrshme të mizorive të kampit dhe atëherë... Si t'ja bëj? T'i them të ngrihem i se më dhemb koka? S'është mirë. Ajo do ta kuptojë».

Donte të kthente kokën e ta shihte fytyrën e saj, por nuk lëvizti. «Asgjë më mirë se dora e saj nuk ma rrëfen trazimin që po ngjet në shpirtin e saj».

Lumtoja ja kishte ngulur sytë perdes dhe e ndiqte filmin me shumë vemendje. Por shpesh fytyrat në ekran i mjegulloheshin e aty dilnin fytyra të tjera, të hequra, të verdha ku ndrinin vetëm sytë. Ja, Zhana, francezja e vogël me sy të kaltër, Anita nga Parma, Sasha nga Kievi, Milena nga Bullgaria, Stefania nga Varshava. Në mes të atij grumbulli me fytyra femrash, ishte një fytyrë burri, e gjatë, gjithnjë e rrojtur me kujdes e me një blanë që i niste poshtë syrit të djathtë e zbriste deri te mjekra. Ai ishte komandanti i kampit.

«Një ditë komandanti na rreshtoi para barangave. Pastaj thirri një numër dhe Sania që ishte në krahun tim, doli përpara. Fytyra e saj ishte e qetë dhe e ashpër. Komandanti nisi të thërrasë me sa

zë kishte. Ne e dinim si ishte puna. Në mëngjes, duke vajtur në punë, Sania kishte kënduar një këngë partizane. Rojet i kishin thënë komandantit dhe ai aty para gjithë kampit i bëri gjyqin. Gjithnjë duke thirrur, njeriu me fytyrë të rrojtur e me blanë, nxori revolverin dhe e qëlloi katër herë. Sania qëndroi një çast pa lëvizur, sytë ju zmadhuan, ju egërsuan dhe ajo u rrëzua përtokë përnjëherësh, pa e thyer trupin, e drejtë si një lis».

Edhe Leka provonte në këto çaste diçka të çuditshme. Kur qëllonte që përqëndrohesh duke parë filmin, vinte re se fytyrat e ekranit i mjegulloheshin dhe ai shihte gra të hequra në fytyrë, skelete që mezi qëndronin në këmbë dhe në mes të tyre shih-te Lumton, të heshtur, të qetë, me sytë e mëdhenj gështenj që i digjeshin nga ethet. Ai nuk e njihte jetën e kampit dhe nuk mund të ndjente atë që ndjente e shoqja, por bashkëjetesa me të, tregimet e saj, sikur e bënë në një farë mënyre edhe atë pjesëtar. Pastaj, dora e saj e nxehtë e dirsur, i transmetonte atij një pjesë të ndjenjave e mendimeve, një pjesë të atij trazimi të madh që ngjiste në shpirtin e së shoqes.

Filmi po mbaronte. Ja tani ai paraqiti fundin e luftës. Heroi lirohet nga kampi dhe kthehet në shtëpi.

«Unë jam kthyer një ditë vere, ju kujtua Lumtos. «Sa më shumë që i avitesha qytetit tim, gëzimi pakësohej dhe ja lente vendin shqetësimit. Mendoja parreshtur për nënën dhe për dy motrat që kisha tre vjet pa i parë. Lufta kishte kohë që kishte mbaruar, por plagët e saj shiheshin kudo: në rrugë, në shtëpi e sidomos në zemrat e njerëzve. Arrita në rrugicën time të qetë e të ngushtë. Aty një fëmijë

po luante para një dere, një plakë po rrinte në dritare. Trokas në derën e shtëpisë sime. Heshtje. Trokas përsëri pak më fort. Hapet një dritare e një zë gruaje flet diçka. Pas pak dëgjoj një hap të shpejtë që i avitet derës dhe e hap. Ishte motra ime e madhe. Një klithmë, zhurmë, klithma të tjera. Gratë e komshive lanë punët dhe u grumbulluan para derës sonë. Në krye të shkallëve takova nënën. U lëshuam në krahët e njera tjetrës. Nuk më kujtohen fjalët që i thamë njera tjetrës. Madje më duket se nuk folëm fare. Vetëm qamë. Kështu filloi jeta ime e re. Në vendin tonë çdo gjë ishte e re, çdo gjë lindte për ditë. Edhe mua ashtu m'u duk vetja: një njeri i lindur përsëdyti. Jeta më joshi, më rrëmbeu me fuqi të jashtëzakonshme. Dhe unë doja të jetoja me gjithë shpirt, në mënyrë sa më dendur sikur doja të fitoja ato dy vite të humbur, të llahtarshëm. Pas disa muajsh u njoha me Lekën. Atë kohë unë punoja në organizatën e gruas. Njohja me të më zgjoi në shpirt një ndjenjë të re, të paprovuar deri atëherë, më zgjoi dashurinë që më përtëriu edhe më shumë e më zbuloi para syve jetën më të bukur e më të thellë. Pas dy muajsh u martuam dhe pas një viti lindi vajza jonë e parë».

* * *

Kur mbaroi filmi e u ndezën dritat, Leka u ngrit në këmbë i pari. U kthye ta ndihmojë Lumton që të veshë pardesynë dhe hetoi me vemendje fytyrën e saj. Sytë i ndrinin por ai nuk shquajti në to gjurmë lotësh.

Rrugën nga kinemaja në shtëpi e përshkuan në heshtje. Rrugët e qytetit ishin të mbushura me njerëz dhe dritat e vitrinave lëshonin reflekse mbi asfaltin e zi të rrugëve. Frynte erë dhe qielli ishte i zi sterrë.

Kur hynë në shtëpi, teto Nicën e gjetën duke arnuar një çorap, Fluturën duke lexuar.

U shtruan të hanë. Shkëmbyen pak fjalë me të bijën për filmin, pastaj në dhomë pllakosi heshtja. Dëgjohej vetëm zhurma e lugëve dhe e pirunjive. Leka hapi radion. Tirana jepte lajmet e orës njëzet.

Të gjithë dëgjonin në heshtje. Ndërmjet të tjerash, folësjë e radios tha:

«Këto ditë u muar vesh se në Bon autoritetet e Republikës Federale nxorrën të pafajshëm ish oficerin nazist Otto Kyler, drejtor i një kampi për qëndrimi gjatë luftës së dytë botërore».

Leka uli lugën. «Edhe kjo duhej. Nuk mjaftoi filmi por ja tani dhe ky lajm».

Kur dëgjoi lajmin, Lumtos ju duk sikur e kishte dëgjuar atë emër. Kur ishte në Gjermani, ajo nuk e dinte si e kishte emrin drejtori i kampit ku qëndroi ajo e mbyllur, por, duke dëgjuar emrin Otto Kyler, ajo sepse besoi që ai ishte pikërisht drejtori i kampit të saj.

Kur e pa ashtu të kredhur në mendime, Leka e mbylli radion.

— Pse e mbylle? — pyeti Lumtoja.

Leka nuk u përgjegj. Lumtoja tha:

— Ti ndruhesh se mua mund të më shqetësojë ai lajm? Edhe sonte porsa filloi filmi, unë e kuptova se ti nuk doje të shkonim në kinema duke menduar se nuk bënte që ta shihja unë. Gabo-

hesh. Duke parë filma të tillë, duke dëgjuar kësi lajmesh, mua më zgjohen kujtime që më ngjethin mishtë. Po shtohet urrejtja. Ti pandeh se duke m'i shmangur këto gjëra, unë do të harroj se ç'pashë e ç'hoqa atje? Gabohesh. Kujtimet e asaj kohe nuk janë të shkruara në rërë, por janë të gdhendura thellë në zemrën e në mendjen time dhe nuk fshihen dot siç fshin vala gjurmët përmbi rërë.

Si tha këto fjalë, e ndezi përsëri radion. Lajmet kishin mbaruar e në dhomë u derdhën notat e një muzike të gëzuar. Lumtoja shikoi të shoqin dhe të bijën. Ato shikuan atë. Pastaj pa e ditur përse, të tre bënë buzën në gaz.

PALLATI ME MERMER TË KUÇ

Dy partizanët qëndruan në rrëzë të shkallëve. Komandanti hodhi sytë përreth, pastaj i tha Halilit:

— Këtu do të bësh roje sonte. Kur të zbardhë dita, po të duash, futu brenda dhe këputja gjumit. Kuptove?

— Siurdhëron.

— Ke cigare?

— Kam.

— Hajt, natën e mirë. Vdekje fashizmit.

Halili e pa duke u larguar dhe e ndoqi me sy hijen e tij, derisa e përpiu errësira e natës së nëndorit. Komandantin nuk e pa, por zhurmën e hapave të tij e dëgjoi edhe për disa çaste.

Pastaj mbeti vetëm përpara atij pallati të madh me mermer të kuq që ngrihej në majë të kodrës. Vetëm me pushkën e tij.

U ul në shkallë. Pushkën e la pranë. Hoqi këpucën e djathtë se duke ngjitur kodrën i kishte hyrë një guriçkë. Ishte matur të qëndrojë për ta hequr, por i kishte ardhur zor prej komandantit. E shkundi këpucën te shkallët dhe dëgjoi krismën e lehtë të guraçokut që doli jashtë.

«Edhe kjo punë mbaroi» tha duke mbathur

këpucën e vjetër me të cilën kishte bredhur gjysmën e Shqipërisë. Pastaj nisi të mendojë për orën: «Nuk besoj të jetë më shumë se nëndë» foli me zë, duke bërë llogari që kishte më se tri orë që ishte errur fare. «Të ishte natë vere do të kalonte shpejt, pa u ndjerë, por është mesi i nëndorit dhe netët janë të gjata. Nejse, do të kalojë edhe kjo pa gjumë, si shumë të tjera gjatë këtyre viteve».

Hodhi pushkën krahëve dhe u ngrit për t'i rënë rrotull pallatit. Ecte ngadalë dhe nuk dinte ku vinte këmbën, por megjithatë gjente rrugën e drejtë, se gjatë atyre viteve i ishin mprehur sytë në errësirë. Ndërtësën e madhe nuk e shihte fare, por në errësirë mezi shquante një masë të zezë, ngjyrën e kuqe të mermerit që vishte ballin e saj, dritaret dhe dyert i kishte përpirë errësira. Kur kishin çliruar atë ditë qytetin i kishin thënë se ai pallat i madh në majë të kodrës kish qenë vila e mbretit. Aty ai shkante bashkë me familjen për të kaluar muajt e verës.

Duke ecur, këmba i preku diçka të fortë. Hekur ishte, me sa dukej. Qëndroi menjëherë. «Po sikur të jetë ndonjë minë?» mendoi padashur. U përkul dhe e preku me kujdes. Ishte një shufër hekuri e gjatë, e ftohët, e mbuluar me baltë. Vioji të ecë.

Edhe prapa ishte qetësi e plotë. Asgjë nuk lëvizte. Vetëm më të rallë ndonjë frymë ere tundte gjethet e zverdhura dhe përshkonte floknajat e egra të shkurreve. Qëndroi. Nga ajo anë shtrihej pjesa e pasme e qytetit. Vuri re aty-këtu ndonjë dritë të dobët. Pastaj shikoi siluetat e errëta të kodrave dhe majat e tyre ju dukën si kurrize kaf-

shësh vigane. Eci edhe ca, kur papandehur u gjend
prapë në vendin nga ishte nisur.

«Edhe kjo punë mbaroi» tha dhe u ul përsëri
te shkallët. Ftohtë nuk bënte. Nga deti frynte shi-
roku dhe ai e ndjente në fytyrë frymën e tij të
ngrohët e të njelmët. Poshtë, pak përtej këmbës
së kodrës, shtrihej deti. Ai nuk e shikonte, por
ndjente frymëmarrjen e tij të gjërë, të thellë e të
pandërprerë.

Ishte i lodhur. Atë ditë kishin ecur shumë. Më
shumë se njëzet kilometra. Zakonisht bredhjet
dhe marshimet nuk e lodhnin se ishte i ri, i fuqi-
shëm dhe që në vogli ishte mësuar të endej male-
ve dhe fushave duke kullotur tufat e agajit të
fshatit. Por këto kohët e fundit kishin ecur shu-
më, se lufta po i afrohej fundit dhe nën goditjet e
forcave partizane armiku tërhiqej si një zvara-
nik i mplakur i plagosur në kokë.

Drodhi ngadalë një cigare. Pasi e ndezi ktheu
kokën dhe shikoi qytetin. Ai ishte i heshtur dhe
vetëm disa drita të zbeta si yje të largët ndriço-
nin njera këtu e tjetra atje. Pas sa vjetësh robë-
rije e vuajtjesh, për herë të parë ai qytet breg-
detar po bënte një gjumë të qetë, pa ankthe e
alarme!

Duke thithur thellë cigaren, u mbështet në
një krah. Pushkën e mbante pranë gjurit. Mendja
i fluturoi te fshati i tij dhe te nëna plakë, që rrin-
te e strukur atje në kasollen e vjetër brenda së
cilës gjithnjë kishte tym dhe grindeshin erërat e
dimrit. Pastaj ju kujtua babai i vdekur, që priste
dru në pyjet e faqes së malit. Që në mëngjes, pa
zbardhur mirë drita, ai ngrihej dhe Halili ende i
përgjumur e ndjente duke u kollitur teksa mpreh-

te sopatën. Edhe kur në mal pritnin drurë disa njerëz, nëna mbante vesh, pastaj i thonte: dëgjo, ja, ky është babai. Ajo ja njihte dorën dhe i dallonte të goditurat e tij. Pastaj ai mbante mend që babai nuk zgjohej më shpejt dhe kollitja i ishte shtuar duke u bërë më e pafuqishme, derisa u shua fare. Mbas disa ditësh njerëzit e fshatit e morën dhe e varrosën te varrezat në breg të lumit. Kasollja e tyre u bë më e zbrazur dhe në një krrabë mbeti e varur sopata e babait.

E ndjeu se kujtime të tjera e mbuluan. Brofi në këmbë. Pushkën e hodhi krahëve.

«Po i bie edhe njëherë rrotull pallatit» tha dhe këpucët e tij të vjetra lëshuan një fëshfërimë të lehtë në zhurin e oborrit.

* * *

Dita nisi të lindë me mundim. Ishte një agim i hirtë, i qetë, shumë i ngadaltë. Drita zbulonte pakngapak qiellin e ngarkuar me re, qytetin dhe detin. Dukej sikur një dorë e padukur hapte ngadalë perdet e rënda të një dhome të zhytur në errësi.

Halili u ngrit nga shkallët. «Më duket sikur jam mpirë», tha duke shkundur supet dhe duke përplasur këmbët. Pastaj u mbush me frymë dhe zuri të ecë përpara pallatit. Tani që po zbardhte, pallati dukej më mirë dhe partizani shikoi muret e veshur me mermer të kuq dhe dritaret e mëdha, të mbyllura. Çdo gjë aty ishte e rëndë, e ftohtë dhe të shkaktonte një ndjenjë zymtësie, që provohet zakonisht kur ndodhesh përpara monastireve apo burgjeve.

Ngjiti shkallët dhe u gjend para derës. «Kur

të zbardhë dita, po të duash, futu brenda dhe këputja gjumit» ju kujtuan fjalët e komandantit. U mendua. Ndjehej i lodhur dhe mërdhihte. «A të hyj brenda?» Njëherë e largoi këtë mendim, pastaj shikoi rrugën e kodrës dhe qyteti iu duk larg. «Po hyj» tha «të më çlodhen eshtrat brenda konakut të mbretit».

U kthye me fytyrë nga dera dhe e shtyu. Kanata e rëndë kërciti dhe u hap «Edhe kjo punë mbaroi» — tha Halili dhe kaloi prakun. Brenda ishte errësirë. Halili padashje hoqi pushkën nga krahu dhe bëri disa hapa përpara. Qëndroi. Sytë nisën t'i mësohen. Vuri re se nga shkallët që të çonin në katin e dytë vinte një dritë e dobët dhe e zbërdhylet. U kthye prapa dhe mbylli derën. Dëgjoi zhurmën e këpucëve të tij të rënduara nga balta, që rrëshqisnin mbi dysheme. Uli kokën dhe vuri re me vështirësi se ajo ishte e lëmuar dhe lëshonte një shkëlqim të venitur. Ju duk sikur ecte mbi akull. Eci edhe pak, pastaj prapë qëndroi. Ku të shkonte? Cilën nga tri dyert që kishte përpara të hapte? I mëshoi dorezës së djathtë, pastaj e shtyu. Dera nuk u hap. U largua dhe i mëshoi dorezës së derës së mesit. Kanata lëvizi nga vendi dhe ai hyri brenda. Ishte një sallon i madh. Nga njera prej pesë dritareve të mëdha e të gjata depërtonte drita përmes grilave paksa të ndara, si përmes një dore kur i ka gishtat të hapur. Në fund të sallonit shquajti një tryezë të gjatë, kurse anash disa pasqyra të mëdha, që reflektonin dritën e hirtë të mëngjesit që vinte duke u shtuar. Gjatë mureve ai pa disa tryeza të vogla dhe kolltuqe të mëdhenj e të rëndë, që dukeshin si arka të gjata. të murme, të hapura nga njera anë.

Harroi të mbyllë derën dhe u nis drejt fundit të sallonit. Para se të arrinte qëndroi përpara një-rës prej tryezave të vogla dhe e shikoi me vemendje. Ajo nuk ishte shumë e gjatë dhe përsipër kishte një copë mermeri të kuq me damar të bardhë. Këmbët i kishte të shtrembëra dhe ato mbaronin si thundra kali. Halili vuri buzën në gaz. Këmbët e asaj tryeze i kujtuan pelën zezveke të Zeqirit, komshiut të tyre që i kishte këmbët ashtu të shtrembëra. Kjo gjë e bëri që mendja përsëri t'i fluturojë te fshati i tij rrëzë malit, me pyllin e gështenjave pranë dhe me lumin e vogël e ujëkulluar që e rrethonte si një brez i argjendë. Pallati i ftohtë dhe i zyrtë iu largua menjëherë dhe ai po shkelte tokën e vlagët. Sytë i preheshin në blerimet e fushave e livadheve dhe ai ndjente kundërmimin e ajrit të vendit të lindjes që ja zgjeronte mushkëritë dhe i përkëdhelte fytyrën dhe duart.

Por kjo zgjati vetëm pak çaste. Ai pa përsëri para vetes tryezën me këmbë të shtrembëra. U largua së andejmi, por buzëqeshja ende ja ndriste fytyrën. Eci edhe pak dhe u gjend përpara një pasqyre të madhe. E pa veten nga këmbët deri në kokë. Në fillim ju duk sikur kishte përpara një të huaj. Nuk mbante mend ta kishte parë veten të pasqyruar ashtu të tërë përveç se kur shihej ndonjëherë në ujët e lumit. Shikoi në pasqyrë fytyrën e argasur nga mundimet e viteve të luftës, lëkurën e murme, aty-këtu të plasarit, mjekrën e parruar që i rrethonte gjysmën e fytyrës. Vetëm sytë i kishte të gjallë, plot dritë dhe ato nuk kishin ndryshuar fare. Tiparet e tjera sikur i ishin zmadhuar dhe dilnin në pah më të theksuara. «Gjatë këtyre

viteve të luftës qenkan burrëruar!» mendoi duke sjellë ndër mend se nuk ishte më tepër se njëzet-enjë vjeç. Shikoi duart: Edhe ato të mëdha, të fuqishme që shtërngonin pushkën fort. Trupi i tij nuk ishte i gjatë, por i ngjeshur e shulak. Padashur vuri re se pantallonat e vjetra italiane i ishin ngrënë shumë te gjunjët dhe mezi i mbulonin kërcinjët. Nën to dukeshin këpucët e çara me majë të kthyer rënduar nga balta dhe ujët. E vetmja gjë e re që mbante ishte kapa partizane me yll të kuq, të cilën ja kishte dhuruar para dy ditësh komisari kur pa që kapën e vjetër ja kishte shpuar në majë një plumb gjerman. Halilit i kishte ardhur keq ta hidhte dhe e kishte ruajtur me qëllim që kur të shkonte në shtëpi ta vinte atje në krrabë pranë sopatës së babait.

Tani, aty, para pasqyrës ai shihte veten si i çuditur.

— Si je, shoku Halil? — i foli vetes.

— Mirë — u përgjegj.

— Ku je kështu, o fshatar i Mënezës së Epërme — pyeti.

— Në konak të mbretit, or tungjatëjeta! — u përgjegj.

— Deri këtu arrite? — pyeti.

— Tani që po çlirojmë Shqipërinë nuk do të ketë asnjë derë të mbyllur për popullin. Të gjitha do të jenë tonat — përgjegji.

— Je lodhur, hë? — pyeti.

— Nuk e fsheh, por megjithatë po të jetë nevoja... — u përgjegj.

— Ke ndërmend të flesh? — pyeti.

— Po them t'ja këpus një gjumi të shkurtër, sa të shlodhem pak — u përgjegj.

U largua nga pasqyra dhe shkoi pranë një kolltuku të gjatë e të ulët. U ul. Gati humbi brenda nga që ishte shumë i butë. «Me ç'dreq leshi është veshur ky?» — mendoi duke prekur lëkurën e lëmuar.

Hodhi sytë përreth. Drita ishte shtuar dhe tani ai shquante çdo gjë. Papandehur ju duk sikur dikush po e vështronte. Rrotulloi kokën dhe pa në një tryezë të vogël një statujë. Ajo paraqiste një njeri me fytyrë të zgjatur, me mustaqe të holla e me buzë të imta. E shikoi me vemendje dhe një ndjenjë pakënaqësie e pushtoi.

«Çdreqin je ti — tha — mbret apo çfarë? Sipas vendit ku të kanë vënë dhe sipas surratit që paske, ashtu dukesh. Hë, po çuditësh duke parë këtu partizanin prej Mënezës së Epërme? Prit, prit, ky është vetëm fillimi. Me ju dhe me miqtë tuaj do të kemi punë. Mjaft ju mbajtëm në kurriz. Mjaft u kapardisët dhe u majmët me bukën dhe me mundin e fukarait. Më dukesh sikur po shtrembëron fytyrën. Kot e ke: s'ke ç'e shtrembëron se mjaft të shtrembër e paske.

I ktheu shpinën dhe u mat të shtrihej. Por ju kujtua se nuk kishte hequr pushkën nga krahu. U ngrit dhe duke e hequr ndjeu se pushka preku diçka dhe dëgjoi një krismë të thatë në dyshemenë e lëmuar. Atëherë pa se qyta e tij kishte rrëzuar statujën e cilia u bë cop'e thërrime.

«Edhe kjo punë mbaroi!» tha buzagaz. Pastaj u shtri të shlodhej, duke mbajtur pushkën pranë.

DY UJQËRIT

Përpjekja me gjermanët duket se kishte mbaruar. Gavroshi nuk dëgjonte më të shtëna. Papandehur u bë qetësi. Partizani mbajti vesh. Diku, një gjerman thërriste një emër në të rrallë. Një flad i lehtë përshkonte pyllin e xhveshur dhe aty-këtu kërciste ndonji degë. Asgjë tjetër. Gavroshi zbriti nga pema pa zhurmë, si ndonjë mace. Duke rënë në tokë, një degë e vogël ia zuri mëngën e djathtë dhe ja shqeu.

— Bobo, ç'më prishi kostumin! — tha duke qeshur.

Hodhi sytë përreth: pa dy gjermanët që i kishte shtrirë në tokë duke i qëlluar nga maja e pemës. Nuk dëgjoi asnjë zhurmë. Nuk pa asnjëri duke lëvizur. Çdo gjë ishte e qetë dhe e heshtur, sikur të mos kishte patur përpjekje. Veç në të rrallë dëgjohej ai gjermani që thërriste një emër.

«Jam vonuar më shumë seç duhej», mendoi. Skuadra e tij kishte patur urdhër të binte në përpjekje me gjermanët dhe t'i mbante forcat e tyre të gozhduara aty në hyrje të pyllit një orë, ndër-sa brigada të kalonte lumin për të rrethuar krahi-nën. «Pas një ore do të tërhiqeni të gjithë në drejtim të malit» u kishte thënë komandanti. «Vendi i takimit do të jetë te Shpella e Bardhë, aty pranë

qafës së malit. Atje do ta kalojmë natën dhe nesër do të bashkohemi me brigadën. Luftoni të shpërndarë, që të jepni përshtypjen se jeni shumë. E përsëris edhe njëherë: përpjekja do të zgjasë vetëm një orë. . .»

Gavroshit ju kujtua se kur tha ato fjalët e fundit, komandanti kishte hedhur vështrimin nga ai, sikur të donte të thosh: «Hap veshët e dëgjo, ti Gavrosh. Ke dy vërejtje për moszbatim të urdhërit në betejë. Mos haro!» Dhe, ja, ai përsëri ishte vonuar, duke shkelur kështu urdhërin. Prapë do t'ja hiqnin veshët. «Ej, mor Gavrosh, tha me vete, prapë e shkele!» Ai ende nuk kishte mësuar ta thotë mirë atë emër të huaj që ja kishte ngjitur mësuesi i brigadës. Emrin e vërtetë e kishte Nurëdin ose shkurt Nurçe por mësuesi, kur dëgjoji njëherë historinë e jetës së tij, i tha: ti je trim dhe i vogël si Gavroshi, një djalë i revolucionit frëng që luftoi për popullin nëpër barikatat e Parisit dhe aty u vra. Pas kësaj të gjithë shokëve sikur u vinte më për mbarë ta quanin me emrin e ri. Edhe atij vetë ky emër i pëlqente por nuk e thonte mirë, mbasi e shqiptonte shkronjën «r» para «v». Kur shokët ja vinin në dukje këtë, ai përgjigjej: «E, o derëbardhë, se nuk prish punë. Ju të ma thoni emrin mirë, pa unë nuk do ta thërras ndonjëherë veten!»

Pa humbur kohë u nis për në thellësi të pyllit ku ishte vendi i takimit. Duke ecur, kontrolloi pushkën; edhe dy fishekë i kishin mbetur. Mendoi të kthehej te vendi ku kishte luftuar, për t'u marrë armët dy gjermanëve që kishte shtrirë pa frymë përtokë. Por e kuptoi se do të vonohej edhe më, prandaj i dha karar të vazhdonte rrugën. Ecte duke

vështruar me kujdes përreth. Meqë ishte dimër dhe pemët ishin të xhveshura, vështrimi i tij arrinte deri larg. Ecte me hap të lehtë por të shpejtë, që t'i dilte sa më parë në anë pyllit, të përshkonte atë fushën përtej dhe pastaj t'i ngjitej të përpjetës që të çonte te Shpella e Bardhë.

Papandehur dëgjoi një zhurmë të lehtë pas vetes. U fsheh me të shpejtë pas trungut të trashë të një peme që ishte aty pranë. Atë çast, një breshëri automatiku prishi heshtjen e pyllit. Gavroshi dëgjoi xhvendosjen e ajrit fare pranë dhe një cifël nga lëkura e trungut e goditi shkarazi në ballë: «Siç duket po më ndjek ndonjë gjerman, mendoi, hej çdo të më vonojë ky qen bir, qeni!»

Kaluan disa çaste. Gavroshi me kujdes nxori syrin dhe shikoi andej nga kish ndjerë të shtënat. Nuk pa gjë. Pas pak ju duk se nja dyzet metra më tutje diçka lëvizi. Atëhere me një shpejtësi të rrufeshme drejtoi tytën e pushkës dhe i hoqi këmbëzën. Të shtënës së tij ju përgjegjën një varg të shtënash të tjera automatiku. «Nuk e qëllova qenin!» tha me zë Gavroshi. «Edhe një fishek kam. Me armë, siç duket, nuk do ta vras dot. Duhet ta ze me dredhi. «Nxori pak trupin nga pema dhe menjëherë u kthye në vend. Kështu bëri nja dy — tri herë. Prapë dëgjoi një breshëri plumbash që i fluturuan pranë duke fishkulluar si nëpërka. Atë priste. Nxori trupin jashtë trungut dhe u rrëzua në shpinë sikur të ishte goditur për vdekje. Ashtu i shtrirë pa mbi vete majat e pemëve që lartësoheshin nga qielli duke u lëkundur ngadalë. Qielli i bruztë i mbrëmjes së shkurtit ndehet sipër majave i qetë dhe i palëvizur. Për një çast, i rrëmby-

er nga bukuria e pemëve dhe pafundësia e qiellit ai harroi ku ishte dhe pse ishte shtrirë.

Dëgjoi një zhurmë hapash të lehta që afrohe-shin me kujdes. «Afroju edhe pak, or fric, se do ta shohësh... të sat ëme! «Mbylli sytë. Pas pak dë-gjoi që hapat qëndruan pranë tij. Hapi me kuj-des syrin e majtë. Pa pranë vetes tytën e një au-tomatiku dhe pjesën e përparme të një helmete. Me një kërcim të rrufeshëm i ra me shqelm tytës dhe u ngrit në këmbë. Gjermani i zënë në befasi e lëshoi armën, që shkoi e ra larg tij. Gavroshi u ngrit në këmbë. Për një çast u shikuan në sy. Gjermani ishte një burrë i ngjallur, me ca nofulla katrore dhe me një vështrim të ftohtë e të egër. Gavroshi pa e zgjatur ju hodh sipër. E mbështeti pas trun-gut të pemës. Dëgjoi frymëmarrjen e tij. Ushtari i huaj mori hov dhe e shtyu përpara. Gavroshi humbi drejtpeshimin. U kolovit pak por nuk u rrëzua. Gjermani e sulmoi. Ai ju shmang dhe pastaj ju hodh në shpinë duke ja shtrënguar qafën me krahun e tij të fuqishëm. Tjetri u përpoq të çliro-het nga ajo darë por më kot. Desh të flasë, por nxorri vetëm disa tinguj pa kuptim.

— «Është i fortë derri, se është ushqyer me pula. Po prit se do ta shohësh sa e fortë dhe sa e hidhur është gjiza e qepa me të cilët jam ushqyer unë.» Pas pak gjermanit nisën t'i thyhen gjunjët dhe u rrëzua, por duke rënë bëri një përpjekje të fundit dhe ja hoqi dorën Gavroshit nga qafa. Ranë të dy përtokë. Partizani vuri re se i huaji bëri një lëvizje të rrufeshme dhe nxori një thikë nga çizmja. U ngrit në këmbë dhe gjermani e goditi në pulpë. Kjo gjë i dha më forcë urrejtjes së dja-loshit. Ai ju hodh përsipër dhe e mbyti.

Kur u ngrit, vuri re se gati ishte errur fare. U nis me të shpejtë për të kaluar pyllin. Por pas pak u kujtua që këmba e plagosur e pengonte. Qëndroi një çast. Shqeu mëngën e djathtë, shkundi xhepat e i hodhi pak pluhur duhani. Pastaj e lidhi si mundi dhe u nis prapë. Tani i dukej se ajo i dhimbte më pak dhe nuk rridhte aqë shumë gjak. Që të ecte më lirisht këputi një degë peme për t'u mbështetur. Kur u err fare, ai i doli nd'anë pyllit. I qeshi fytyra. Pa përpara fushën dhe përtej saj të përpejtën që të çonte te Shpella e Bardhë. Kjo gjë ja shtoi forcat. Por pasi eci edhe ca vuri re se fusha pranë së përpjetës ishte e mbuluar me dëborë, e cila niste aty e mbaronte në majë të malit. Qëndroi një çast. Atëherë ndjeu se këmba prapë i dhimbte dhe i rridhte gjak. Mori një grusht dëborë, fërkoj fytyrën e nxehur dhe një grusht tjetër e futi në gojë. Prapë zu të ecte. Kur po i afrohej fundit të fushës, ju duk se dikush po e ndiqte. Ktheu menjëherë kokën. Disa dhjetra metra prapa tij pa një ujk që po e ndiqte. Siç duket egërsira kishte ndjerë kundërmimin e gjakut dhe ishte sulur pas partizanit. Gavrosi ndenji dhe e shikoi. Edhe shtaza qëndroi. Në errësirë ju duk se pa shkëlqimin e syve të ujkut. «Derisa nuk sulmon, duket se është i dobësuar nga uria, tha me vete Gavrosi, pastaj ju drejtua me këto fjalë: «Je i dyti ujk që po takoj sot. Armë nuk kam, megjithatë do të kemi punë bashkë. Sonte njeri nga ne nuk do të kthehet te shokët, por mos kujto se do të jem unë ai.»

Duke ndenjurr aty në këmbë, nisi të mendojë në ç'mënyrë ta vriste ujkun. Kish dëgjuar nga një bari se ai njëherë që ishte përleshur me një ujk

shpëtoi duke i futur ujkut në gojë një shkop me të cilin ja kishte gozhduar nofullat. «Po sikur ta provoj këtë gjë? Tha me vete. Ama, shaka i thonë, të fusësh dorën në gojën e ujkut. Pastaj, sikur ai do të rrijë si qengj para teje, të të hapë gojën dhe të të thotë: urdhëro, fute shkopin, shoku Gavrosh! Megjithatë, me duar nuk e mbys tot. Do ta provoj, të dalë ku të dalë.»

Mori shkopin që mbante në dorë, pastaj e vuri te gjuri dhe këputi një copë të gjatë një pëllëmbë. Tani i kishte mbetur vetëm ta ftonte ujkun që t'i vinte pranë e të përleshej me të. Filloi përsëri të ecë. Pastaj qëndroi dhe u shtri në dëborë. I pëlqeu ai çast çlodhjeje që i dha trupit të cfilitur. Ftohtë nuk kishte. Gati nisi të dremisë. Papandehur ju kujtua kovaçhana e ngrohtë, ku kishte punuar pesë muaj si ndihmës i usta Muratit. Por kjo dremitje zgjati disa çaste, se ai e shkundi veten dhe ngriti kokën. Pa se një hije po i afroresh me hap të shpejtë. Pastaj dëgjoi frymëmarrjen e bishës fare pranë vetes. U ngrit dhe e goditi me një grusht të fortë. Ujku ulëriu dhe ju sul. Njeriu dhe kafsha u përleshën duke u rrokullisur në dëborë. Gavroshi thirrte e godiste duke patur kujdes që mos ta lëshonte shkopin e vogël nga dora dhe përpiquej të gjente rastin t'ja rraste atë në gojë. Duart e tij herë preknin kokën e ujkut, herë shpinën. Ai ndjente herëpashere dhëmbët e tij që i shqyenin rrobat dhe i nguleshin në mish. Përleshja vazhdoi disa çaste. Pastaj papandehur dy kundërshtarët u gjendën të ndarë. Aty pranë vetes Gavroshi pa sytë plot dritë ligësie të kafshës së egërsuar. Përmblodhi fuqitë. Dorën me shkopin e mbante gati dhe të shtrirë përpara. «Tani erdhi

çasti i pritur. Kafsha do të më sulmojë dhe, atëhere. . .» Para se ta mbaronte mendimin, ujku ju sul. Zgjati dorën dhe atë çast dëgjoi që ajo ju fut në gojë të bishës. Ndjeu një afsh të nxehtë që ja mbuloi dorën. Ai e shtyu edhe më përpara dhe shkopi u ngul mirë në fundin e nofullave të ujkut. Atë çast dëgjoi një ulërimë të tmerruar. Ujku shtangu në vend dhe nisi të thërrasë si i tërbuar. Gavroshi u ngrit në këmbë dhe fshiu djersët e gjakun nga fytyra. Mori përsëri një grusht dëborë dhe e futi në gojë. Pastaj fshiu fytyrën dhe hoqi frymë thellë. Ujku ishte larguar duke marrë rrugën e kundërt me atë të Gavroshit. Partizani e dëgjoi edhe disa herë ulërimën e tij që humbte nëpër natën e errët.

Kur zuri të ecë vuri re se ishte shumë i lodhur dhe këmba përsëri i dhimbe. Megjithatë shtrëngonte dhëmbët dhe çante përpara.

Kur zuri të ngjitë të përpjetën, pa se forcat po e linin. Qëndroi një çast. «Jo or jo, tha me zë, sikur zvarrë të hiqem do të shkoj te shokët sonte, se s'bën!» Dhe prapë zuri të ecë.

Nuk e mbante mend sa kohë kishte që ecte zvarrë nëpër dëborë. Papandehur u gjend para sheshit të Shpellës së Bardhë. Ju duk se dëgjoi zëra dhe pa një shkëlqim të mekur zjarri. Thirri me sa fuqi i kishte mbetur.

Nga shpella vrapuan disa partizanë. Ata e njohën menjëherë.

— Ti Gavrosh? Si kështu? Ne të dinim të vvarë.

— U vonove shumë!

— Të kemi kërkuar nëpër pyll. Ku ishe?

Gavroshi qeshte, qeshte dhe nuk kishte fuqi

të fliste. Qeshte ashtu pa zë, i mbështetur në kra-
hët e shokëve.

E futën në shpellë. Nisën t'i mjekojnë plagën.
Atëhere, pranë zjarrit Gavrosi pa komandan-
tin dhe i tha:

— Shoku komandant, e shkela edhe sot.

Komandanti nuk i foli por ndukte mustaqet
duke parë zjarrin. Sytë i mbante poshtë, se e
ndjente se i ishin njomur nga lotët.

Pas pak, një partizan e pyeti përsëri:

— Po hë, de, na thuaj ku ishe, pse u vonove?

— U përlesha me dy ujqër.

— Me dy ujqër? Si kështu? Hë, na trego!

— Lere a derëbardhë, se nuk është ndonjë
gjë e madhe. Tani më jepni të ha dhe pastaj më
lini të flë. Nesër bisedojmë.

NJERIU ME FYTYRË TË DAMKOSUR

Teksa po rrija duke pritur që të më sillnin kafënë, dëgjova një zë nga prapa:

— A mund të ulem pak këtu, o shok?

Ktheva kokën. Ish një burrë pak i thyer në moshë, i thinjur anash, i veshur me një pallto ushtarake pak të gjërë për trupin e tij të imët.

— Urdhëro ulu, — u përgjegja duke i zgjatur një fron.

Kur ai zuri vend, nisa ta shikoj më mirë fytyrën e tij të rrumbullakët, me flokë të zes e të shkurtër. Kish tipare të theksuara, sy të qetë ngjyrë-hiri dhe hundë të madhe. Nga mezi i mollëzave nisnin dy rrudha të thella. Mustaqet e dëndura e pak të mëdha, ja mbulonin fare buzën e sipërme.

— Ju nuk jeni vendas, apo jo? — më pyeti ai, dhe pa pritur përgjegje shtoi: — Me ç'punë mërreni?

I tregova shkurt për veten time, pastaj nisa ta pyes.

Më tha se ishte kryetar këshilli në një fshat pranë Kavajës. Ishte martuar dhe kish vetëm një djalë të rritur. Kish ardhur në Kavajë se donte të nisej për në Tiranë.

— Pse shkon? — e pyeta.

— Të takoj djalin që e kam ushtar atje, m'u përgjegj dhe, pasi heshti një çast, shtoi — veç kësaj...

Heshti përsëri. Kamarieri i solli kafënë.

Veç kësaj do të shkoj në Tiranë se kam për të dorëzuar një lutje.

E shikova. Mënyra si fliste dhe kjo puna e lutjes më ngjallën kureshtjen. Ai ngriti ngadalë filxhanin dhe pasi i fryu kafesë, nisi ta rufisë.

— Unë, që thua ti o shok, kam bërë një lutje për të ndërruar mbiemrin, se që ta marrësh vesh, quhem Hamdi Rrena.

Vijoi të rufisë kafënë ngadalë, pa më shikuar.

Ky mbiemër ka një histori të gjatë. Në paç kohë po ta tregoj. Apo mërzitesh?

I thashë se më pëlqente shumë ta dëgjoja atë histori, bile ju luta të ma tregonte.

— Si të thashë, unë banoj në fshat. Aty kanë jetuar edhe gjyshi e stërgjyshi im. Historia nis me babanë tim. Gjer para çlirimit fshati ynë ish pronë e Xhaferr bej Demixhiut. Atë unë e kam parë vetëm një herë. Ka qënë pranverë. Bashkë me një vajzë të moshës sime, po ndërtonim një shtëpi me rërë e copa gurësh. Mund të kem qënë nja tetë vjeç. Ndërsa ne po i vinim çatinë, dëgjuam një trokëllimë kali. Pas pak aty kaloi beu sipër doriut. Ai e solli kalin drejt nesh. Ne u tërhoqëm në një anë të tmerruar. Beu kaloi si vetëtima. Thundrat e kalit të tij shkatërruan shtëpizën tonë të vogël me të cilën po luanim.

Tregonin se ai ish njeri shumë i mbyllur dhe vetëm disa herë në vit dukej në sytë e fshatarëve. Krejt punët ja bënëin qahallarët dhe i vëllai i vogël Myrtezai. Beu banonte në një kullë të madhe me pak

dritare, të ndërtuar me gurë të përhimë në majë të një kodre të xhveshur. Kasollja ku banonte familja ime ish në të dalë të fshatit, buzë lumit të hijëzuar me shelgje, që e rrethonin krejt fshatin si një breg i argjendë. Në ujët e kulluar të lumit ne laheshim dhe mbushnim ujë për të pirë. Babai kur ish i lirë zinte peshk me një lundër të vogël dhe me një kariq të vjetëruar.

Historia që do të tregoj ka ngjarë më 1940 ose më 1941. Ish dimër. Kishim ndezur një zjarr të madh bubulak dhe të ulur rreth tij dremitim të heshtur, prindërit në një anë e unë me motrën në anën tjetër. Flakët vallzonin të gëzuara, duke lëshuar hije të mëdha në faqet e kasolles.

Papandehur dëgjua zurmë hapash. Mbajtëm vesh. Para derës sonë qëndroi dikush. Pas pak një dorë e rëndë nisi të trokasë shpejt. Babai u ngrit e thirri:

— Kush është?

— Jam unë, Aliu — u përgjegj një zë i trashë nga jashtë.

Babai hapi derën:

Bujrum, Ali — i tha.

— S'do të rri, kam një fjalë me ty.

Babai doli jashtë.

Aliu ish shërbëtor në kullën e beut. Ruante kuajt. Ai hynte e dilte në shtëpinë tonë. Ish djalë i gjallë, gazmor dhe shakatë i kish në majë të gjuhës. S'kish njeri në këtë botë, prandaj neve na u duk çudi atë natë kur ai as na përshëndeti, as hyri brënda, po vetëm thirri babanë. Mendova njëherë të ngrihem, por e dija sa i rreptë ish babai. Megjithëse i kisha mbushur të pesëmbë-

dhjetat, ai nuk më linte të përzihesha në «punët e burrave», siç thoshte.

Nëna i hodhi ca shkarpa zjarrit. Ajo mundohej të rrinte e qetë, por, duke e shikuar me vëmendje, s'ish e vështirë të kuptoje se ish shqetësuar dhe mezi priste të merrte vesh ç'kish ngjarë.

Pas disa minutash babai hyri në kasolle dhe pa folë e pa na shikuar mori stapin e gjatë, me të cilin shtynte lundrën dhe doli. Nëna s'i foli. Duke jetuar shumë vjet me të, ajo e dinte se kur babai nuk fliste vetë, as ajo s'duhet ta hapte gojën.

Ne s'po kuptonim gjë. Vetëm motra e vogël ngacmonte macen e bardhë që kish një njollë të zezë në syrin e majtë dhe s'donte t'ja dinte se ç'po ngjiste. Unë me nënën vetëm një gjë kuptuam: Me sa dukej në fshat kish ngjarë diçka dhe babai do ndihmonte dikë për të kaluar lumin. Ky mund të ish Aliu ose ndonjë i njohur i tij.

Pasi kaluan edhe disa çaste, nëna tha:

— Çohuni të flemë!

Motra u ngrit menjëherë, u shtri dhe pas pak e mori gjumi. Mua nuk më tha gjë. Ajo nuk donte të mbetesh vetëm duke pritur babanë.

Zjarri brambullonte si më parë dhe ne dëgjonim uturimën e lumit që ish fryrë nga shirat e fundit. Nuk flitnim, por të dy mbanim vesh. Unë e përfytyroja babanë duke luftuar me rrjedhën, për të nxjerrë lundrën në bregun tjetër.

Pas një orë ose pas dy — kush mund ta dijë — u hap dera dhe hyri babai duke bartur stapin, të cilin e vuri në vendin e mëparshëm. Pastaj erdhi e u ul pranë zjarrit. Ish lagur dhe shqyer në dy-tre vende. Në dorën e majtë i rridhte një curril i vogël gjaku.

— Qënke vrarë, — i tha nëna e trembur.

— Asgjë, asgjë — tha babai duke fshirë gjakun — më goditi pak stapi duke kthyer lundrën.

Tani nuk kisha më asnjë dyshim: dikush kish kaptuar lumin. Po kush? Aliu apo ndonjë tjetër? Dhe përse? Ç'kishte ngjarë? Ajo natë e ftohët, e zezë dimri, fshihte ndonjë krim, ndonjë pusi, ndonjë të zezë ose djalli e merrte vesh se çfarë tjetër.

Qëndruam disa çaste ashtu, pastaj babai i tha nënës të shtronte për të fjetur.

Kur u fik pisha e zjarrit dhe në dhomë s'ndjehej tjetër veç uturimës së lumit, më zuri veshi këtë bisedë me zë të ulët:

— Dëgjo grua, tani po të tregoj se ç'ngjau sonte, por mbaje gjuhën në mes të dhëmbëve se na merr në qafë.

— Mos u bëj merak.

— Aliu ishte zënë me beun. Ti e di se ai mendonte të martohej. Prandaj sonte i kish kërkuar beut të hollat e rrogës që i takonin. Beu i kish thënë: «Unë të mbaj me bukë, prandaj ty s'të takon të marrësh gjë.» Fjalët ishin trashur dhe Aliu, që është gjaknxehtë i kish thënë beut derr dhe e kish goditur. Kish shpëtuar për një qime. Prandaj ai erdhi sonte e kërkoi lundrën.

— I shkreti Ali! — tha nëna, kur babai heshti. — Tani do ta ketë punën pisk.

— Ai është zhivë e s'ja ha qeni shkopin. Ai do t'i shpëtojë beut.

— Ishalla.

Heshtën. Atë natë, përveç motrës së vogël, askush s'vuri gjumë në sy në kasollen tonë. Të

gjithë e dinim se ajo punë s'mbaronte me aq e me siguri do të kish avaze të tjera.

Nuk pritëm shumë. Që në mëngjes, kur babai po bëhej gati të dilte nga kasollja, hyri qahajaji i beut e i tha mos të luante nga vendi se aty do të vinte beu për të biseduar me babanë.

Tani dukej sheshit se beu e kish marrë vesh që babai kish ndihmuar Aliun të arratisej. Vështrova babanë. Fytyra e tij e hequr ish e rëndë dhe e qetë si gjithnjë.

Nëna u zverdh dhe shikoi babanë. Pastaj ai pa nga ne dhe duket diç ju kujtua e na erdh pranë.

— Merr Hamidenë — më tha me zë të lehtë e të dridhur — e shkoni të mbushni ujë te pusi i Zamanëve se ai i lumit është i turbullt. Pastaj shkoni te hallë Xheja e i kërkoni pallën për të larë lëveret.

S'ish e vështirë të kuptoje se nëna nuk donte që ne të ishim në shtëpi, kur të vinte beu.

Pa folur, kapa në një dorë katruven e madhe, në tjetrën motrën e vogël dhe u mata të dal. Te dera qëndrova pak dhe shikova babanë: ai rrinte në këmbë para stapit të lundrës. Papandehur ktheu kokën e na shikoi.

— Shkoni, shkoni, na tha dhe sytë ju mbushën me një dritë të ëmbël.

Unë bëra sikur vura buzën në gaz dhe dola nga kasollja zemërthyer. Rrugës më silleshin në kokë gjithfarë mendimesh të këqia: Shihja beun duke rrahur babanë, shihja Aliun që e kishin kapur njerëzit e beut dhe e ballafaqonin me babanë. Kisha frikë të madhe.

Këto që do të tregoj tani i mora vesh më

vonë nga nëna e nga një njeri, i cili i kish parë me sytë e tij.

Sa kishim dalë ne, në kasollen tonë kish ardhur beu me tre njerëz nga pas.

— Unë e dij — i kish thënë ai babait — se ti mbrëmë ke nxjerrë Aliun në anën tjetër të lumit. Më thuaj ku ka vajtur, se ai me siguri ty ta ka thënë.

Babai kish mohuar çdo gjë. Beu ish munduar me të gjitha mënyrat ta bindte. I kish thënë se do ta falte, i kish premtuar shpërblim, por babai gjithnjë po të tijën. Në fund beu kish klithur i egërsuar:

— Rrenë, rrenë. Po të them për herë të fundit : «Ose kallëzo, ose do të zhduk me soj e sorollop.»

Kur beu e kish parë se ish e kotë, e kish marrë babanë me vete në kullë.

— Më vjen keq për fëmijtë e për gruan — i kish thënë kur kishin vajtur atje — prandaj as do të burgos, as do të bëj gjë por vetëm do të ve në ballë njollën e turpit për rrenën që më the. Sot e tutje ti do të quhesh Osman Rrena dhe këtë fjalë do ta kesh të shkrojtur në ballë.

Pastaj beu kish urdhëruar që ta lidhnin dhe kish thirrur kovaçin për t'ja damkosur ballin. Po, po, mos u habit, për t'ja damkosur ballin! Babai kish thirrur:

— Jo, më mirë vritmë sa të më lesh me këtë vulë turpi në ballë.

Por beu kish bërë veshin e shurdhër. Kovaçi kish nxehur hekurin, pastaj kish nisur t'i gdhendë në ballë një nga një shkronjat e fjalës Rrena. Mund ta marrësh me mend vetë se çfarë dhimbje ka

duruar im atë. Kur po i shkruanin shkronjën «n», i kish rënë të fikët.

Kur babai kish ardhur në vete, beu i kish vënë përpara një pasqyrë të madhe që ta shihte ballin të damkosur.

E lanë shumë orë ashtu. Të nesërmen, e sollën në shtëpi. Ishte gjysmë i vdekur. Pasi e shtrimë, tha me një fije zëri:

— Më lidhni ballin.

Dhe dy ditë me radhë as foli as hëngri. Vetëm nja dy herë kërkoi ujë. Kohën tjetër qëndroi i shtrirë, symbyllur, pa dhënë asnjë shënjë jete.

Të tretën ditë kur u zgjuam, pamë se ai nuk ishte në dyshekun e tij. Të trembur shikuam njëri tjetrin dhe dollëm nga shtëpia me zemër të ngrirë. Pasi kërkua ca, e gjetëm në breg të lumit, të ulur mbi një sop. Kish zgjidhur pecen e ballit dhe qëndronte kokëulur duke shikuar të pasqyruar në ujë fytyrën dhe ballin me atë plagë të gjallë, me atë vulë të turpit në mes.

Kaluan ca ditë. Pak nga pak babai nisi ta marrë veten, por kurrë s'u bë si përpara. Nisi të punojë. Ballin e mbante gjithnjë të lidhur, hem ditën, hem natën. As para nesh nuk e zbulonte.

Në fshat e kishin marrë vesh të gjithë, por shumica bënë sikur nuk dinin gjë. Kish nga ata që pëshpëritnin pas shpine. Ndonjëri vinte edhe ta ngushëllonte me fjalë të ëmbia. Por këta të fundit e lëndonin edhe më tepër plagën e babait.

Për Aliun s'u muarr vesh gjë. Një ditë prej ditësh në fshat u hap fjala se ish e fejuara e tij që martuar me një jabanxhi të ngulitur në fshatin tonë.

Muajt kalonin. Plaga në shpirtin e babait kish vënë kore, por ajo ish si një zjarr i mbuluar nga hiri dhe mjaftonte një frymë ere, që hiri të përhapet dhe damkimi të shihej.

Dhe, ja, pas ca kohe plaga u çel përsëri... Kjo ndodhi kur erdhën të bëjnë regjistrimin e popullsisë. Me urdhër të beut na regjistruan me mbiemrin: «Rrena».

Kjo e tronditi shumë babanë dhe shumë net me radhë ai u përpoq në dyshek pa vënë gjumë në sy. Por më e madhja ngjau pas dy muajsh. Një mëngjes babai vajti në Kavajë për të shitur ca zarzavate. E mori vesh beu dhe i dërgoi pas dy njerëz. Afër drekës, kur pazari ish plot e përplot me njerëz, dy njerëzit e beut ju afruan babait dhe ja hoqën me zor pecen, duke i zbuluar ballin. Pas kësaj ata thirrën: «Ja, shikoni o njerëz, ky është Osman Rrena, gënjeshtari më i madh i Shqipërisë. Këtë e ka të shkruar në ballë».

Kjo ngjarje e tronditi shumë babanë. Në mbrëmje u kthye nga tregu një fshatar e na tregoi ç'kish ngjarë atë ditë në pazar.

Babai u kthye vonë. Hyri në kasolle dhe qëndroi ca kohë te dera. Pastaj ktheu shpinën dhe bëri të dalë.

— Ku shkon? — u dëgjua zëri i nënës.

— Do dal — u përgjegj ai shkurt.

U ngrit e doli.

Nuk kaloi shumë dhe nëna më tha të ngrihem. E kërkuam në breg të lumit. Por s'e gjetëm gjëkund. Një fqinji ynë që e kish takuar dhe më parë, na tha se e kish parë në rrugën që të çonte te shtëpia e beut. Që nga ajo mbrëmje babai s'u kthye më në shtëpi.

Kjo është historia e mbiemrit tonë. S'po të kallëzoj ç'hoqëm, se në çfarë xhehenemi vuajtjesh i kaluan vitet. Prandaj, sot që beu u zhduk nga faqja e dheut dhe mund të marrim frymë lirisht, si zot të vetes, vendosa të shkoj në Tiranë, të ndërroj mbiemrin.

U ngrit në këmbë. Desha t'i flas, t'i them diçka, por s'dija nga t'ja nis. Ai më zgjati dorën e tij të madhe e t'ashpër.

— Mirë mbetsh, o shok! dhe u nis për Tiranë.

— Ç'ka hekë ky popull! thashë me vete.

DJALOSHI DHE GJARPERI

— Çfarë more në tokë? — ushtoi prapa djaloshit zëri i milicit.

Ai drejtoi trupin duke mbajtur të shtërnguar grushtin e djathtë.

Çfarë more, po të pyes.

Por djaloshi edhe kësaj radhe nuk foli. Milici ju avit, i zuri dorën dhe ja hapi grushtin.

— Ç'e do këtë copë thëngjilli, mos do të nderzësh zjarr për t'u ngrohur tani në verë? — foli përsëri milici dhe qeshi me fjalët që tha.

Djaloshi mbylli grushtin dhe vijoi të ecë nëpër oborrin e burgut. Ecte me vështirësi se gju-njëti mezi e mbanin. Hidhte hapat ngadalë duke shikuar herë pllakat e nxehta të oborrit, herë këmbët e zbathura e të djegura që ndërroheshin përpara syve të tij. Pastaj ngrinte kokën dhe shikonte atë katror të vogël qielli të mjegulluar sipër tij, shikonte muret e zymta të burgut, karakollin e rojes, një tytë të heshtur mitrolozi dhe anës saj fishekët e bardhë që ngjanin si dhëmbë të mbrehët gati për të kafshuar jetën.

Ecte, kthehej, shikonte poshtë dhe lartë, kurse grushtin e djathtë e mbante gjithmonë të shtërnguar.

— Mjaft brodhe zotrote; — u dëgjua zëri i milicit — hajt, marsh në qeli.

Djaloshi qëndroi. U mbush me frymë, ngriti kokën dhe shikoi përsëri katrorin e mjegulluar të qiellit, pastaj u kthye dhe hyri në një derë të madhe pa asnjë dritë brenda. Duke ecur nëpër koridorin e gjatë e të errët ai ndjente zhurmën e lehtë që lëshonin në çimento këmbët e tij të zbatthura dhe krismën e këpucëve të milicit.

Hapat përziheshin, zhurmat kryqëzoheshin dhe ata hynin përherë më thellë koridorit të gjatë.

Papandehur u hap një derë. Një zë thirri...

— Sille këtu të burgosurin!

Kur hyri në zyrën e drejtorit të burgut, djaloshi pa në fillim fytyrën e bymyer të Musolinit brenda kornizës së varur në mur, pastaj një kamxhik mbi tryezë që i ngjante një gjarpëri të fjetur. Në fund vështrimi i tij u ndesh me sytë e vegjël e dinakë të drejtorit që vështronin vëngër.

— Kemi një njoftim të rëndësishëm. Na erdhi vendimi për ekzekutimin tuaj. — Duke folur, në njerën dorë mbante letrën, kurse dora tjetër u mbështet mbi kamxhik.

— I pandehuri Jordan Misja, nesër në mëngjes do të vareni në Fushë të Qelës, mu midis pazarit.

Keni gjë për të thënë?

Drejtori uli letrën dhe i vuri dorën sipër. Dora tjetër rrinte gjithnjë e mbështetur mbi kamxhikun. Djaloshi shikonte jashtë dritares dhe mendonte: Ja, ju erdhi fundi. Pastaj foli:

— Çfarë rëndësie ka që do të vdes, kur ideali për të cilin kam luftuar me shokët e mi është më i gjallë se kurrë.

— Të gjithëve do t'ju zhdukim.

— Përpjekje e kotë, zoti drejtor. Me ne është

populli dhe atë s'mund ta zhdukni dot, se populli është i pavdekshëm.

— Pusho!

— Vetë më pyetët a kam për të thënë gjë.

— Mbylle gojën!

U bë qetësi. Jordani shikonte duart e drejtorit dhe një buzëqeshje e hollë ja çeli paksa buzët dhe ja rrudhi bishtat e syve.

— Çfarë shikon ashtu? — pyeti pas pak drejtori.

— Duart tuaja: njera është mbështetur mbi vendimin me varje, tjetra mbi kamxhikun.

— Jashtë! — u çor drejtori duke u ngritur në këmbë.

— Do të shohësh nesër në mëngjes në Fushë të Qelës.

Përsëri u dëgjuan në koridorin e gjatë zhurma e lehtë që lëshonin këmbët e zbathura të Jordanit dhe krisma e rëndë e këpucëve të milicistit. Hapat përziheshin, zhurmat kryqëzoheshin, përziheshin.

* * *

Në qeli ishte dritë. Dielli duke u anuar nga perëndimi derdhej përmes dritares së vogël si një përrua drite. Hija e stërmadhe e hekurave e mbulonte Jordanin që nga balli i gjërë deri poshtë te këmbët e djegura. Ai rrinte përballë faqes së murit që ishte në të djathtë të derës së hekurt. Shikonte vizatimin e madh që kishte nisur ato ditë në mur. Me ndihmën e asaj cope thëngjilli që gjeti në oborrin e burgut, mund ta mbaronte

atë ditë. Desh të nisi punën, por ndjeu se ishte i lodhur dhe këmbët me zor i mbanin trupin e cfilitur nga uria e torturat. U ul në dërrasën e ashpër e të pagëdhendur që i shërbente si shtrat. Ndjeu se këmbët i zienin dhe gjymtyrët i ishin kapitur. Por mendjen e kishte akull dhe ishte fare i qetë. Shikonte përpara dhe vështrimi i tij ishte i vendosur dhe i kthjellët. Duke lëvizur duart mbi dërrasën e ashpër, preku copën e thëngjillit që e la aty, kur u ul. Pa e shikuar e mori dhe e mbështolli në grusht. Atë çast ktheu kokën dhe shikoi vizatimin e madh në mur. Megjithëse i pambaruar, kuptohej çfarë kishte dashur të paraqiste. Edhe gjarpëri i madh edhe djaloshi i fuqishëm që i kishte zënë kokën dhe po e mposhte, dukeshin shkoqur. Mungonte vetëm fytyra e djaloshit dhe koka e gjarpërit që ende nuk i kishte mbaruar. Kështu vepronte gjithmonë kur vizatonte apo pikturonte. Fytyrën e linte për në fund. Më parë përfundonte gjërat e tjera, sfondin, veshjen duart, pastaj fytyrën. Donte që të përqëndrohej mirë te gjëja më e vështirë e njeriut: te fytyra. Nëse te të tjerat punonte me një farë lehtësie, kur vinte te fytyra, vizat ecnin ngadalë, mbi sipërfaqen e bardhë të pëlhurës. Kështu kishte vepruar në shumë punë të bëra në ato vite që merrej me, pikturë. Me vemendje e kujdes kishte pikturuar portretet e prindërve, të motrës, të nipit e të disa të tjerëve. Duke sjellë ndërmend këto gjëra, pyeti veten: Ku ishin tani punimet e tij? Ndonjera ishte e ruajtur nëpër shtëpitë e shokëve dhe e farefisit, por shumica kishte humbur përgjithmonë gjatë luftës që u bë në rrugën Firaj atë mëngjes qërshori kur Jordani me Perlatin e

Brankon luftuan kundër ordhivë fashiste. I kujtohej se, kur po lufonte, nga dritarja një plumb fashist kishte rrëzuar portretin e babait që ishte i varur në mur. Kur shtëpia kishte marrë zjarr, mbante mend se ishte përpjekur të shuante me duar flakën në portretin e nënës, por kishte qenë e kotë. E kishte lënë aty pas murit të pushtuar nga gjuhët e kuqe të flakëve. Portreti ishte djegur shpejt dhe Jordani kishte parë duke u larguar nga sytë e tij duart, flokët dhe në fund sytë e saj të kthjellët e të bukur. Pastaj çdo gjë ishte pushtuar nga një përzjerje tymi e flake, por atij i kishte mbetur para syve, shikimi i nënës, i qetë, i ëmbël, i ndritur.

«Më mirë po ngrihem e po punoj tani se është akoma dritë» mendoi dhe brofi në këmbë duke shtrënguar në grusht copën e thëngjillit.

Kur ngriti dorën dhe thëngjilli rrëshqiti me një zhurmë të lehtë mbi gëlqeren e murit, vuri re se grushti i tij lëshonte hije mbi vizatimin.

«Punë e madhe» mendoi duke qeshur, «sikur jam në studio këtu».

Nisi punën me vrull. Atëhere muret e qelisë, këmbët e djegura, gjymtyrët e cflitura, dënimi me varje u harruan.

Të gjitha ndodheshin diku larg ose nuk ekzistonin fare. Në ato çaste puna e tij, puna e tij e dashur ishte reale, e prekshme, e rëndësishme. Muret e trashë të qelisë u rrëzuan dhe ai mernte frymë lirisht; zhurma e hapave të rënda të milicëve nëpër koridor u fshi dhe ai dëgjonte muzikë. Melodi të reja, të panjohura jehonin në veshët e tij. Dora rrëshqiste ngadalë mbi mur, e sigurtë, e drejtuar nga mendja e tij, e përqëndru-

ar nga zemra i tij e zjarrtë, nga shpirti i tij i përkulur.

Duke vizatuar sytë e gjarpërit, ju kujtuan sytë e drejtorit të burgut, të vegjël, dinakë, të mbushur plot hije ligësie. Ashtu nisi t'i bëjë edhe ato të gjarpërit. Natyrisht thëngjilli nuk mund të jepte tërë nuancat e atyre syve të këqij të njeriut të shitur tek i huaji. Por megjithatë sytë e gjarpërit i bëri të vegjël, të këqij dhe njëkohsisht të trembur e të pafuqishëm. Duke vizatuar atë varjant të Laokoonit të lashtësisë trojane, Jordani e trajtonte në mënyrën e vet dhe me qëllim të caktuar. Në vend të priftit të moçëm e të trembur, deti që e mbyti bashkë me fëmijët dhe, gjarpërit të madh të dalë nga deti, Jordani kishte paraqitur një djalosh të fuqishëm shqiptar, gjarpërin fashist të zënë për kokë. Ai vizatim shprehte besimin për fitore dhe urrejtjen për armikun. Ajo vepër e fundit ishte testamenti që ai nuk kish si ta shkruante, por e vizatonte në qeli disa orë para ekzekutimit.

Ndërsa punonte nënë shtytjen e atij vrulli të madh, të dëshirës për të thënë fjalën e fundit në pikturë, dëgjoi papandehur një zhurmë që e shkëputi nga puna dhe u kthye menjëherë brenda qelisë. Në koridor ushtuan hapa të rënda njërezish që vraponin. Në oborr gjithashtu dëgjoi dikë që qe duke vrapuar. La punën dhe mbajti vesh pa kuptuar se ç'po ndodhte. Por pas pak dëgjoi një kor të fuqishëm burrash që këndonin një këngë luftime. Zemra i rrahu: Ishin shokët që këndonin: zërat vinin nga të gjitha anët e burgut. Nga qelit e ndryshme dhjetra të rinj këndonin pas hekurave dhe zërat bashkoheshin në atë kor të

fuqishëm që kalonte mure e hekura, roje e karakolle dhe ngjitej lart si një erë që paralajmëronte stuhi.

Ju afrua dritares së vogël të qelisë. Kënga vijonte e pandërprerë dhe përherë më e fortë, shtoheshin gjithashtu zhurmat e hapave të rojeve të milicëve.

— Çfarë ka ngjarë? — pyeti një zë nën dritaren e Jordanit.

— Të burgosurit kanë zënë të këndojnë. Komunistët shkaktojnë turbullira. — përgjegji një zë i ngjirur.

— Përse? — pyeti i pari.

— Kanë marrë vesh se nesër një shoku i tyre do të varet. Ata vazhduan të flasin me zë të ulët, por bisedën e tyre e mbyti kori dhe thirrjet e fuqishme të të burgosurve.

Jordani shtërngonte fort hekurat. Zemra i gufonte.

Ai nuk ishte vetëm. Kurrë nuk kishte qenë i vetëm. Luftën legjendare të rrugës Firaj e kish-te marrë vesh e tërë Shqipëria dhe të gjithë mbainin në gojë emrat e herojve.

Në qeli zbritën hijet e para të muzgut që në fillim pushtuan cepat dhe këndet, pastaj mbuluan pak nga pak tërë qelinë. Edhe jashtë po shuhe-shin shkëlqimet e asaj dite të nxehtë vere.

Burgu akoma ushtonte nga këngët dhe thirrjet e shokëve. Jordani dëgjonte pas hekurave, i qetë dhe buzagaz. Kokën e mbante lart duke shikuar yjet e parë që ndriçonin dhe dridheshin në qiell.

Jordani u shkund dhe u ngrit në këmbë. Padeshur kishte dremitur. Shikoi nga dritarja. Nga lindja qielli kishte nisur të ndriçohej dhe një rryp drite kishte pushtuar tërë horizontin.

Ai u shtriq dhe mori frymë thellë. Ju avit dritares dhe nisi të shikojë lindjen e ditë së re. Shikonte i mahnitur dritat e dlira të atij agimi që ishte agimi i fundit për të.

Kur dritat u shtuan dhe hijet largoheshin, Jordani zbriti nga dritarja dhe mori copën e thëngjillit që ishte përgjysmuar. Pastaj shkoi te faqja e murit ku ndodhej vizatimi. Nisi të bëjë fytyrën e djaloshit që po ja shtypte kokën gjarpërit. Duke vizatuar i dilte parasysh fytyra e Perlatit e Brankos dhe e shokëve të tjerë të luftës. Shumë tipare të tyre ai i vuri në fytyrën burrërore e të vendosur të djaloshit. Jordani donte që ai t'u përngjante pikërisht atyre. Kur e mbaroi, psherëtiu i kënaqur dhe i shikoi me vemendje; fytyra e vizatuar herë herë i dukej si ajo e Perlatit, herë si ajo e Brankes, herë si ajo e shokëve të tjerë, të cilët me duart e tyre të fuqishme po ja shtypnin kokën gjarpërit fashist.

Thëngjilli ju mbarua. Ai shkundi gishtat e dorës së djathtë për të hequr pluhurin e zi. Atë çast heshtjen e koridorit para qelisë e prishi një zhurmë hapash.

Jordani i kishte kthyer shpinën derës dhe rrinte me fytyrë nga dritarja duke shikuar lindjen e ditës së re.

Hapat në koridor erdhën duke u shtuar pastaj qëndruan përpara qelisë së tij.....

KALI I VAJE ÇELATIT

Vaje Çelati mbeti e ve një ditë nëndori të vitit 1943. Një mëngjes përcolli të shoqin për Shijak dhe po atë mbrëmje ja sollën në shtëpi të vdekur e të përgjakur përmbys mbi shalën e kalit. Pasdite dy aeroplanë anglezë kishin mitraluar një autobus me udhëtarë dhe një plumb kish-te zënë në shpinë të shoqin e Vajes që ndodhej pranë autobusit, duke u kthyer në shtëpi.

Fshatari, që ja solli të shoqin, e ndihmoi ta zbriste nga kali, ta fuste në shtëpi dhe vetë ai ndenji aty. Ajo e xhveshi të vrrarin dhe e lau me ujët e pusit, e veshi me rrobat e reja dhe e shtriu në mes të dhomës. Fshatari grazhdoi kalin duke ja larë pikat e gjakut që kishte mbi lëkurën e lëmuar. Vaja nxorri nga sepeti teshat më të mira që kishte, u vesh, pastaj u ul pranë të shoqit dhe qëndroi tërë natën nën dritën e kandilit duke parë fytyrën e tij të zbetë dhe duke dëgjuar erën e nëndorit. Fshatari ndenji në fund të dhomës duke pirë parreshtur duhan.

Kur nisi të zbardhë, ai u ngrit, mori lopatën dhe doli në oborr. Porsa mbaroi hapjen e gropes pranë manit me degë të gjera, në shtëpi erdhi familja e Dellçëve: djali me nusen dhe e ëma. Pasi i varrosën të shoqin, ata ndenjen me Vajen

për drekë duke folur pak dhe duke pirë parresh-tur kafe pa sheqer. Kur u err, komshitë u ngritën, plaka e Dellçëve i tha:

— A të rri unë sonte të flej me ty, moj qyqe?

— Jo, nuk është nevoja, — përgjegji Vaja — Zoti ju nxjerrtë në selamet dhe jua shpërblefsha ndër gëzime.

Dhe plaka u largua duke tundur kokën e duke mërmëritur diçka nëpër dhëmbë. Pas tyre iku edhe fshatari që solli kufomën në shtëpi.

Më vonë Vaja shkoi në bodrum, i dha kalit të hajë duke e parë teksa ai mbllaçitej me zhurmë dhe herëpashere çukërmonte dheun me këmbët e para. Pastaj hyri në dhomën e saj, kyçi derën dhe shoi kandilin. Nuk ra të flejë por ndenji para dritares që shihte në oborr. Aty ja nguli sytë ma-nit dhe atij grumbulli dheu që ishte pranë tij. Orët kalonin dhe ajo rrinte gjithnjë aty, duke shikuar jashtë dhe duke dëgjuar të lehurat e qenve që era e nëndorit i mirrte me vete dhe i çonte larg.

Kështu e kaloi ditën e parë pa burrë Vaje Celati.

* * *

Vaja ishte një grua që porsa i kishte mbu-shur të dyzetat. Kishte trup të bëshëm, të fortë e të drejtë si një shkop. Kishte fytyrë të rrumbu-llakët, lëkurë të bardhë dhe dy sy të bukur si ba-jame. Buzët e vogla, gjithmonë të shtrënguara i jepnin fytyrës së saj një shprehje të ashpër. Ishte martuar e re, pa i mbushur të shtatëmbëdhjetat.

I shoqi, Demir Çelati njeri i urtë dhe punëtor, kishte marrë me qira një copë tokë në faqen e një kodre të butë dhe në shtëpinë e vogël jetonte vetëm me prindërit e moçëm. Por një muaj pas martesës kishte vdekur babai i Demirit. U sëmur e vdiq si gjithë njerëzit. Por në fshat nisën të dëgjohen lart e poshtë disa pëshpëritje se, fajin e kishte nusja që nuk i donte prindërit e burrit dhe nuk u bënte shërbim. Shtëpia e tyre ishte e mënjanuar nga pjesa tjetër e fshatit dhe Demiri nuk ishte njeri shumë i shkueshëm. Po ashtu ishte edhe Vaja, që nuk lidhte miqësi me gra të tjera dhe burr'e grua jetonin të shkëputur nga njerëzit.

Fjalët e njerëzve u shtuan edhe më shumë kur pa kaluar tre muaj vdiq edhe vjehrra. Atëherë tërë fshati nuk kishte tjetër në gojë veç emrin e Vaje Çelatis.

— Ajo shtrigë i la të vdesin për bukë prindërit e burrit! — thonin disa.

— Bile i ka rrahur e munduar — shtonin të tjerë.

Disa arrinin të thonin se Vaja është e xhindosur, ka dreqin në bark. Prej saj u xhindos edhe shtëpia. Të gjithë njerëzit e asaj shtëpie do të vdesin. Ja, të shihni kur të vdesi edhe i shoqi.

Por Demiri kishte rrojtur dhe e donte shumë të shoqen. Si gjithnjë ata rronin të mënjanuar, pa u trazuar me të tjerët dhe pa hyrje e dalje. Vaja kishte vetëm një motër të martuar në Shijak dhe rrall takohej me te, kurse Demiri kishte disa kushërinj në një fshat tri orë larg. Ajo që ia kishte shkretuar jetën atyre ishte mungesa e fëmijëve.

Nuk kishin lënë gjë pa bërë e pa provuar. Vaja vetë kishte shkuar te një plakë që i kishte dhënë të pijë disa barna të hidhur. Asgjë. Demiri e kishte dërguar te mjeku në qytet. Prapë asgjë. Dy vite me radhë kishte shkuar në Durrës ditën e Shëngjergjit dhe ishte larë në det. Thonin se atë ditë gratë bëheshin pjellore dhe lindnin. Por gjithnjë asgjë. Shtëpia e tyre e mënjanuar kurrë nuk kishte ushtuar nga qarja ose qeshja e ndonjë foshnje.

Ata kishin vazhduar të jetonin për shumë vite pa fëmijë, pa gëzime, por të rrethuar nga dashuria për njeri tjetrin. Të dy ngriheshin pa zbardhur, punonin gjersa dielli fshihej prapa kodrave të Durrësit dhe binin pa u ndjerë hijet e mbrëmjes. Nga ajo copë tokë dhe nga një bahçe e vogël merrnin pak breqet dhe një dorë zarzavate sa për të jetuar. Me shumë mundime kishin mundur të blejnë një kalë që i duhej Demirit për të vajtur në qytet. Kali ishte e vetmja pasuri e tyre dhe Demiri e donte jashtë masës dhe kujdesej për të parreshtur.

Një pranverë, ndërsa mani kishte nxjerrë gjetin e ri, në fshat erdhën disa ushtarë të huaj që i vështronin fshatarët vëngër dhe vazhdimisht flitnin me zë të lartë e thërrisnin. Pa e pyetur fare ata kishin ngritur çadrat te toka e Demirit, se aty nuk kishte lagështirë dhe kodra ja priste erën. Ata i shkelën me këpucët e tyre të rënda plot gozhdë brazdat e porsambjellura dhe, kur Demiri shkoi e ngriti zërin, askush nuk e dëgjoi. Atë vit ata jetuan më keq se herët e tjera. Keq jetuan edhe vitin tjetër.

Prapë mani u xhvesh e u vesh me gjethe të

reja dhe atëherë nëpër fshat filloi të hapet fjala se në male kishin dalë disa të rinj që luftonin të huajin dhe donin të çlironin Shqipërinë. Demirit i erdhën shumë për zemër këto fjalë dhe ai nisi të shpresojë se së shpejti të huajt do të shporrreshin prej arës së tij dhe nëpër rrugët e qeta të fshatit nuk do të dëgjohej më ajo gjuhë e huaj.

Një natë të errët shkurti, në shtëpinë e Demirit erdhën tre njerëz të armatosur, të veshur gjysmë civilë dhe gjysmë ushtarakë, me shalla të kuq rreth qafës dhe me një yll në kapele.

— Jemi partizanë — thanë ata dhe me një zë përshëndetën të tre:

— Vdekje fashizmit!

Në fillim burr e grua kishin ndenjur të heshatur duke shikuar tërë habi ata njerëz me fytyra të rrëshkura, me tipare të ashpra, që hanin të uritur ato pak gjëra që u kishin vënë përpara. Biseda që kishin bërë me ta u kishte kthjelluar shumë gjëra fshatarëve dhe ata i kishin kuptuar qëllimet e luftës së tyre, si lufta e «të gjithë të shtypurve e të varfërve».

Burr e grua u kishin thënë të flinin atë natë e të shlodheshin, por më i vjetri nga ta u ishte përgjegjur se «kishin punë».

Pas një ore në fshat ishin dëgjuar të shtëna pushkësh dhe Demiri me të shoqen e kishin kuptuar menjëherë se partizanët po luftonin kundër të huajve. Në fund të betejës shumë nga ushtarët ishin vrarë dhe çadrat e tyre ishin djegur. Megjithatë Demiri nuk e mori përsëri arën, se çadrat e djegura u zëvendësuan me çadra të reja, kurse ushtarët e vrarë me ushtarë të tjerë që flitnin po atë gjuhë dhe thërritnin parreshtur.

Megjithatë Vaja e Demiri tani nuk dëshpëro-
heshin si përpara se në zemrat e tyre kishte lë-
shuar rrënjë shpresa e ditëve të mira që do të vi-
nin.

Por, ja mani përsëri u vesh e përsëri u xhvesh
nga gjethet dhe, kur filluan shirat e vjeshtës,
nga fshati i tyre ikën të huajt dhe ara te kodra
u bë përsëri e Demirit. Njerëzit morën frymë li-
risht. Por kjo nuk zgjati shumë se në vend të
ushtarëve të parë erdhën ushtarë të tjerë po aqë
të këqij sa të parët që megjithëse ishin të ve-
shur ndryshe dhe flitnin një gjuhë të ndryshme,
ngjasonin me të parët si dy gjethe mani. Prapë
e zunë arën e Demirit, prapë në rrugët e qeta të
fshatit ushtuan fjalët e një gjuhe të huaj dhe
prapë fshatit i ra hieja e zezë.

Tani lufta që bëhej maleve dëgjohej përhierë më
shumë e përherë më afër. Njerëzit i ngrohte shpresa
më shumë se zjarri i vatrës në ditët e ftohta plot la-
gështirë e erë. Edhe Demiri e Vaja rronin duke
pritur. E kishin jetën të vështirë. Demiri u shtër-
ngua të shesë edhe qetë e parmendës sa të ka-
lonin dimrin.

Një ditë nëndori, kur shkoi në Shijak të shesë
disa pula, njerëz të huaj e vranë nga qielli dhe
e shoqja e varrosi pranë manit të madh e degagjërë
të oborrit. Vdiq i dëshpëruar, pa i parë të huajt duke
u larguar nga fshati.

* * *

Sa ishte i shoqi gjallë, Vaja mbahej e fortë
dhe i përballonte vështirësitë. Por tani që ai nuk
ishte më, ajo nisi ta ndjejë thellë vetminë dhe

mërzitej e trishtohej. Si gjithnjë, hynte e dilte pak me njerëzit e tjerë të fshatit. Vetëm me shtëpinë e Dellçëve mbante lidhje të mira dhe kryente ndonjë punë. Tani që kishte mbetur qyqe e vetme, njerëzit nuk e zinin më në gojë, por u vinte keq për atë grua që jetonte fillikat në atë shtëpi të vjetër me të shoqin varrosur te mani dhe me një kal në bodrum.

Disa muaj pas vdekjes së Demirit, në shtëpinë e saj erdhi një ditë plaka e Dellçëve. Vaja u habit shumë për atë vizitë dhe në fillim nuk e kuptoi pse kishte ardhur. Pastaj plaka i tha se ishte e vështirë të jetonte vetëm një grua, madje kjo gjë nuk bënte as përshtypje të mirë në sytë e njerëzve. Pas kësaj hyrjeje, plaka ja hodhi fjalën Vajes për t'u martuar dhe i përmendi emrin e një fshatari të shpërngulur, që punonte si argat i cili ishte gati të martohej me të. Vaja e dëgjoji e qetë, pa i ndryshuar fare fytyra, pastaj ja preu shkurt duke i thënë se martesë nuk ishte për të dhe se kishte vendosur të vdiste pa futur njeri të huaj në shtëpi. «Njëherë lind e vdes njeriu e njëherë martohet» i tha ajo në fund plakës së Dellçëve. Ndoshta do të gjej ndonjë fëmijë ta rrit e të jetoj me të. Nga mënyra si i kishte thënë ato fjalë, plaka e kishte kuptuar që ishte e kotë të ngulte këmbë për martesë.

Pasi e përcolli plakën te hyrja e oborrit, Vaja u kthye prapa me çapa të ngadalta. Por nuk hyri brenda. Qëndroi para grumbullit të dheut pranë manit, qëndroi gjatë dhe e menduar. Atë natë nuk fjeti shumë, por u përpëliti në shtrat derisa drita e ndrojtur e agimit hyri ngadalë në dhomën e saj të qetë.

U ngrit menjëherë. Megjithëse nuk kishte shumë punë, ashtu ngrihej përditë dhe shkante te kali në bodrum. Ajo gjithnjë e kishte dashur dhe ishte kujdesur për atë kafshë të bukur. Por tani që Demiri nuk ishte më, ajo e donte edhe më shumë kalin. E pastronte thuajse çdo ditë, ja krihte jelet e gjata që i derdheshin rreth qafës së gjatë si një ujëvarë e ndritur ngjyrëgështenjë. Zgjidhte për te ushqimin më të mirë dhe qurin ja mbante gjithmonë pastër. Kur e ndjente se turfullonte nga mërzitja, Vaja e zgjidhte, pastaj e shëtiste disa kohë nëpër oborr sa t'i shpiheshin këmbët e të thithte ajër të pastër. Sa herë që kali hante, ajo i qëndronte pranë e kënaqej duke e parë që mbllaçitej me zhurmë dhe tundte bishtin e gjatë majtas e djathtas si lavjerësi i një sahati të madh. Kur shtrohej për të fjetur, ajo dëgjonte e gëzuar çukëritjet e këmbëve të tij në bodrum dhe i dukej se nuk kishte fare vetëm në atë shtëpi të heshtur. Nga gjithë punët e shtëpisë, kujdesi për kalin ishte gjëja që i hante më shumë kohë. Edhe pasi e pastronte e i jepte të hajë, shkante shpesh në podrum për të ndenjtur pranë tij dhe për t'ja përkëdhelur shpinën e drejtë, këmbët e holla dhe fytyrën e zgjatur. Ndërsa dora e saj lëvizte mbi lëkurën e lëmuar, kafsha e shikonte me sytë e lëngshëm e të trishtuar.

Kështu kaloi dimri i parë pa burrë. Kaluan javë e muaj. Nisi të afrohej pranvera. Toka avulloi e pemët u gjallëruan e nxorrën gjethet e para. Vaja e kishte punën pisk. Paratë e qeve të shitura nisën t'i mbarohen. Pasi u mendua gjatë, ajo vendosi të shkojë në Shijak tek e motra për të shitur disa plaçka.

Një ditë të kthjellët prilli u zgjua më shpejt se ditët e tjera. Hapi sepetin e madh, të stolisur me lule e të lyer me bojë të kuqe dhe nxorri së andejmi ferexhenë e zezë. E shkundi dhe e vuri sipër minderit. Pastaj doli nga dhoma dhe shkoi në bodrum. Qielli ishte akoma i errët dhe yjet e fundit ndriçonin. Vetëm nga lindja një brez ende i pafuqishëm drite tregonte se kishte nisur të zbardhë. Një puih e lehtë bënte të dridheshin gjethet e reja të manit. Kur hyri në bodrum, një afsh i rëndë ja pickoi flegrat e hundës. Kali porsa ndjeu që u hap dera, ktheu kokën. Vaja e fërkoj trupin e tij të nxehtë, pastaj nxorri pajimet. Ju afrua dhe i vuri shalën. Shtaza që kishte kohë pa e ndjerë mbi shpinë peshën e shalës, në fillim kundërshtoi dhe çukërmoi tokën me thundra, por shpejt u qetësua. Vaja i vuri frerin dhe e nxorri në oborr duke e lidhur te shtylla e çardakut. Hyri në dhomë dhe u gatit për rrugë; kyçi derën me kujdes, qëndroi pak pranë grumbullit të dheut aty te mani, pastaj i kërceu kalit në shpinë dhe, duke tundur frerin, i ra lehtë me thembra mu në bark.

Shtaza u nis menjëherë. Kali e kishte pritur prej kohësh këtë çast. Duke ecur trok i përpinte fushat dhe arat ende të përgjumura. Edhe Vaja që kishte kohë pa dalë nga shtëpia, ndjente gëzim duke vrapuar. Mbante me dhëmbë cepin e shamisë së bardhë ndërsa ferexheja i fryhej nga era si veli i një barke. Për të shkuar në Shijak mori rrugën më të gjatë vetëm që mos të kalonte nëpër rrugën automobilistike. Kaloi nëpër fshatra ende të përgjumura. Nga kasollet ngriheshin shtëllunga tymi të kaltër drejt qiellit të zbetë ku

po shkriheshin yjet e fundit. Rrugës nuk takoi asnjë ushtar të huaj.

Arriti në Shijak në një kohë me diell. Qyteti i vogël buzë lumit të Erzenit ishte i qetë si gjithnjë. Pak shtëpi, pak dyqane e në të rrallë ndonjë automobil. Civila e ushtarë kalonin nëpër rrugët e bardha prej pluhuri. Pranë lumit, shelgjet derdhnin floknajat e tyre të blerta drejt ujit të turbullt që rridhte shumë ngadalë.

Të motrën e gjeti duke ndenjtur pranë dritares, mbëshjellur me një batanie të vjetër ushtarake. Ajo i tha Vajes se atë ditë ishte ngritur prej shtratit pasi kishte lënguar tërë dimrit. Fytyra e saj e gjatë, e hequr ishte e fishkur dhe e mbuluar nga rudhat si ajo e një plake. Vaja i tregoi për vdekjen e të shoqit, po nuk i tregoi shumë për vështirësitë e saj. Burri i motrës ishte mishtar dhe bridhte andej këndeje për të gjetur bagëti që i therte vetë dhe i shiste në një dyqan të vogël e të errët në një qoshe të pazarit. As e motra e Vajes nuk kishte fëmijë dhe bënte një jetë të xhveshur nga çdo gëzim. Kur i tregoi për qëllimin e vizitës, e motra i tha se ishte vështirë të gjente njerëz për t'u shitur plaçkat, por megjithatë i shoqi njihte shumë e ndoshta do të të mund t'i bënte gjë. Po këto fjalë i tha edhe mishtari kur u takuan me të në drekë. Vetëm fjalë të mira dhe asgjë tjetër. Vaja ndenji sa për të ngrënë drekë, bleu pak miell misri e disa kile mish dhe, kur dielli u anua nga kodrat e Durrësit, u ngrit dhe shaloi kalin.

U përqaftua me të motrën. Ajo u nda nga Vaja me lot në sy. Pasi kaloi oborrin ktheu kokën

dhe e pa aty në prak të dritares mbështjellë me batanien e vjetër ushtarake.

Në mbrëmje arriti në afëristë e fshatit. Diç-lli kishte perënduar dhe kali ecte trok duke ngritur pas vetes pluhur dhe duke bërë që të ushtonte toka nën thundrat e tij të forta. Vaja ndjente kraharorin që i mbushej me ajër të freskët dhe i dukej se duke vrapuar sikur largohej nga brengat e jetës, sikur po shkonte në një vend tjetër të mrekullueshëm ku nuk kishte ushtarë të huaj, ku njerëzit nuk rrinin të strukur nëpër shtëpi dhe nuk vuanin për bukën e gojës. Ecte e gëzuar dhe ndjente se tërë plogështia që i kishte kapliuar gjymtyrët muaj me radhë ishte zhdukë njëherë e përgjithmonë.

Por gjysmë ore para hyrjes në fshat, në një sop, i dolën përpara disa ushtarë të huaj dhe një civil i veshur me të zeza. I bënë shenjë të qëndrojnë.

— Ku po shkon? — e pyeti civili duke e shikuar me sy të keq.

— Në fshat — u përgjegj ajo duke ngritur dorën përpara dhe pa ja hequr sytë njeriut me të zeza.

— Nuk bën të shkosh atje — tha prapë ai.

— Po atje e kam konakun — kundërshtoi ajo.

— Nuk bën të thashë. — Ktheu prapa — urdhëroi ai ashpër.

Vaja ktheu kalin dhe shkundi frerinin. «Po i bie rrotull, tha me vete» dhe të hyj në fshat nga prapa. Me këto dreqën nuk merresh vesh.

Eci gati një orë, shpesh duke e gjetur rrugën e drejtë me hamendje. Ishte errur fare. Në qiell

ishin shojtur shkëlqimet e ditës dhe yje të rallë dridheshin si leskra të arta. Kali ecte gjithmonë trok dhe nuk jepte shenja lodhjeje. Papandehur ca krisma pushkësh u dëgjuan pas shpinës së saj. Ca të tjera u përgjegjën nga ana e kundërt. Pastaj një batare shungulluese dhe një gjënim i rëndë. «Diçka po ngjet në fshat mendoj ajo», duket kanë zbritur partizanët dhe po luftojnë kundër të huajve».

E ngau kalin shpejt. Një gjënim tjetër më i fortë se i pari e bëri kalin të kërcëjë i trembur dhe të ndalë në vend. Gjëmimin ja përcollën njera tjetrës kodrat përreth, derisa ai u shua larg. Kali qëndroi me veshë të ngritur, duke turfu-lluar nga flegurat e gjëra.

Papandehur Vajes ju duk se i zuri veshi një pëshpërimë zërash. Pastaj një kaçubë lëvizi dhe një zë i ashpër e pyeti:

— Kush je ti?

— Një grua, banoj në fshat, — përgjegji Vaja getë. — Po ju çfarë jeni?

— Jemi partizanë. A ke ujë me vete për një shok të plagosur?

— Nuk kam.

— Lere Ndreko, do të duroj edhe pak — foli një tjetër që siç dukej rrinte në krahët e të parit.

— A pe rrugës gjermanë?

— Po, ishin në të hyrë të fshatit.

— Kur i pe?

— Para një ore.

— Viron mbaju — i tha Ndrekoja të plagosurit — të nisemi.

— Më ler këtu? Do të të pengoj.

— Mos u bëj budalla.

— Më ler, po të them. Unë jam gati i vdekur. Këmbët nuk i ndjej. Do të na zënë të dyve.

— Mbylle gojën. Mbaju te supi. Natën e mirë moj motër. Vdekje fashizmit!

Nisën të ecin me vështirësi të madhe. Vaja ndali kalin dhe qëndroi pa lëvizur mbi samar duke i ndjekur me sy. — Keq e kanë — tha me vete — këta janë heroj.

Po këtë çast disa krisma pushkësh shqyen terrin e natës dhe kali bën prapa.

— Pritni — u thirri Vaja.

Ata s'e ndëgjuan. Ajo i dha kalit përpara. I arriti.

— Hype shokun në kalë dhe largohuni të dy — i tha Ndrekos pasi zbriti nga kali.

Pa e zgjatur i ndihmoi atij të ngarkojë të plagosurin pastaj rregulloi frerin dhe ja dha Ndrekos.

— Falemnderit, motër. Mirupafshim në Shqipëri të lirë. Vdekje fashizmit.

I ra kalit në bark, por ai nuk lëvizi. Vaja u afrua, i ra lehtë në shpinë dhe i tha ngadalë:

— Nisu.

Dorën nuk e hoqi nga lëkura e tij e butë. Kali u shkëput nga vendi dhe ajo e dëgjoi si i iku nga dora lëkura e lëmuar.

Qëndroi aty, derisa krismën e këmbëve të tij e përpipu errësira e natës.

Kur arriti në shtëpi, nuk hyri brenda, por ndenji gjatë para grumbullit të dheut në oborr, pranë manit. Krismat e pushkëve vazhdonin dhe

asaj i dukej se po dëgjonte trokun e kalit nëpër natë.

Pastaj hyri brenda dhe hapi dritaren. U shtri në minder pa u xhveshur. Ajri i natës ja përkëdheli fytyrën e nxehtë. Jashtë dëgjohehin gjithmonë krismat e pushkëve të partizanëve.

Dhe ato krisma ju dukën Vaje Çelatis sikur po e vritnin edhe vetminë e saj.

NATA E FUNDIT

Djaloshi hyri në portin e Durrësit pas orës dhjetë. Para doganës qëndroi një çast:

— A është nisur vapori për në Itali? — pyeti një burrë që ishte te dera.

— Jo, sonte do vonohet. Keni fat.

— Ku është ankoruar?

— Tek ura me dërrasa.

— Ju falemnderit.

— Udhë të mbarë!

Djaloshi pak i qetësuar, zuri të ecë më ngadalë. E kishte lodhur shumë valixhja e madhe dhe e rëndë që kishte me vete. Herëpashere e kalonte nga një dorë në tjetrën. Binte një shi i qetë, i imët. Në dritën e fenerëve të rrallë ai dukej si një pluhur i ndritshëm. Nata e dhjetorit ishte e errët e me lagështirë. Djaloshi ndjente se këmbët i ishin lagur duke rënë nëpër llonxha dhe pikat e ujit i rrëshqisnin nëpër flatrat e kapeles. Kaloi një depo ku shiu trokiste nëpër llastrat e çatisë si mijëra gishta dhe pas asaj pa dritat e një vapori pasagjerësh. Lexoi në bash emrin «Barletta» dhe psherëtiu i qetësuar.

Para shkallëve të vaporit ish një oficer xhandarmërie dhe një nëpunës i portit.

— Jeni udhëtar? — e pyeti civili dhe papritur përgjegjen shtoi: — Paraqitni pasaportën dhe biletën.

Djaloshi zbërtheu pardesynë.

— Si quhesh? — e pyeti oficeri, ndërsa nëpunësi hapi faqen e parë të pasaportës.

— Millosh Gjergj Nikolla.

— Me ç'punë merresh?

— Jam mësues.

Nëpunësi i ktheu pasaportën.

— Pse shkon në Itali? — e pyeti përsëri oficeri duke e parë ngultas.

— Për qejf — përgjegji Milloshi me qesëndi. Pastaj mbërtheu pardesynë dhe nisi të ngjisë shkallët luhatëse të vaporit.

Tek përshkonte koridorin e gjatë e të ngushtë të katit të poshtëm i shoqëruar nga një marinar flokëdredhur, djaloshit ja preku hundët një kundërmim i rëndë naftë e boje të freskët. E zuri kolla.

— Qenkeni ftohur. — tha marinari.

— Ashtu duket. — përgjegji buzagaz Milloshi dhe, pasi ecën edhe pak, tha — A do të nisemi shpejt?

— Presim kapitenin. Sonte është për darkë te drejtori i shoqërisë «Adriatik».

— Me ç'rast bëhet kjo darkë?

— Keni harruar se pas tre ditësh është nata e Krishtlindjeve?

— Keni të drejtë, me njëzetekatër dhjetor, në orën dymbëdhjetë lind për të njëmijëenëndëqindetridhjeteshtatën herë Krishti. Është pak e mërzitshme të lindësh e të vdesësh çdo vit, apo jo?

Marinari ktheu kokën dhe e vështroi me çudi atë djalosh të gjatë, të hequr e me sy të ëmbël. Duke ecur panë një çift të shkuar në moshë që hynë në palmetë duke u grindur. Në fund të koridorit, marinari qëndroi, hapi një derë dhe tha:

— Urdhëroni! Ky është vendi juaj. Uroj udhëtim të mirë.

Dhe u largua.

Miloshi qëndroi pak para derës së hapur. Dëgjoi hapat e rënda të marinarit që ushtonin në koridorin e gjatë. Në palmetë kishte dy shtretër. «Sa mirë do të jetë sikur të mos vijë njeri» mendoi Miloshi. Ajri brenda ishte i rëndë. Ai la valixhen dhe hapi oblonë. Nga jashtë hyri një rrymë e freskët ajri dhe zhurma e butë e shiut. Ai qëndroi para oblosë së rrumbullakët duke këqyrë dritat e dridhëshme që pasqyroheshin në det.

Pastaj hoqi pardesynë, shkundi kapelen dhe ju afrua pasqyrës që të krihej. Shikoi me vemendje fytyrën e vet, sikur ta shihte për herë të parë. Lëkura ish e zbetë, e hollë dhe gati e tej-pashme. Sytë e ëmbël ishin qarkuar me rrathë bojëqielli të errët, ishin të lodhur dhe si të veshur nga hijet. Padashur i erdhën në mend disa vargje të poezisë së tij: «Vuajtja»

«. .nga vuajtja sytë po më madhohen.
Nëpër ball' e ftyrë rrudhat po më shtohen,
E si buzëqeshja m'asht e hidhun...

U largua nga pasqyra pa u krehur. U shtri në shttrat me duart pas zverkut e me sytë lart. Ato vargje i sollën në mend historinë e botimit të librit të tij. Sa dëshirë kish patur që t'i shihte të

botuara në libër «Vargjet e lira»! Do të kish qëndruar prapa dyerve të librarive e t'i shihte një-rëzit duke dalur së andejmi me librin e tij në duar. Për botimin e tij ai kishte shpenzuar edhe të hollat e ilaçeve që i kish ruajtur për të shëruar sëmundjen që po ja shterte burimin e jetës. Tani po shkonte në Itali për t'u shtruar në një sanatorium. A do të kthehej më? A thua kjo është nata e fundit që po kalonte në Shqipëri? E fundit? Nuk do të kthehej më kurrë në këto brigje?

Hoqi mendimet e zymta dhe brofi nga shtrati. Ju duk sikur aty brenda po i zihej fryma. Hodhi pardesynë krahëve dhe doli në kuvertë. Nuk dukej asnjë shenjë për nisjen. Ai zuri vend nën një strehë dhe qëndroi aty i palëvizur, duke dëgjuar zhurmën e shiut. Përballë vaporit ish një kafe e vogël, thujse e boshatisur, me tryeza të pambuluara, me një banak të ulët pas të cilit ishin rrjeshtuar shishe të ndryshme.

— Si duket puna, a do të nisemi shpejt? — pyeti një marinar që po kalonte.

— Kapiteni nuk duket në horizont. — Përgjegji ai duke qeshur.

— A mund të zbres e të pij ndonjë gjë tek ajo kafene?

— Zbritni, por kur të shihni një burrë të gjatë, tullac që do të ecë duke u tundur si anije në stuhi, hypni shpejt në vapor se ai është kapiteni.

Duke përshkuar hapësirën që ndante vaporin nga kafeneja, Milloshi dëgjoi zërin e trashë të një burri që thirri:

— Kape prapa shtyllën. Ashtu. Tani ngrije në sup. Ho-op! ho-op!

Ktheu kokën. Ishin dy hamej që po ngarkonin qereste në një barkë të vogël. Ai që thirri ish një burrë shtatmadh, shpatullgjërë, i veshur me lecka e i qullur nga shiu si një sfungjer i futur në ujë. Flokët e dendur i ishin ngjitur pas ballit. Pasi e ngriti shtyllën në sup, hamalli bëri disa hapa duke ju marrë këmbët, pastaj e ngriti shpinën, eci drejt barkës me hap të sigurtë dhe papandehur nisi të këndoje. Milloshi qëndroi aty në shi, pa lëvizur. E shoqëroi hamallin me sy dhe ja pat zili fuqinë e supeve dhe optimizmin. Pastaj shpejtoi hapin dhe u fut në kafene.

Brenda në lokal ishin dy-tre civila të shpërndarë në dy qoshe. Pas banakut ish një burrë flokëbardhë, hundëkrrut. Më tej ishte ulur një djalë i ri që shkruante diçka.

— Një konjak. — Porositi Milloshi duke mbështetur bërrylin në banak.

Kur pa gotën para vetes, u mendua një çast pastaj e rrëmbeu me të shpejtë, mbylli sytë dhe e rrokullisi në gojë. Ndjeu një valë nxehtësie, që ju përhap në tërë trupin. Rrudhi buzët dhe e zuri kolla. Banakieri flokëbardhë qeshi:

— Konjak i fortë! — tha.

— I fortë.

— T'jua mbush edhe një?

— Jo. Mjafton.

Pagoi dhe i shtyrë nga kureshtja, ju avit djalit, që në qoshe të banakut shkruante i qetë, pa e ngritur kokën. Vuri re se djali kishte para vetes një numër të revistës «Bota e re». Ai lexonte diçka aty, pastaj shkruante në një fletore. Duke vërejtur me kujdes, Milloshi vuri re se ai po hidhte në fletore: «Legjendën e misrit» të cilën

ai e kish botuar në atë revistë para një viti dhe pikërisht më 15 tetor të 1936-ës. Ndjeu se e pushtoi një gëzim i papritur.

— Çfarë po shkruan ashtu?

Djali ngriti sytë dhe e vështroi pak i habitur. Pastaj tha:

— Një letër.

Milleshit i ndritën sytë dhe e pyeti pa e zgjatur:

— Të pëlqen «Legjenda e misrit»?

Djalit i qeshi buza dhe pa ngurruar përgjegji:

— Shumë. — Pas pak shtoi — Ju mos jeni shkrimtar?

— Jo, jam mësues. Por atë shkrim e njoh mirë.

— Ju pëlqen?

— Si të them...

— Mua më pëlqejnë të gjitha shkrimet e Migjenit. Çdo gjë që ka botuar ai unë e kam kopjuar me dorë. Si unë kanë bërë edhe shumë të tjerë. Kam dëgjuar se për së shpejti do të qarkullojë një vëllim me poezi të Migjenit. A është e vërtetë kjo?

— Ashtu qe fjala. Migjeni e dërgoi librin «Vargje të lira» për botim. Libri gati u shtyp i tëri, por qeveria nuk aprovoi qarkullimin e tij.

— Nuk është për t'u çuditur. — tha djali me inat dhe balli ju mvrejt.

— Me ç'punë merresh ti...

— Më quajnë Bardhyl. Jam marangoz. Pasi mbaroj punën, vij e ndihmoj babanë këtu në banak.

— Sa shkollë ke bërë?

— Kam kryer filloren. Më shumë babai nuk pati mundësi të më mbajë në shkollë. Mua më pëlqente shumë të mësoja. I dua shumë librat dhe gjithnjë lexoj.

— Sa vjeç je?

— Shtatëmbëdhjetë.

Papandehur, aty pranë u dëgjua zëri i çjerrë e i dridhur i sirenës së vaborit.

— Duhet të iki. — Tha Milloshi duke u shkëputur nga banaku — Natën e mirë Bardhyl. Duaji librat.

Doli jashtë me të shpejtë. Duke ngjitur shkallët e vaborit dëgjoi përsëri hamallin e mëparshëm që këndonte.

U dëgjua edhe dy herë sirena, pastaj u zgjidh ankora dhe vapori nisi të shkëputet ngadalë prej urës me dërrasa.

Milloshi nuk hyri në palmetë. Qëndroi aty në kuvertë me sytë e ngulur në port. Në veshët e tij vinte akoma jehona e këngës së hamallit dhe ndërsa vapori largohej, jehona nuk shuhej por rritej, rritej e ngjante si një hymn optimist shprese; në sytë e Milloshit ishte akoma djali punëtor, që dukej sikur nuk shkruante por gdhendte fjalët e zjarra të «Legjendës së misrit» dhe figura e tij nuk zvogëlohej por rritej, rritej duke marrë përpjestimet e një vigani.

PORTIERI I HOTELIT

Muzg dhjetori. Mbi Berlin është nderë një mjegull bojëhiri, e dendur dhe plot lagështirë. Megjithëse ende nuk është errur, dritat e udhëve e të shtëpive janë ndezur qëkur. Reklamat e dyqaneve e të lokaleve ndizen e fiken duke shpërndarë reflekse të mekura. Njerëzit ecin të mbështjellur në kapota të rënda dhe zhduken në tymin e dendur të mjegullës.

Janë ndezur edhe dritat e hotelit «Adlon». Para hyrjes, portieri ecën posht e lart, duke përplasur këmbët që të mos mërdhijë. Ai ka veshur uniformën bojëqielli të hotelit. Në kokë ka një kapele të madhe me strehë, shirit të artë, ku është shkruar fjala «Adlon». Portieri është plak njeri, me sy gati të bardhë dhe vetulla e mustaqe të thinjura.

«Ftohët sonte» tha me vete plaku dhe ju kujtua se duhej të rrinte edhe pesë orë të tjera aty gjer sa të mbaronte shërbimin. «S'po vjen njeri» shtoi pastaj duke tundur kokën. «Të pak-tën të shoh ndonjë fytyrë të re e të fitoj ca pfeningë sa për të hedhur një gotë shnaps!»

Para hyrjes së hotelit kalonin shumë vetura. Plaku i shihte dritat e tyre që shponin me zor

perden e mjegullës dhe ndiqte me sy automobilat që shkitnin pa zhurmë në asfaltin e lagur. Ndërsa kalonte kohën kështu, vuri re një veturë të gjatë, të zezë e cila qëndroi para hyrjes. Plaku rregulloi uniformën dhe me hap të shpejtë ju afrua, kapi dorezën e portës së pasme dhe e hapi. Brenda ish errësirë. Në fillim atij ju duk sikur s'kish njeri. Pastaj dëgjoi tek krisën lehtë sustat e ndënjësës dhe pa një fytyrë që ju avit derës. Ish një burrë me fytyrë të gjatë, pak të hequr e me sy të mëdhenj.

— Hoteli Adlon? — pyeti i huaji me zë të qetë e gati si të përgjumur.

— Siurdhëroni, zotni.

Ai pagoi dhe zbriti nga maqina. Ish një burrë trupshkurtër që mbante një kapotë bojëkafe me jakë gëzofi. Pas tij zbriti edhe shoferi që nxorri nga fundi i maqinës dy valixhe. Portieri ja mori nga duart dhe u nis pas të huajit, ndërsa vetura u largua dhe pas pak u zhduk, sikur ta kish përrpirë mjegulla e muzgut të dhjetorit.

— Para dy javësh kam dërguar një telegram që të më rezervoni një apartament — i tha zotëria me kapotë bojëkafe nëpunësit që rrinte pas banakut në hollin e hotelit.

— Emri juaj, ju lutem?

— Aleksandër Moisi.

Nëpunësi e shikoi me habi, pastaj menjëherë zu të shfletojë me ngut një regjistër të madh, të zi. Shkuan ca çaste dhe ai thirri i gëzuar:

— Apartamenti juaj është gati: kati i dytë, numër gjashtë.

— Kam kërkuar të jetë nga ana e kundërt e rrugës.

— Siurdhëron, ashtu është. Vend shumë i qetë.

— Falemnderit.

Mori çelësin e u nis drejt shkallëve. Dy çuna të vegjël, të veshur me uniformën bojë-qielli të hotelit, morën valixhet nga duart e portierit e u nisën pas klientit. Kur arriti në krye të shkallëve ai ktheu kokën, pa plakun që s'kishte lojtur nga vendi dhe e përshëndeti me buzë në gaz. Pasi ai u zhduk në kthesën e shkallëve, plaku i tha nëpunësit të banakut.

— Cili është ky zotëria?

— Nuk e njeh? Është Aleksandër Moisiu, aktor i madh.

Plaku heshti një çast, përsëriti me vete emrin e të huajit, pastaj e pyeti prap:

— Gjerman është?

— Jo, thonë se është italian.

Pa kaluar as një gjysmë ore, Aleksandri zbriti shkallët dhe pas pak kapërceu prakun dhe doli në rrugë. Portieri plak po ndizte llullën e s'e vuri re. Ai u nis me hapa të shkurtra dhe u zhduk në mjegull.

U kthye pas dy orësh. Plaku po dremiste i mbështetur pas murit. Ai hapi sytë kur degjoi zhurmën e hapave. Në fillim s'e njohu atë që po vinte, por kur i pa pallton dhe të ecurit, u habit që ai vinte nga rruga.

— Mirëmbërëma! — e përshëndeti.

— Mirëmbërëma! — ja ktheu Aleksandri dhe shtoi: — Ftohët sonte?

— Siurdhëron, të ftohët i madh. Është hera e parë që vini në Berlin në dimër?

— Jo, kam qenë edhe herë të tjera.

— Domethënë e njihni dimrin tonë. — Tha plaku duke qeshur. — Ne jemi mësuar me të, kurse ju që jeni italian mërdhahni shumë.

— Nuk jam italian.

Plaku heshti dhe e kuptoi se bëri gabim pa dashur.

— Keni punë të vështirë. — Tha Aleksandri — Kur e lini shërbimin?

— Pas dy orë e gjysmë — tha plaku dhe shtoi — Puna është e vështirë, por jam mësuar. Epo duhet jetuar, apo jo?

— Si quheni?

— Klaus Hemering.

— Keni familje?

— Siurdhnon, gruan dhe dy djem të martuar. Njeri është marangoz, tjetri mekanik. Ky i dyti tani është pa punë dhe rri në shtëpi. Po ju?

— Unë kam nënën, një vëlla dhe dy motra.

— Po grua?

— Edhe grua kam.

Heshtën. Në rrugë kaloi një veturë. Mbasi u tret zhurma, portieri e pyeti:

— Do të rrini shumë kohë në Berlin?

— Varet nga puna. Sidoqoftë, do të rrij disa muaj.

— Çfarë do të çfaqni në teatër?

Aleksandri e shikoi i habitur. Nga e kish marrë vesh ai se ishte aktor?

— Disa role që i kam lojtur kur isha më i ri dhe po pregatis edhe dy role të tjerë. Për ju do të gjej biletë që të vini në teatër.

— Falemnderit.

— Vetëm më kujtoni se unë harroj. Natën e mirë, Klaus.

— Natën e mirë, zotëri.

Rruga ishte shkretuar. Dritat po shuheshin. Sheshi para hotelit u qetësua. Mjergulla ish gjithnjë e dendur dhe e lagësht e s'kish ndër-mend të zvaritej. Para hotel Adlonit dëgjohej vetëm zhurma e hapave të portierit plak, që ecte poshtë e lart që të mos mërdhijë.

* * *

Në vatrën e dhomës së Aleksandrit është ndezur zjarri. Aktori rri ulur në një kolltuk të gjerë me tekstin e pjesës në dorë. Pranë ka një tryezë ku janë vënë pa rregull libra, gazeta dhe një pjatë me ëmbëlsira. Është ora njëmbëdhjetë. Aleksandri ja ka ngulur sytë zjarrit dhe mendjen e ka të çfaqja që do të japë atë mbrëmje. Vetëm njerëzit që merren me teatër mund ta kuptojnë gjendjen shpirtërore të aktorit ditën e premierës. Për të asgjë nuk ekziston përveç asaj, asnjë mendim tjetër nuk ka vend në trurin e tij. Herë-herë aktorit i duket sikur nuk di asgjë, sikur premiera duhet shtyrë se ai ka nevojë për përgatitje të tjera. Çdo çast ai pyet veten: Si do të dal sonte? si do të më presë spektatori, ç'do të thotë kritika? Aleksandri është aktor me përvojë dhe i di surprizat që mund të të bëjë ajo gropë e ndritur që quhet skenë. Si gjithnjë, ai është përgatitur më së miri dhe është munduar t'i hyjë gjer në palcë personazhit që do të mishërojë. Sa i dashur është ai

personazh për të. Atë mbrëmje do të çfaqë Hamletin, ose më mirë do ta riçfaqë. Kësaj figure ai i ka dhënë jetë para disa vjetësh, dhe tani që është më i pjekur si njeri e si aktor do ta luajë rishtas.

Ndërsa qëndron kështu pranë zjarrit që buillon, i vijnë ndërmend vitet e para të jetës. së tij si aktor, i kujtohet sa ju desh të vuajë gjer-sa spektatorët e kritikët nisën ta duan e ta çmojnë. Sa zhurmë pat bërë shtypi kur në vitin 1912 Maks Rejhardti i besoi atij rolin e Hamletit. Edhe tani që po e lozte pas kaq vjetësh, Aleksandri kish diçka të re për të thënë e për t'i zbuluar asaj figure të madhërishtme. Mbrëmë, kur kishte bërë provën e përgjithshme, njerëzit që e kishin parë e kishin ngritur në qiell lojën e tij. Por ai vetë e dinte se kishte akoma gjëra që duheshin përmirësuar. Po kjo nuk është hera e fundit që do të luaj, i kishte thënë vetes, pas ca kohësh përsëri do t'i shtrohem punës, se role si Hamleti duhen punuar gjithë jetën.

Shikoi orën. Njëmbëdhjetë e gjysmë. Kishte pesë orë që po punonte. S'duhet të lodhem shumë, se sonte kam premierën, mendoj. Ç'të bënte? Të dilte? Në asnjë mënyrë. Po ta shihnin rrugës do ta ndalonin, do t'i kërkonin autografe e intervista. Ai në përgjithësi nuk dilte shumë rrugëve, kurse para ndonjë premiere zhdukej fare, bile ndërpriste edhe çfaqjet, vinte një shërbëtor para derës që mos të hynte njeri dhe qëndronte ashtu i mbyllur duke punuar me ngulm tërë ditën pothuaj pa asnjë ndërprerje.

U ngrit e i hodhi ca dru zjarrit, megjithëse nuk kish shumë nevojë. S'ke ç'e do sobën e kalo-

riferin, tha me zë duke vënë buzën në gaz, oxhaku të kënaq. U ul përsëri dhe padashur ju kujtua ajo dhoma e madhe në Durrës, kur mbrëmjeve ndizej oxhaku dhe tërë familja mbledhej rreth vatrës. Sa të lumtur e kish ndjerë veten në ato çaste! Edhe pasi ishte larguar nga Shqipëria ai kudo që ndodhej, në dimër ndizte oxhakun dhe i dukej sikur kjo gjë ja bënte pak më të afërt atdheun dhe i sillte ndër mend vitet që kishte kaluar nënë qiellin e kaltër të Shqipërisë.

Qëndroi pak ashtu si i përgjumur në kujtime, pastaj u ngrit dhe ju afrua raftit. Mori pa qejf një ëmbëlsirë dhe e kafshoi. Teksa përtypej, i shkuan sytë e pa gazetatat e më.gjezit. Në faqen e parë të njerës lexoi: «Shqipëria e parë me sytë e gazetarit.» La ëmbëlsirën në pjatë dhe mori gazetën. Ndezi një cigare, u ul dhe nisi të lexojë artikullin.

Pas disa minutash u ngrit i tronditur, e bëri gazetën shuk dhe e vërviti në zjarr. Vuri re si flaka u zmadhua një çast dhe gazeta u dogj e s'mbeti tjetër veçse një grusht hiri.

Sa gjëra të këqia dhe fyese shkruante ai gazetari për Shqipërinë. Ai s'kish parë aty veçse varfëri, njerëz të sëmurë, të leckosur e injorantë, qytete të ndyrë me shtëpi të vogla, të errëta si ahure bagëtish. Eci nëpër dhomë duke sharë e duke mallkuar gazetarin. Ai vetë e dinte se shumë gjëra që shkruheshin në gazetë ishin të vërteta. Por, përse gazetari nuk kishte folur edhe për vetitë e rralla të shqiptarëve, përse nuk tregonte shkaqet e asaj varfërie e përse nuk bënte fjalë për bukuritë e rralla të natyrës shqiptare?

Pak nga pak zemrimi ju zbut dhe atë e push-

toi një ndjenjë trishtimi. Por shpejt e mblodhi veten, mori në dorë tekstin e tragjedisë dhe ju vu punës.

Duke përsëritur aktin e dytë, skenën me Goldensternin e Rozenkrancin, ai shqipëtoi batutën: «Danimarka është një burk», ai qëndroi, ju kujtua atdheu dhe tha: «Shqipëria është burk.» Hodhi tekstin dhe u ngrit.

Trokiti dera. Aleksandri ju afrua derës së gëzuar që e shqetësuan pikërisht në kohën kur e kishin pushtuar mendime aq të zymta.

— Kush është?

— Jam unë, Hansi. — u dëgjua një zë i hollë.

Aleksandri hapi derën. Hansi ishte djali që ai mbante para derës për të mos lejuar njeri që ta trazonte.

— Ç'është, Hans?

— Tani ish këtu herr Petri, nipi juaj. Dësh të hyjë, por unë nuk e lejoval. Atëhere ai shkroi një pusullë dhe më porositi që t'ju jap menjëherë dhe shtoi se është diçka shumë e rëndësishme. Më falni që ju trazova. Urdhëroni.

I dha pusullën. Duke parë fytyrën e ngrysur si një re shiu të aktorit, ai priste nga një çast në tjetrin që të plaste stuhia e qortimeve. Por ja, atij sikur ju çel fytyra dhe djali psherëtiu i qetësuar.

— A mund të largohem, zotëri?

Aleksandri nuk ju përgjegj. Ai ishte i zënë sepse po lexonte letrën që i dërgonte i nipi. Ai i shkruante:

«I dashuri vetmitar. Sonte do të çfaqësh Hamletin. Erdha të të kujtoj që mos të harrosh të

porosisësh drejtorinë e teatrit që të ruajë llozhën tënde, se kemi ndërmend të vijmë bashkë me nënën të të shohim. Urime për premierën. Nipi yt që ka ardhur këtu të gëzojë jetën e jo të burgoset në dhomë si ti. Petro.»

Aleksandri vuri buzën në gaz dhe i tha Hansit të presë. Ju avit tryezës dhe nisi të shkruajë një pusullë për drejtorin e teatrit. Por në atë çast ju kujtua Klausi. Mbaroi së shkruari pusullën e parë dhe mori një fletë tjetër. Shkruajti: «Të lejohet Z. Klaus Homering të hyjë sonte në llozhën time.» I vuri datën dhe e nënshkroi. Pastaj ja dha djalit që ta çonte njerën në teatër dhe tjetrën t'ja jepte drejtorit të hotelit për portierin plak.

Kyçi derën, ndezi cigaren dhe u ul e nisi punën.

Sipari u mbyll duke nxjerrë një fëshfërimë të lehtë. Pas një heshtjeje të shkurtër, në sallë nisën duartrokitjet. Aleksandri u ngrit. Ishte i lodhur e i zbetë në fytyrë. Rregulloi me dorë një tufë flokësh që i kishin rënë në ballë dhe doli në paraskenë. Salla ishte ngritur në këmbë dhe duartrokiste e thirrte pareshtur. Çfarë suksesi! Gjatë karrierës së tij, ai nuk mbante mend një triumf të tillë. Qëndronte në paraskenë si i mpirë, ndërsa salla ziente e uturinte si deti në stuhi.

Pas disa minutash Aleksandri u largua nga skena. Duartrokitjet u shtuan. U kthye përsëri në skenë. Dhe kështu hyri e doli disa herë me radhë. Kur doli herën e fundit nga skena, çau me zor turmën e njerëzve që ishin në prapaskenë duke e pritur, u fut në kabinën e tij dhe ashtu i

veshur me kostumin e princit danez u shemb në një fron, i lodhur por i lumtur.

S'kaluan as dy minuta dhe trokiti dera. Hynë dy vajza që sollën shporta me lule. Para tyre vërshuan gazetarë, fotografë, aktorë, drejtori i teatrit dhe miq e të njohur. Në mes të tyre qenë edhe motra me të nipin. Aleksandri u përgjigjej fjalëve e pyetjeve, shtrëngonte duart, duronte i nënshtruar lavdërimet e dëgjuaara qindra herë.

«E pata më lehtë t'i bëj ballë me shpatë Larentit në skenë, sesa këtyre njerëzve», mendoi ai.

Pas disa minutash ai ju tha atyre se donte të xhvishej dhe se ishte shumë i lodhur. Njerëzit u larguan një nga një. Në kabinë mbeti vetëm e motra bashkë me Petron. Aleksandri vajti pas në paravento të xhvishej.

— Vetëm ishit sonte në llozhë? — u dëgjua pas pak zëri i tij.

— Vetëm — përgjigjji Petroja.

— Mos pritshe njeri, i dashur vëlla? — pyeti e motra.

— Po. I kisha dhënë një pusullë njerit për të hyrë në llozhën time.

— Ndonjë femre? — e ngacmoi nipi.

— Jo, një plaku, portierit të hotelit ku banoj. — përgjigjji serioz aktori dhe mendoi: «Përse nuk erdh sonte Klausi në çfaqje? Mos vallë drejtori i hotelit ka harruar t'i japë pusullën time, apo ka pasur shërbimin? «Kur taksia u ndal para hotelit «Adlon», Aleksandri vuri re se derën e automobilit ja hapi një plak tjetër, i panjohur.

— Ju, jeni me shërbim sonte te porta? —

— Siurdhëron, zotëri — përgjigjji plaku pak i habitur.

- Po Klaus i ku është?
- Tjetri heshti një çast, pastaj tha:
- Atë sot e kanë pushuar nga puna.
- E pushuan, po pse?
- Nuk e di mirë, por mora vesh se kishte harruar t'i hapte derën maqinës së një klienti, të një milioneri zviceran. Ky ishte ankuar në drejtorin dhe për të qetësuar atë, Klausin e pushuan nga puna.
- A e dini ku banon?
- Jo.
- Po si mund ta takoj?
- Nesër në mëngjes Klaus duhet të vijë këtu për të marrë rrogën. Po dal ta takoj unë dhe po i them se të kërkon zotëria...
- Aleksandër Moisiu, apartamenti numër gjashtë, kati i dytë nga e majta.
- Portjeri shënoi në një bllok emrin dhe numurin e apartamentit pastaj tha:
- Mos u bën merak, zotëri. Klausin do ta takoj unë. T'i them të vijë në dhomën tuaj?
- Po, në çdo orë qoftë. Falemnderit. Natën e mirë.

* * *

- Të nesërmen në mëngjes, në orën dhjetë e gjysmë, trokiti dera e apartamentit numër gjashtë në katin e dytë. Aleksandri u ngrit dhe e hapi.
- Erdhe Klaus?
- Siurdhëron, zotëri. Më kishit kërkuar?
- Po. Hajde brenda. Ku humbe kështu? Plaku nuk foli, vetëm vuri buzën në gaz.

Aleksandri e ndihmoi të heqë pallton e madhe dhe të dy u ulën pranë oxhakut të ndezur. S'dinin si t'ja nisnin bisedës. Plaku nxorri llullën dhe një qeskë të murme ku mbante duhanin. E hapi dhe filloi t'i shtjerë duhan llullës duke e shtypur me gishtin e madh.

— Mbrëmë më thanë sikur... a është e vërtetë se ty... — nisi të flasë Aleksandri pa e shikuar plakun.

— Po, e vërtetë është.

— Domethënë, të pushuan nga puna?

— Po.

— Se harrove t'i hapësh derën një automobili ku ishte një milioner zviceran?

— Po ju si e morët vesh këtë, zotëri? — u habit plaku.

Aleksandri vuri buzën në gaz:

— Nganjëherë, i dashuri Klaus, lajmet e këqia merren vesh më shpejt se lajmet e mira.

Plaku nuk foli por thithi llullën duke lëshuar një re tymi bojëqielli.

— Kjo është e rëndë për ty, apo jo? — e pyeti Aleksandri.

— E rëndë. Ju e dini se unë kam gruan dhe djemtë. Njeri ka dy fëmijë dhe është marangoz, kurse i dyti ka vetëm një dhe është pa punë. Me dy rroga, atë të djalit dhe timen disi e shtynim, por, tani që mua më hoqën nga puna...

Mos u mërzit, Klaus. — i tha Aleksandri me zë të lehtë. Ndezi një cigare, e hoqi thellë, pastaj u ngrit papritmas në këmbë.

— Do të hedh një gur në ujë edhe unë. Më prit këtu.

Plaku nuk pati kohë as ta pyesë ç'kish ndër-

mend të bënte, se ai doli nga dhoma, me të shpejtë, duke përplasur derën.

Kur u kthye përsëri në dhomë, Aleksandri e gjeti plakun të ulur po në atë vend, me duart leshatore të ndera drejt zjarrit.

— Nuk pranon i poshtri — shfryu Aleksandri duke ecur nëpër dhomë.

Plaku e shikoi i habitur dhe u mat ta pyeste. Aleksandri e kuptoi dhe tha:

— Fola me drejtorin e hotelit për punën tënde, por atij nuk ju mbush mendja të të marrë përsëri në punë.

— Pse u munduat kot, zotëri?

— Nuk është mundim ky. Mua më duket gjë shumë e parëndësishme ajo që bëre ti, por për zotëri drejtorin qenka faj i madh, gabim i pafalshëm, që cenon prestigjin e hotelit.

Eci edhe një copëherë lart e poshtë, pastaj i shkrepri diçka në kokë dhe i tha Klausit:

— Vishu, duhet të ikim.

— Ku?

— Do ta marrësh vesh më vonë.

— Unë, zotëri, nuk dua që ju për shkakun tim...

— Leri fjalët. Vishu.

Veshëm palltot e dolëm.

Ndërsa po udhëtonin me taksi, Aleksandri i tha Klausit:

— Mbrëmë pata premierën e Hamletit dhe ashtu si të pata premtuar, të bëra një leje për të hyrë në llozhën time dhe ta dërgova në drejtorinë e hotelit që të ta jepnin ty.

Plaku nuk foli. S'dinte ç'të thoshte. Ndërsa

maçina përshkonte rrugët plot zhurmë të Berlinit, ai vriste mendjen për ta spjeguar sjelljen aqë të përzemërt të këtij të huaji me sy të mëdhenj e të ndritur. Ju kujtua ajo mbrëmje kur ishte njohur me te, bisedat që kishin bërë si të ishin miq të vjetër. Pastaj i erdh ndërmend puna në hotelin «Adlon». Gjatë njëzet vjetëve të shërbimit ai kishte qenë gjithnjë i përpiktë, kishte punuar me zell e kujdes, kishte pritur e përcjellur me buzëqeshje njerëz nga të katër anët e botës; kish duruar fyerjë e përrulje, u ishte bindur tekave të klientave pa hapur gojë. Dhe ja, tani vetëm për një pakujdesi të vogël e kishin hedhur jashtë hotelit, siç hedhin shërbyeset në mëngjes gjërat e panevojshme.

— Arritëm, Klaus. — e zgjoi nga kujtimet zëri i mikut të tij.

Zbritën para një ndërtese të madhe, hijerëndë, me shtylla të trasha si të përhimta.

— Ke qenë ndonjëherë në këtë teatër? — e pyeti Aleksandri plakun.

— Jo — përgjegji ai duke shikuar i habitur ndërtesën.

Hynë mbrenda. Aleksandri e la Klausin në paradhomë dhe vetë u fut në zyrën e drejtorit.

— Urdhëro, i dashuri mik — tha drejtori me përzemërsi të madhe, duke i bërë me dorë që të ulet. — Çfarë ere ju hodhi këtej?

U ngrit dhe i zgjati kutinë e cigareve. Ai ish një burrë rreth të dyzetave, i shkurtër, tullac, me syza të mëdha pas të cilave dukeshin dy sy si të zbërdhulët me rremba të vegjël gjaku.

— Kam ardhur për një punë të vogël — ja nisi Aleksandri. — Unë kam një mik, plak nje-

ri, i cili është pa punë. Erdha t'ju lutem t'i gjeni ndonjë punë këtu në teatrin tuaj, një punë ç'farëdo, kontrollor biletash, portier, punëtor i prapaskenës, gardarobier, e çfarë të doni tjetër.

Drejtori e dëgjoi me vemendje, pastaj i ndërroi disa herë vend punës që kish mbi tryezë dhe foli me zë të qetë e plot njerëzi:

— Si t'ju them? Është e vërtetë se ju kërkoni punë modeste, por tani për tani i kam të tëra vendet e zëna. Besomëni, më vjen shumë keq por s'kam çfarë të bëj. I thoni mikut tuaj të presë ca; më vonë mund të lirohet ndonjë vend.

— Mendohuni njëherë — i tha Aleksandri pasi e dëgjoi.

— Ç'të mendohem. Unë e di mirë se të tëra vendet janë të zëna.

— Zoti drejtor, unë po ju kërkoj një nder kaq të parëndësishëm me bindje se do të ma bëni me doemos.

— I dashuri Moisi, edhe unë do t'ju a bëja me gjithë qejf por ja që s'kam asnjë mundësi.

Aleksandri përmbajti me zor inatin dhe, pasi u mendua pak, u ngrit, ju afrua dritares dhe tha duke kqyrur jashtë:

— Nejse, bëni si të doni. Veç kësaj unë erdha këtu që t'ju them se kam vendosur mos të pranoj propozimin tuaj për të lidhur një kontratë prej tre muajsh.

— Si kështu? — tha i tronditur drejtori dhe sytë ju zmadhuan pas qelqeve të bardha të syzave.

— Jam në fjalë me një teatër tjetër, për ta lojtur atje «Hamletin» gjatë këtyre tre muajve. Te ju do ta çfaq vetëm këtë javë.

Heshtën të dy. Në dhomë tingëlloi telefoni. Dretjori s'e preku me dorë.

— Dëgjoni, zoti Moisiu — foli pas pak drejtori — i thoni atij mikut tuaj të vijë nesër me një pusullë nga ju e të nisë punën si gardero-bier.

— Shumë mirë. Edhe unë do t'i them drejtorit të teatrit tjetër se gjatë këtyre muajve do ta luaj «Hamletin» vetëm në teatrin tuaj.

Kur doli në parathomë, i tha Klausit:

— Mbaje mend këtë teatër dhe zyrën ku hyra unë. Nesër në mëngjes do të vish këtu, do të shkosh te drejtori e do t'i japësh këtë pusullë nga ana ime.

Ju avit tryezës ku rrinte sekretaria e drejtorit dhe shkruajti dy pulla. Pastaj i bëri palë dhe ja zgjati Klausit:

— Kjo është për drejtorin, që të marrë në punë si gardero-bier në këtë teatër, kurse kjo pusulla tjetër është një leje që të hysh sonte në teatër për të parë «Hamletin».

Plakut ju drodhën duart duke marrë ato dy copa letre. E shikoi Aleksandrin dhe sytë i ndritën nga lotët.

— Këtu mbrenda ka shumë tym duhani, dhe të lotojnë sytë — tha Aleksandri. — Më mirë eja të dalim në ajër të pastër.

— Dhe, pasi tha këto fjalë, i shtiu krahun e të dy pranë njeri tjetrit dolën nga teatri.

TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
Pesë dritare	3
Atë natë, pas mbledhjes	10
E mirë si buka	19
Qyteti që kish humbur qetësinë	27
Vila e vetmuar	35
Një cigare në errësi	43
Duke udhëtuar natën	50
Nuk janë fjalë të shkruara mbi rërë	56
Pallati me mermer të kuq	65
Dy ujqërit	73
Njeriu me fytyrë të damkosur	81
Djaloshi dhe gjarpëri	91
Kali i Vaje Çelatit	99
Nata e fundit	113
Portieri i hotelit	120